Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

6M1-2020

**MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 52, DATË 2.9.2020 TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË.*

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE 7

SHËNIME 8

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2020 10

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR 16
1.1 Harta e stabilitetit financiar 16
1.2 Rreziku sistemik 17

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE 21
2.1 Mjedisi makroekonomik i jashtëm 21
2.2 Mjedisi makroekonomik në vend 24
2.3 Zhvillimet në sektorë të veçantë të ekonomisë 26

3. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE 33
3.1 Tregjet 33
3.2 Sistemet e pagesave 42

4. SISTEMI FINANCIAR 44
4.1 Sektori bankar 45
4.2 Sektori jobankar 88

5. POLITIKAT MAKROPRUDENCIALE DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE 93
5.1 Vlerësimi i rreziqeve dhe masat makroprudenciale në vendet e BE-së dhe rajon 93
5.2 Vlerësimi i rreziqeve dhe masat makroprudenciale në Shqipëri 95

ANEKSE 101

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1.	*Përmbledhje e rezultateve të vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe ecuria e indeksit të çmimit të banesave për 6M I-2020*	*41*
Hapësirë informuese 2.	*Sektori bankar dhe kredia e pambrojtur në valutë*	*57*
Hapësirë informuese 3.	*Indeksi i shëndetit bankar*	*64*
Hapësirë informuese 4.	*Efektet e masave për klasifikimin e huasë, provigjionimin dhe kontabilizimin – përvoja ndërkombëtare*	*70*
Hapësirë informuese 5.	*Matja e rrezikut të sektorit bankar nëpërmjet treguesit Z*	*81*

PËRMBAJTJA E TABELAVE

2.	*Zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale*	
Tabelë 1.	*Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare*	*23*
Tabelë 2.	*Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor*	*24*
Tabelë 3.	*Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali sipas sektorëve*	*30*
4	*Sistemi financiar*	
Tabelë 4.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %)*	*44*
Tabelë 5.	*Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, qershor 2020*	*45*
Tabelë 6.	*Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*52*
Tabelë 7.	*Të dhëna mbi ecurinë e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës*	*61*
Tabelë 8.	*FRS 9 – klasifikimi, provigjionimi dhe akumulimi i interesave*	*71*
Tabelë 9.	*Juridiksionet IFRS – ndikimi i masave mbi provigjionet, të ardhurat dhe kapitalin bazë të nivelit të parë (KBN1)*	*73*
Tabelë 10.	*SHBA – ndikimi i masave mbi provigjionet, të ardhurat dhe kapitalin bazë të nivelit të parë (KBN1)*	*73*
Tabelë 11.	*Vlerat mesatare të treguesit të agreguar Z dhe të probabilitetit të paaftësisë paguese*	*83*

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

1.	*Vlerësimi i përgjithshëm i rreziqeve kryesore të stabilitetit financiar*	
Grafik 1.	*Harta e stabilitetit financiar*	*17*
Grafik 2.	*Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik*	*18*
Grafik 3.	*Indeksi i Stresit Financiar*	*18*
Grafik 4.	*Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike në vend*	*19*
2.	*Zhvillimet makroekonomike dhe sektoriale*	
Grafik 5.	*Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve*	*22*
Grafik 6.	*Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera*	*22*
Grafik 7.	*Pozicioni financiar sektorial (miliardë lekë)*	*27*
Grafik 8.	*Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar*	*27*
Grafik 9.	*Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar*	*28*
Grafik 10.	*Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm*	*28*
Grafik 11.	*Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm*	*29*
Grafik 12.	*Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm*	*29*
Grafik 13.	*Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave*	*31*
Grafik 14.	*Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës*	*31*
Grafik 15.	*Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të kredimarrjes në 6 muajt e ardhshëm*	*31*
Grafik 16.	*Indeksi i planifikimit të kredimarrjes bankare në 6 muajt e ardhshëm*	*31*
3	*Tregjet dhe sistemet e pagesave*	
Grafik 17.	*Ecuria e normës mesatare të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)*	*33*
Grafik 18.	*Përbërja e borxhit të brendshëm në lekë të emetuar gjatë 2016-6MI 2020*	*33*
Grafik 19.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar*	*34*
Grafik 20.	*Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6M I-2020*	*34*
Grafik 21.	*Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar*	*35*
Grafik 22.	*Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6M I-2020*	*35*
Grafik 23.	*Huamarrja e brendshme në euro*	*35*
Grafik 24.	*Emetimet e Qeverisë Shqiptare në tregun ndërkombëtar të kapitalit, sipas viteve*	*36*
Grafik 25.	*Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar*	*37*
Grafik 26.	*Numri i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar*	*37*
Grafik 27.	*Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar sipas titujve të tregtueshëm*	*37*
Grafik 28.	*Nivelet e Yield-it (YTM) në datën 30.06.2020*	*37*
Grafik 29.	*Normat e interesit në tregun ndërbankar*	*38*
Grafik 30.	*Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor*	*38*
Grafik 31.	*Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën*	*39*
Grafik 32.	*Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme*	*39*
Grafik 33.	*Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH në gjashtëmujorin e parë 2018-2020*	*42*
Grafik 34.	*Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër (6M I vitet 2015-2020)*	*43*
4	*Sistemi financiar*	
Grafik 35.	*Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, qershor 2020*	*44*
Grafik 36.	*Efekti i kursit të këmbimit në ecurinë e zërave kryesorë të aktivit (majtas) dhe pasivit (djathtas), kundërvlera në lekë*	*46*
Grafik 37.	*Struktura e detyrimeve jorezidente*	*46*
Grafik 38.	*Pozicioni neto me jorezidentët*	*46*
Grafik 39.	*Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*47*
Grafik 40.	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit*	*47*
Grafik 41.	*Kontributi i zërave të mjaftueshmërisë së kapitalit (në pp)*	*48*
Grafik 42.	*Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit sipas instrumenteve përbërëse (në pp)*	*48*
Grafik 43.	*Shpërndarja e aktiveve të sektorit bankar sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit*	*49*
Grafik 44.	*Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, qershor 2020*	*49*
Grafik 45.	*Ecuria e levës financiare sipas përbërësve*	*49*
Grafik 46.	*Ecuria e levës financiare për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, në herë*	*49*
Grafik 47.	*Përbërësit e rezultatit financiar*	*51*
Grafik 48.	*ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit*	*51*
Grafik 49.	*Marzhi neto nga interesi*	*51*
Grafik 50.	*Treguesit e përfitueshmërisë*	*51*
Grafik 51.	*Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë*	*51*
Grafik 52.	*Ndryshimi 6–mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse*	*53*
Grafik 53.	*Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në pp, ndryshime gjashtëmujore*	*53*
Grafik 54.	*Ecuria e kredisë totale pa efektin e kursit dhe fshirjeve; dhe e kredisë në valutë pa efektin e kursit, ndryshime vjetore, në %*	*53*
Grafik 55.	*Ecuria e kredisë për bizneset rezidente*	*54*
Grafik 56.	*Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës, (në %)*	*54*
Grafik 57.	*Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë*	*55*
Grafik 58.	*Ecuria e kredisë për individët rezidentë sipas qëllimit të përdorimit*	*56*

Grafik 59.	*Kredia për rezidentët dhe jorezidentët dhe kredia për jorezidentët sipas afatit*	*56*
Grafik 60.	*Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë*	*57*
Grafik 61.	*Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas qëllimit të përdorimit (në %)*	*57*
Grafik 62.	*Ecuria gjashtëmujore e kredisë së pambrojtur në valutë (kontributi sipas sektorëve)*	*58*
Grafik 63.	*Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj*	*58*
Grafik 64.	*Kredia e re për bizneset dhe individët sipas qëllimit të përdorimit*	*59*
Grafik 65.	*Ecuria e normës së peshuar të interesit për kreditë e reja*	*60*
Grafik 66.	*Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas monedhës*	*60*
Grafik 67.	*Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas subjektit*	*60*
Grafik 68.	*Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontributi në normën vjetore të ndryshimit)*	*62*
Grafik 69.	*Ecuria e depozitave në lekë dhe në euro (në mld njësi)*	*62*
Grafik 70.	*Efekti i kursit të këmbimit në depozitat në valutë*	*62*
Grafik 71.	*Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës (indeks)*	*63*
Grafik 72.	*Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës (kontribut në rritjen vjetore)*	*63*
Grafik 73.	*Flukset e depozitave të reja dhe norma mesatare e interesit për depozitat me afat në lek dhe euro*	*63*
Grafik 74.	*Indeksi i shëndetit bankar*	*64*
Grafik 75.	*Harta e shëndetit bankar*	*64*
Grafik 76.	*Harta e shëndetit bankar e ndarë në grupe, sipas rëndësisë sistemike të bankave*	*65*
Grafik 77.	*Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione*	*67*
Grafik 78.	*Struktura e kredive me probleme*	*67*
Grafik 79.	*Raporti i kredive me probleme sipas sektorit, monedhës dhe afatit*	*67*
Grafik 80.	*RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave*	*68*
Grafik 81.	*RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit*	*68*
Grafik 82.	*Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit*	*69*
Grafik 83.	*Ndryshimi vjetor i stokut të kredive me probleme dhe RKP për subjektet jorezidente*	*69*
Grafik 84.	*Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit*	*70*
Grafik 85.	*Tregues të likuiditetit*	*75*
Grafik 86.	*Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve*	*75*
Grafik 87.	*Maturimi mesatar i mbetur*	*75*
Grafik 88.	*Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin dhe grupet*	*76*
Grafik 89.	*Ecuria e komponentëve të indeksit për sektorin bankar*	*77*
Grafik 90.	*Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore sipas monedhave*	*77*
Grafik 91.	*Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave*	*78*
Grafik 92.	*Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare*	*78*
Grafik 93.	*Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %*	*79*
Grafik 94.	*Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto të peshuar ndaj kapitalit rregullator, në %*	*79*
Grafik 95.	*Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %*	*80*
Grafik 96.	*Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %*	*80*
Grafik 97.	*Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave me afat dhe spread i normave të interesit, në %*	*81*
Grafik 98.	*Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në pikë përqindje*	*81*
Grafik 99.	*Treguesi Z për bankat e veçanta gjatë periudhës T4:2017 – T2:2020*	*82*
Grafik 100.	*Treguesi Z i agreguar gjatë periudhës T4:2017 – T2:2020*	*82*
Grafik 101.	*Dekompozimi i treguesit të agreguar Z sipas përbërësit të përfitueshmërisë dhe të kapitalizimit*	*83*
Grafik 102.	*Kontributi i bankave sistemike në nivelin e përgjithshëm të rrezikut sipas treguesit Z*	*83*
Grafik 103.	*Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës*	*85*
Grafik 104.	*Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës*	*87*
Grafik 105.	*Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë, mars 2020*	*89*
Grafik 106.	*Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, mars 2020*	*89*
Grafik 107.	*Struktura e aktiveve të SH.K.K-ve*	*89*
Grafik 108.	*Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, mars 2020*	*89*
Grafik 109.	*Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve, mars 2020*	*90*
Grafik 110.	*Pesha në treg e fondeve të investimeve sipas vlerës neto të aktiveve, mars 2020*	*90*
Grafik 111.	*Investimet e sektorit jobankar në banka dhe letrat me vlerë të qeverisë në raport me totalin e aktiveve të sektorit jobankar (pesha në %)*	*91*
Grafik 112.	*Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në sektorin bankar ndaj totalit të aktiveve të tyre (në %)*	*91*
Grafik 113.	*Masat kryesore të ndërmarra në vendet e BE-së, sipas lloji*	*94*
Grafik 114.	*Numri i masave të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së*	*94*

5.	*Politikat makroprudenciale dhe vlerësimi i rreziqeve*	
Grafik 115.	*Instrumentet makroprudenciale me bazë kapitalin sipas vendeve të rajonit*	*95*
Grafik 116.	*Disa tregues të kredisë konsumatore*	*97*
Grafik 117.	*Përbërja e kredisë konsumatore sipas qëllimit të përdorimit dhe kontributi i komponentëve në rritjen e kredisë konsumatore për rezidentët, sipas qëllimit të përdorimit (në pp)*	*98*
Grafik 118.	*Norma mesatare e interesit për kredinë e re dhënë individëve dhe struktura e periudhave të fiksimit fillestar të normës së interesit për kreditë e reja për konsum*	*99*
Grafik 119.	*Raporti i kredive konsumatore me probleme dhe kontributi i kredive konsumatore në rritjen e stokut të kredive me probleme në total (në p.p)*	*100*

PARATHËNIE

Raporti i Stabilitetit Financiar (më tej "raporti") publikohet dy herë në vit dhe ky është numri i 24-t i tij. Në hyrje të tij është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, e cila sipas kërkesës së ligjit duhet të publikohet çdo gjashtë muaj. Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të rreziqeve që mund të kërcënojnë stabilitetin e sistemit financiar të Republikës së Shqipërisë dhe infrastrukturën e tij, si dhe vlerëson aftësinë e sistemit financiar për t'i përthithur këto rreziqe. Dokumenti në fjalë iu mundëson autoriteteve publike identifikimin në kohë të masave përkatëse për korrigjimet e nevojshme.

Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Analiza në vijim përfshin kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 (më tej, "periudha"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen për një periudhë kohe deri në 12 muaj.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë të veprimtarisë së tij dhe të rreziqeve që burojnë nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm. Për të vlerësuar rreziqet që burojnë nga ndërveprimi me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e vendeve të zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin e pagesave, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punësimit, të ecurisë së të ardhurave dhe vrojtimeve specifike, është vlerësuar gjendja financiare e sektorit të bizneseve/ndërmarrjeve dhe të individëve/familjeve si edhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Në raport përfshihen gjithashtu edhe rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës. Ky i fundit vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj goditjeve makroekonomike dhe financiare, e shprehur kjo në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Raporti i Stabilitetit Financiar përgatitet nga Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

SHËNIME

Në fund të muajit qershor 2020, klasifikimi i bankave në sektorin bankar shqiptar është si në vijim:

I. Sipas kontributit marzhinal të secilit institucion në rrezikun sistemik në vend,[1] bankat grupohen në:

- Banka me rëndësi sistemike, që janë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a., Banka Raiffeisen sh.a., Banka Credins sh.a., Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. dhe Banka OTP Albania sh.a.
- Banka të tjera, që janë: Banka Alpha Albania sh.a., Banka Procredit sh.a., Banka e Parë e Investimeve Albania sh.a., Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a., Banka Union sh.a., Banka Amerikane e Investimeve sh.a. dhe Banka Tirana sh.a.

II. Sipas origjinës së kapitalit, bankat grupohen në:

- Banka me kapital të huaj[2], që janë: Banka Raiffeisen sh.a. (Austri); Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. (Itali); Banka Alpha Albania sh.a. (Greqi); Banka Kombëtare Tregtare sh.a. (Turqi); Banka OTP Albania sh.a. (Hungari); Banka Procredit sh.a. (Gjermani); Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. (Bullgari); Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a. (Arabia Saudite); Këto banka zotërojnë rreth 70% të totalit të aktiveve të sektorit.
- Banka me kapital shqiptar, që janë: Banka Credins sh.a., Banka Union sh.a, Banka Amerikane e Investimeve sh.a., dhe Banka Tirana sh.a, Këto banka zotërojnë rreth 30% të totalit të aktiveve të sektorit.

III. Sipas shtrirjes së aktivitetit jashtë vendit:

Shtrirje të rrjetit bankar jashtë vendit kanë: Banka Kombëtare Tregtare sh.a. me filialin e saj në Kosovë, dhe Banka Credins sh.a, me degën e saj në Kosovë.

---

[1] *Kontributi marzhinal individual matet nga "Indeksi i Fortësisë Financiare". Për më shumë informacion mbi indeksin dhe mbi përcaktimin e BARS, lutem konsultoni dokumentin: https://www.bankofalbania.org/Stabiliteti_Financiar/Politika_makroprudenciale/Instrumentet_e_politikes_makroprudenciale/Akte_te_miratuara/*

[2] *Një bankë klasifikohet si bankë me kapital të huaj, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

Për analizën e kryer në raport, duhet të konsiderohet që:

(1) Termat "hua" dhe "kredi" kanë të njëjtin kuptim dhe mund të përdoren si zëvendësues të njëri-tjetrit; në të njëjtën mënyrë përdoren edhe termat "ndërmarrje" dhe "biznese" apo dhe "individë" dhe "familje";

(2) Në këtë raport, "teprica e kredisë" i referohet gjendjes së llogarisë "marrëdhënie me klientët", siç është raportuar nga bankat në bilancet e periudhave që analizohen. Ajo përfshin tepricën e kredisë së dhënë nga sektori bankar për subjektet jofinanciare, private dhe publike, rezidente dhe jorezidente. Kjo tepricë ndikohet nga largimi i kredive me probleme nga bilancet e bankave gjatë periudhës që analizohet. Për këtë arsye, teprica e kredisë që analizohet në Raportin e Stabilitetit Financiar është një koncept i ndryshëm nga ai i "kredisë për ekonominë", që trajtohet në raportet e politikës monetare. Në kredinë për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat përfshihet edhe kredia e dhënë nga institucionet financiare jobanka. Gjithashtu, në vlerën e kësaj kredie përfshihet vetëm kredia për sektorin privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirjet e kredive me probleme nga bilancet e bankave duke qenë se këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën ekonomike të tyre; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt. Dallimi në këto koncepte të kredisë, duhet pasur parasysh gjatë interpretimit të analizës përkatëse të treguesve të kredisë (normë rritjeje, raporte të cilësisë, shpërndarje sipas sektorëve, sipas monedhës etj.) në raportet e ndryshme të Bankës së Shqipërisë.

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2020

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Në raportin e stabilitetit financiar dhe në këtë deklaratë që e paraprin, vlerësohet ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve që burojnë prej ndërveprimit të tij me zhvillimet ekonomike, të jashtme dhe të brendshme, me agjentët e ekonomisë reale, me tregjet financiare në vend, si edhe ndaj rreziqeve që lidhen me mënyrën se si sektori bankar zhvillon veprimtarinë e tij. Në vijim, këto rreziqe përballen me gjendjen financiare të sektorit bankar dhe stresohen nëpërmjet ushtrimit të provës së rezistencës, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar.

Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 (më tej, 'periudha'), veprimtaria e sektorit bankar u zhvillua në mënyrë të qëndrueshme, pavarësisht sfidave që paraqiti situata e pandemisë në vend. Masat operacionale të marra nga bankat për sigurimin e vijueshmërisë së funksioneve kritike dhe marrëdhënieve me klientelën dhe masat e marra nga autoritetet publike për zbutjen e goditjes së pandemisë mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare të vendit, mundësuan që veprimtaria e ndërmjetësimit financiar të vijojë në mënyrë të përshtatshme dhe treguesit financiarë të sektorit bankar të mbeten në nivele të mira. Pasiguria për zhvillimet ekonomike në kushtet e pranisë së pandemisë mbetet e konsiderueshme, dhe të tilla mbeten edhe sfidat për veprimtarinë bankare e financiare. Megjithatë, vlerësimet e industrisë bankare dhe ushtrimet e provës së rezistencës, sugjerojnë që kapacitetet e sektorit bankar për t'u pëballur me këto sfida janë aktualisht të mjaftueshme. Banka e Shqipërisë, mbetet e gatshme të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas ligjit, për të mbështetur veprimtarinë bankare dhe kontribuar në stabilitetin e sistemit financiar.

Ky raport, si rregull, analizon zhvillimet në sistemin financiar deri në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2020. Në përgjithësi, këto zhvillime treguan:

- *Shfaqjen e ndikimit të goditjes së pandemisë në treguesit makroekonomikë.* Të dhënat për tremujorin e parë të vitit provuan tkurrjen e ekonomisë me 2.5%, të ndikuar kryesisht nga rënia e investimeve dhe e konsumit. Norma e papunësisë shfaqi një rritje të lehtë pas disa periudhave me përmirësim të vazhdueshëm. Me qëllim zbutjen e goditjes së pandemisë mbi ekonominë e vendit, Qeveria synoi që pavarësisht rënies së të ardhurave buxhetore të ruajë nivelin e shpenzimeve publike, duke vepruar me shpejtësi për të financuar rritjen e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Krahasimi me vende të tjera dhe pritjet për thellim të goditjes së pandemisë në tremujorin e dytë të vitit, tregojnë që ky veprim ishte i nevojshëm dhe i pashmangshëm. Përsa kohë që pasiguria prej pandemisë mbetet e pranishme, kontributi i politikës fiskale në përballimin e efekteve të saj mbetet i rëndësishëm. Ruajtja e një shkalle të përshtatshme fleksibiliteti në afatin e shkurtër duhet gjithsesi të konsiderojë objektivin më afatgjatë për konsolidimin fiskal. Në rang botëror, por edhe në rajon, shumica e vendeve provuan tkurrje ekonomike. Parashikimet për zhvillimet e ardhshme, ruajnë parashikimet pesimiste për vitin 2020 dhe tregojnë se ekonomia botërore gradualisht do t'i rikthehet normave pozitive të rritjes në vitin 2021.

- *Ecurinë normale të tregjeve financiare në vend.* Në këto tregje, megjithë rritjen e vëllimit të huamarrjes nga ana e Qeverisë jo vetëm në lekë, por edhe në valutë, norma mesatare e interesit të titujve të borxhit nuk shfaqi ndryshime gjatë periudhës. Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar mbeti i ulët dhe i përqendruar në emetimet afatshkurtra, duke reflektuar preferencën e investitorëve për zotërimin e titujve të borxhit deri në maturim. Në tregun ndërbankar, vëllimet e tregtimit u rritën, por normat e interesit mbetën pranë nivelit të normës bazë të interesit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë. Leku u nënçmua ndaj valutave kryesore në fund të tremujorit të parë të vitit, por rikuperoi pjesën më të madhe të vlerës në pjesën e dytë të periudhës. Në tregun e pasurive të paluajtshme, treguesit e përfituar nga vrojtimet tregojnë për rritje të çmimit, por pritshmëritë e zhvillimeve në këtë treg për afatin e shkurtër u shfaqën më pesimiste. Gjatë periudhës, funksionimi i sistemeve të pagesave ka qenë optimal.

- *Shfaqjen e ndikimit të pandemisë mbi veprimtarinë e individëve dhe bizneseve*. Gjatë periudhës, sipas të dhënave nga bankat, pozicioni tradicional financiar i individëve si kreditorë neto dhe i bizneseve si debitorë neto ndaj sistemit financiar është zgjeruar. Rritja e depozitave dhe kredive ka qenë pozitive për të dy sektorët, por rritja e depozitave ka qenë shumë më e lartë për individët, ndërsa rritja e kredisë ka qenë e përqendruar tek bizneset. Rezultatet e vrojtimeve për gjendjen financiare dhe ngarkesën në borxh të familjeve, tregojnë se përdorimi i borxhit prej tyre mbetet i kufizuar. Për familjet huamarrëse, gjatë periudhës është vënë re një rënie e aftësisë paguese. Për të ardhmen e afërt, duket sikur kërkesa për borxh do të jetë më e lartë, nga familje që

nuk kanë pasur borxh më parë. Tek ndërmarrjet, përgjigjet e vrojtimit përkatës raportojnë një ndikim të konsiderueshëm nga pandemia, e cila ka paraqitur sfidën kryesore të tyre gjatë periudhës. Ndonëse shumica e ndërmarrjeve kanë arritur të gjenerojnë një rezultat financiar pozitiv, niveli i shitjeve dhe ai i rezultatit financiar kanë treguar një rënie të jashtëzakonshme për të gjitha grupet e ndërmarrjeve, por më shumë për ato të vogla e të mesme. Rënia e nivelit të shitjeve është shoqëruar me rritjen e mbështetjes nga burime të jashtme financimi (kredi), i cili është përdorur kryesisht për përballimin e shpenzimeve korrente dhe më pak për investime. Financimi i jashtëm ka qenë në rritje për ndërmarrjet e vogla e të mëdha. Sipas monedhës, mbizotëron financimi në lekë, veçanërisht tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Rreth ¾ e ndërmarrjeve, sipas grupeve, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e financimit. Për rreth 80% të ndërmarrjeve, vlera e borxhit është deri sa gjysma e vlerës së kapitalit. Pritshmëritë për 6-mujorin e dytë të vitit shfaqen më optimiste në drejtim të rritjes së financimit, rritjes së investimeve dhe përmirësimit të performancës financiare.

- *Performancën e qëndrueshme të sistemit financiar*. Aktiviteti i sistemit financiar u zgjerua me gati 4.4 pikë përqindje (pp) gjatë periudhës, duke u ngjitur në 111.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Në këtë rritje, sektori bankar kontribuoi me 3.9 pikë përqindje. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira. Shkalla e ndërlidhjes mes institucioneve financiare mbetet e qëndrueshme dhe reflekton rëndësinë e qëndrueshmërisë së sektorit bankar për të gjithë sistemin financiar. Gjatë periudhës, veprimtaria e sektorit bankar u zgjerua me 4% dhe me 7% kundrejt një viti më parë. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i investimeve në tituj dhe i aktivitetit kreditues. Në krahun e detyrimeve, depozitat shënuan rritje dhe së bashku me fondet e veta, mbeten burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar. Efekti statistikor i kursit të këmbimit pati një efekt neto rritës në veprimtarinë e sektorit bankar në valutë. Sektori bankar e mbylli gjashtëmujorin e parë të vitit me fitim, por ai ishte rreth 32% më i ulët në krahasim me një vit më parë. Të ardhurat neto nga interesat dhe të ardhurat nga veprimtaritë e tjera ishin të krahasueshme me ato të vitit 2019, por rritja e shpenzimeve për provigjione për kredi dhe për mjete të tjera financiare, e përqendruar në tremujorin e parë të vitit, ka dhënë ndikim negativ në rezultatin financiar të bankave. Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe asnjë bankë e sektorit nuk rezulton me një normë mjaftueshmërie nën minimumin rregullator prej 12%. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2020, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti me 0.4 pikë përqindje, në nivelin 18.1%, e ndikuar kryesisht nga rritja e aktiveve të ponderuara me rrezik. Bankat me kapital të huaj dhe bankat sistemike, shfaqin nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit.

- *Ekspozimin e kontrolluar të sektorit bankar ndaj rreziqeve*. Bankat kanë perceptuar rritje të rreziqeve ekonomike dhe financiare gjatë periudhës, por besimi i bankave në qëndrueshmërinë e sistemit financiar është ruajtur i pandryshuar në vijim të treguesve të mirë financiarë dhe masave të marra për ruajtjen e tyre. Në fund të periudhës, stoku i kredive me probleme ishte rreth 48 miliardë lekë, pothuaj i pandryshuar gjatë saj. Ndikimin kryesor në këtë qëndrueshmëri të vlerës së kredive me probleme e ofruan përcaktimet në moratoriumin e shlyerjes së kredive, të cilat iu kanë dhënë mundësi bankave të pezullojnë përkohësisht evidentimin e kredive me probleme dhe ndryshimet brenda tyre. Si rezultat, kredia me probleme është rreth 24% më e ulët se niveli i një viti më parë. Kjo rënie e kredive me probleme gjatë 12 muajve të fundit, e përqendruar në gjysmën e dytë të vitit 2019, është ndikuar nga fshirjet e kredive, shlyerjet dhe ristrukturimi i tyre. Në kushtet e vijimit të rritjes së kredisë, raporti i kredive me probleme zbriti në 8.1%. Gjendja e likuiditetit të sektorit bankar paraqitet mjaft e mirë, megjithë një rënie të lehtë të raporteve të likuiditetit gjatë periudhës. Tek rreziqet e tregut, sektori bankar mbetet i ndjeshëm ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes segmentit të kredisë së pambrojtur në valutë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit mbetet i pranishëm dhe është rritur gjatë periudhës, por vlerësohet i kufizuar.

  Rreziqet e veprimtarisë bankare reflektojnë dhe ndërthuren me zhvillime të natyrës strukturore. E tillë është ekzistenca për një kohë të gjatë e mjedisit me norma të ulëta të interesit, i cili ruan presionin mbi rezultatin financiar të bankave, nxit ndryshimin e strukturës së financimit të tij drejt burimeve më afatshkurtra dhe nevojës për aktive likuide të larta, si dhe ruan potencialin për rritje të stresit të veprimtarisë në rastin e një korrigjimi të fortë e të papritur. Përdorimi i lartë i valutës në sektorin bankar shoqërohet me rreziqe për administrimin e rrezikut të likuiditetit në valutë. Në tërësi, indekset e vlerësimit të rrezikut sistemik shfaqin rritje gjatë periudhës.

  Nëpërmjet veprimeve rregullative të natyrës mikroprudenciale dhe instrumenteve të politikës makroprudenciale, Banka e Shqipërisë është përpjekur t'i adresojë këto rreziqe. Disa akte të reja rregullative që janë futur në zbatim, ku përfshihen ai për raportin e mbulimit të likuiditetit, paketa e masave për de-euroizimin, si edhe rregullorja për zbatimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit, synojnë zbutjen e rreziqeve dhe forcimin e rezistencës së sektorit bankar ndaj tyre.

Në periudhën mars-qershor të këtij viti, në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë dhe vështirësive të pritshme të kredimarrësve për të përballuar pagesat e kredive, Banka e Shqipërisë ndërmori disa masa dhe ndryshime rregullative të natyrës prudenciale, të cilat synojnë lehtësimin e barrës së kredimarrësve të ndikuar nga pandemia, rritjen e rezistencës financiare të bankave dhe vijimin e aktivitetit kreditues nga ana e sektorit bankar. Këto masa konsistonin në:

- nxjerrjen e një moratoriumi, që mundëson pezullimin e përkohshëm të pagesave të shlyerjes së kredive për huamarësit e ndikuar nga pandemia, fillimisht deri në fund të qershorit 2020 dhe më pas, deri në fund të gushtit 2020;
- miratimin e ndryshimeve rregullative që iu mundësojnë bankave të ruajnë klasifikimin e kredive dhe nivelet e provigjioneve të kredive me probleme gjatë kësaj situate. Qëllimi është që, deri në fund të këtij viti, bankat dhe klientët e tyre huamarrës të gjejnë forma ristrukturimi të kredive të caktuara, që rivendosin shpejt aftësinë paguese të kredimarrësve të ndikuar nga pandemia;
- pezullimin e shpërndarjes së fitimit të bankave deri në fund të këtij viti, me qëllim që në rast të materializimit të humbjeve financiare, madhësia e kapitalit të jetë e përshtatshme jo vetëm për të përthithur këtë humbje, por edhe për të mbështetur kredidhënien e re.

Duke qenë se këto masa janë të përkohshme, edhe ecuria e pandemisë (intensiteti dhe kohëzgjatja e saj) mbetet e pasigurt, nuk përjashtohet mundësia që sfidat me të cilat mund të ndeshet sektori bankar të thellohen. Ushtrimet e provës së rezistencës të kryera nga Banka e Shqiperisë, sugjerojnë që në rast të goditjeve ekstreme në kuadrin makroekonomik, do të ishte e nevojshme që banka të caktuara të forconin pozicionin e tyre të kapitalit, megjithëse në tërësi sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar.

Ndaj është e nevojshme që kjo periudhë të shfrytëzohet nga bankat për të administruar në mënyrë të përshtatshme dhe transparente rreziqet e veprimtarisë, duke u përqendruar në rrezikun e kredisë. Ndonëse të dhënat e mbledhura paraprakisht nga bankat tregojnë se ato janë aktivisht të angazhuara në këto procese, vlerësohet e nevojshme që bankat të ruajnë fokusin e tyre:

- për të garantuar mirëfunksionimin e veprimtarisë institucionale nga këndvështrimi operacional, duke ofruar kushte sa më të sigurta pune për personelin dhe duke siguruar vijueshmërinë e funksioneve kritike të veprimtarisë;
- për të vepruar pa vonesë në drejtim: të vlerësimit të rrezikut të kredisë për klientët e tyre, të shfrytëzimit të mundësive për ristrukturim të kredisë sipas qasjeve që ofrojnë standardet lokale dhe ndërkombëtare, të vlerësimit të provigjioneve shtesë që mund të kërkohen, të analizës së këtyre kostove mbi pozicionin e kapitalit dhe të mënyrës se si do të arrijnë ta përballojnë efektin e këtyre kostove në rast nevoje. Është e rëndësishme të konsiderohet që pozicioni i kapitalit duhet të jetë i mjaftueshëm jo vetëm për të përballuar humbjet e mundshme, por edhe për të mbështetur kreditimin e ri për të cilin ekonomia ka nevojë;
- për të përdorur të gjitha mënyrat, duke përfshirë edhe ushtrimet e provës së rezistencës me skenarë ekstremë, por të mundshëm, në mënyrë që të vlerësojnë rregullisht e në mënyrë proaktive shkallën e rezistencës së tyre ndaj zhvillimeve të pafavorshme;
- për të ruajtur një komunikim konstant dhe të ngushtë me Bankën e

Shqipërisë, në mënyrë që të ndajnë në kohë reale vlerësimin e tyre mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare dhe ndikimin e tyre mbi veprimtarinë bankare.

Nga ana e saj, në kuadër të funksioneve ligjore dhe në koordinim me autoritetet e tjera shtetërore, Banka e Shqipërisë do të jetë e vëmendshme për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, që sektori bankar dhe tregjet financiare të veprojnë në këtë periudhë në kushte sa më të përshtatshme dhe në mënyrë të qëndrueshme.

Në vijim, gjeni të detajuar përmbajtjen e raportit të stabilitetit financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020.

1. VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RREZIQEVE KRYESORE TË STABILITETIT FINANCIAR

1.1 HARTA E STABILITETIT FINANCIAR[3]

Zhvillimet më të fundit reflektojnë një nivel të rritur të rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm makroekonomik dhe agjentët e ekonomisë reale.

Rreziqet që lidhen me veprimtarinë bankare nuk paraqesin ndryshime thelbësore, në reflektim të përmirësimeve strukturore të viteve të fundit, të cilat kanë forcuar parametrat e shëndetit e kanë rritur rezistencën ndaj goditjeve.

Mbështetur në zhvillimet e gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, harta e stabilitetit financiar tregon përgjithësisht një nivel të rritur të rreziqeve në mjedisin e përgjithshëm makroekonomik dhe në agjentët e ekonomisë reale, ndërsa rreziqet që lidhen me veprimtarinë e sektorit bankar mbeten në nivele të kontrolluara në reflektim të ndryshimeve strukturore që sektori bankar ka përjetuar vitet e fundit. Në mënyrë të përmbledhur, vlerësohet se:

A. Në mjedisin e përgjithshëm ekonomik:

I. Rreziku që buron nga "ekonomia e brendshme"[4] vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe i përkeqësuar përgjatë harkut kohor të një viti. Kontribut kryesor në këtë zhvillim ka dhënë ngushtimi i hendekut të prodhimit dhe ecuria e normës së inflacionit.

II. Rreziku nga "mjedisi i jashtëm" mbetet në nivelin "mesatar", por regjistron rritje përgjatë vitit, duke reflektuar recesionin në ekonomitë e partnerëve kryesorë tregtarë dhe rënien e indeksit paralajmërues OECD-CLI[5], të ndikuara nga pandemia SARS-CoV-2. Në një masë më të vogël, kontribut në zbutjen e këtij rreziku dha rënia e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.

B. Në agjentët kryesorë të ekonomisë reale:

I. Rreziku nga "bizneset" vlerësohet "i moderuar", duke regjistruar një rritje graduale përkundrejt një viti më parë. Pavarësisht se cilësia e portofolit të kredisë së bizneseve paraqet ndryshime pozitive, përkeqësimi i ndjeshëm i "indeksit të gjendjes financiare" dhe i "pritshmërive të sektorit privat" kanë ndikuar në rritjen e notës së rrezikut për këtë kategori.

II. Rreziku nga "individët" vijon të vlerësohet "mesatar" dhe i pandryshuar ndaj një viti më parë. Nota e rrezikut për këtë kategori është ruajtur nga cilësia e portofolit të kredisë, pesha e huamarrjes së tyre dhe zhvillimet në tregun e banesave, duke balancuar efektin e përkeqësimit të pritshmërive të individëve dhe të tkurrjes së dërgesave të emigrantëve.

III. Rreziku nga "qeveria" vijon të vlerësohet "i ulët", por nota e kësaj kategorie është rritur përgjatë periudhës. Ndikim kryesor në këtë zhvillim ka pasur zgjerimi i borxhit publik dhe përkeqësimi i ecurisë së të ardhurave tatimore.

---

[3] *Kjo hartë tregon shpërndarjen e rrezikut tek faktorët që ndikojnë stabilitetin e sistemit financiar. Këta faktorë përfshijnë mjedisin ekonomik rrethues, të brendshëm e të jashtëm, sektorin bankar dhe agjentët e ekonomisë reale: qeverinë, bizneset dhe individët.*

[4] *Vlerësimet janë kryer duke u bazuar në vlerat më të fundit zyrtare të publikuara, T1 2020.*

[5] *Indeksi OECD-CLI (Composite Leading Indicator) jep sinjale të paralajmërimit të hershëm mbi kthesat e ciklit të biznesit në nivel global. Rënia e vlerave të tij sinjalizon rënien e nivelit të aktivitetit ekonomik nën potencialin afatgjatë të tij.*

C. Në veprimtarinë e sektorit bankar, në fund të periudhës:

I. Rreziku nga "kapitalizimi dhe përfitueshmëria" mbetet në nivelin "mesatar", por shfaq prirje rritëse përgjatë vitit të fundit, ndikuar kryesisht nga rënia e të ardhurave nga interesat në aktivitetin bankar.

II. Rreziku nga "likuiditeti dhe financimi" mbetet në nivelin "mesatar", duke reflektuar rritjen e depozitave të individëve dhe një mbështetje të ulët në burimet e huaja të financimit.

III. Rreziku që lidhet me vetë "strukturën e sektorit bankar" vlerësohet në nivelin "mesatar" dhe i pandryshuar ndaj një viti më parë. Në këtë kategori, rritja e nivelit të rrezikut si rezultat i rritjes së përqendrimeve në sektorin bankar në terma të kredisë ndaj biznesit dhe burimeve të financimit, është balancuar nga rënia e rrezikut të lidhur me treguesin e devijimit të RMK-së në sektorin bankar.

Grafik 1. Harta e stabilitetit financiar



* Rreziku vlerësohet: i ulët për notat 0-3 në hartë, mesatar për notat 4-5, i moderuar për notat 6-8 dhe i lartë për notat 9-10. Lëvizja drejt skajeve të hartës, larg qendrës, nënkupton rritje të rrezikut.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2 RREZIKU SISTEMIK[6]

1.2.1 ZHVILLIMET NË TREGUESIT E RREZIKUT SISTEMIK

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut sistemik vlerësohet mbi bazën e treguesve të akumulimit e të materializimit të rrezikut, si edhe të stresit financiar. Në këtë vlerësim përfshihet gjithashtu edhe perceptimi i sektorit bankar rreth këtyre rreziqeve[7].

Përkundër rënies në nivelin e stresit financiar, ecuria e treguesve të akumulimit e materializimit të rrezikut sistemik, reflekton një prirje rritëse gjatë periudhës, duke diktuar një vëmendje të shtuar.

Indekset e materializimit e të akumulimit të rrezikut sistemik reflektojnë zhvillime jo të favorshme gjatë periudhës[8]. Indeksi i akumulimit, pavarësisht rënies së peshës së kredive me normë të ndryshueshme interesi, u ndikua në rritje nga zgjerimi i borxhit publik e atij të jashtëm dhe nga rritja e stokut të depozitave në valutë, në reflektim të luhatshmërisë së kursit të këmbimit. Rritje regjistron edhe indeksi i materializimit, ndikuar sërish nga ecuria e kursit të këmbimit, ndërkohë që në kahun rënës ndikoi përmirësimi i cilësisë së kredisë për bizneset.

Nga ana tjetër, indeksi i stresit financiar ka shënuar rënie në fund të periudhës, pavarësisht një rritjeje në tremujorin e parë të vitit. Ecuria e këtij indeksi ka reflektuar kryesisht zgjerimin e bazës së depozitave dhe ngushtimin e hendekut të tepricës së kredisë ndaj prirjes së saj afatgjatë. Efekti i tregut të parasë mbetet i pandryshuar, ndërkohë që ecuria e kursit të këmbimit paraqet rënie të stresit përgjatë tremujorit të dytë të vitit.

[6] *Rreziku sistemik përcaktohet si "mundësia e materializimit të goditjeve që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që rritja ekonomike dhe mirëqenia të ndikohen në mënyrë materiale".*

[7] *Perceptimi i sektorit bankar mbi rreziqet kryesore sistemike në vend përftohet nëpërmjet një vrojtimi ad hoc.*

[8] *Analiza mbi treguesit e akumulimit e materializimit bazohet mbi të dhënat më të fundit të disponueshme: T1 2020.*

Grafik 2. Indekset e akumulimit dhe materializimit të rrezikut sistemik



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3. Indeksi i Stresit Financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2.2 PERCEPTIMI I RREZIKUT SISTEMIK NGA SEKTORI BANKAR

Pandemia dhe efektet e saj mbi ekonominë reale, kanë ndikuar në rritjen e perceptimit të rreziqeve nga ana e sektorit bankar. Për shkak të treguesve të mirë financiarë, masave të marra nga vetë bankat dhe nga autoritetet publike, besimi në qëndrueshmërinë e sistemit financiar mbetet i palëkundur.

I pyetur gjatë periudhës për perceptimin rreth rreziqeve sistemike, sektori bankar ka evidentuar 'rrezikun e përkeqësimit të ekonomisë së vendit' si rrezikun kryesor. Ky vlerësim është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga efektet e pandemisë dhe pasiguria e krijuar prej saj. Paralelisht, 'rreziku i kredisë nga të gjitha subjektet' është rritur ndjeshëm gjatë periudhës si rrjedhojë e përkeqësimit të situatës financiare të bizneseve dhe familjeve.

Përmasat globale të pandemisë dhe masat kufizuese të marra nga vendet për të frenuar pandeminë, kanë rritur perceptimin e bankave mbi "rrezikun e goditjeve nga jashtë". Shumë biznese të lidhura me transportin ndërkombëtar, tregtinë, turizmin etj., janë ndeshur me vështirësi të theksuara financiare për shkak të këtyre masave, duke ulur aftësinë e tyre paguese dhe duke rritur rrezikun e tyre të kreditit. Së fundi, bankat evidentojnë dhe rritjen e rëndësisë së disa rreziqeve të reja të lidhura me periudhën e pandemisë si "rreziku operacional" dhe "rreziku kibernetik", si rezultat i mbështetjes së rritur tek përdorimi i teknologjisë për përmbushjen e veprimtarisë së tyre.

Grafik 4. Vlerësimi i bankave mbi rreziqet kryesore sistemike në vend



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht rritjes së perceptimit të bankave për rreziqet ekonomike dhe financiare me rëndësi sistemike, besimi i tyre tek qëndrueshmëria e sistemit financiar ka mbetur i qëndrueshem. Bankat e mbështesin këtë besim tek treguesit e mirë financiarë të veprimtarisë dhe tek masat që kanë marrë ato vetë dhe autoritetet publike, për të zbutur ndikimin e pandemisë.

Për shkak të pritshmërive që pandemia do të ndikonte negativisht në aftësinë paguese të huamarrësve dhe cilësinë e kredisë së tyre, Banka e Shqipërisë ndërmorri disa masa rregullative që në thelb iu mundësojnë bankave dhe klientëve të tyre huamarrës të ndikuar nga pandemia, të ristrukturojnë ekspozimet përkatëse të kredititi me qëllim që rënia e pritur në cilësinë e kredisë të zbutet. Paralelisht, këto masa kanë synuar edhe forcimin e kapaciteteve financiare të bankave, me qëllim përballimin e humbjeve financiare të mundshme. Në tërësi, masat e marra kanë natyrë të përkohshme, ndaj është e rëndësishme që bankat ta shfrytëzojnë periudhën e zbatimit të tyre për të kryer në mënyrë transparente dhe efektive proceset e ristrukturimit për kreditë e identifikuara. Ndërkohë, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar komunikimin me bankat për të vlerësuar ecurinë e këtij procesi. Në tërësi, informacioni i mbledhur tregon që:

a) bankat janë treguar aktive në pranimin e kërkesave për ristrukturim të kredive të ndikuara nga pandemia, ku mesatarja e raportit të kërkesave të pranuar është mbi 90%;
b) tek kreditë e ristruturuara mbizotërojnë ndjeshëm kreditë të cilat përpara shfaqjes së ndikimit të pandëmisë, kishin status 'performues'. Ky është një fokus i drejtë, për të trajtuar/ndihmuar ata huamarrës që janë ndikuar nga pandemia;
c) në përgjithësi, format e ristrukturimi mbizotërohen nga shtyrja e pagesës së kështit të kredisë për një ose disa periudha dhe (paralelisht) zgjatja e afatit të maturimit të kredisë;

d) në vlerë, ristrukturimet mbizotërohen nga bizneset, ndërsa në numër nga individët/familjet;
e) ristrukturimet kanë përfshirë kredi të bizneseve që kanë vepruar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, ku peshë më të madhe zënë industria përpunuese, tregtia dhe turizmi, ndërsa peshë më të ulët kanë transporti dhe bujqësia;
f) pavarësisht ristrukturimeve të kryera, në kushtet e pasigurisë që shoqërojnë ecurinë e pandemisë, bankat presin që të përballen me rënie të cilësisë së kredisë dhe rritje të provigjioneve për rrezikun e kredisë. Pavarësisht njohjes së këtyre provigjioneve në mënyrë proaktive, efekti i rritjes së tyre mbi rezultatin financiar të bankave pritet të shtrihet edhe përgjatë vitit 2021.

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE DHE SEKTORIALE

2.1 MJEDISI MAKROEKONOMIK I JASHTËM

EKONOMIA BOTËRORE

Aktiviteti ekonomik botëror përjetoi një goditje të paprecedentë në muajt e parë të vitit 2020 si pasojë e emergjencës shëndetësore të pandemisë nga SARS-CoV-2. Masat e forta që u morën për ruajtjen e shëndetit të publikut, krysisht në drejtim të kufizimit të lëvizjes dhe të respektimit të distancimit fizik, u shoqëruan me çrregullimin e zinxhirëve të prodhimit dhe tregtimit, si dhe me rënien e përgjithshme të konsumit. Në kushtet e rënies së ndjeshme të aktivitetit ekonomik, presionet inflacioniste mbetën të dobëta, pavarësisht kërkesës së qëndrueshme për mallra të jetesës së përditshme.

Aktiviteti ekonomik botëror përjetoi një goditje të paprecedentë në fillimvitin 2020 si pasojë e emergjencës shëndetësore të pandemisë nga SARS-CoV-2, që rezultoi në një recesion të thellë të tij.

Perspektiva e ekonomisë botërore mbetet e ndikuar nga një shkallë e lartë pasigurie. Rreziqet kryesore lidhen me kohëzgjatjen e pandemisë dhe materializimin e ndikimit ekonomik të saj, si dhe suksesin e paketave të masave në mbështetje të ekonomisë.

Zhvillimet negative në sektorin real, fillimisht sollën rritje të ndjeshme të pasigurisë në tregjet financiare, gjë që u reflektua në shtrëngimin e kushteve të financimit, rënien e vlerave të aseteve dhe zgjerimin e *spread*-ve, rritjen e treguesve të luhatshmërisë dhe rënien e përgjithshme të besimit. Këto dukuri u vërejtën si në rajonet e zhvilluara ashtu edhe tek ato në zhvillim. Duke e konsideruar si më të ulët aftësinë e vendeve në zhvillim për t'u përballur me zgjerimin e pandemisë, investitorët mbështetën zhvendosjen e flukseve të kapitalit drejt instrumenteve financiare të vendeve të zhvilluara.

Në përgjigje të situatës së krijuar dhe për të zbutur pasojat e krizës, qeveritë në mbarë botën ndërtuan dhe aktivizuan paketa masash të natyrës fiskale e financiare në mbështetje të familjeve dhe të bizneseve të prekura nga pandemia. Bankat qendrore dhe autoritete të tjera monetare u angazhuan gjerësisht në mbështetjen e sistemeve financiare dhe ekonomive me likuiditet përmes çlirimit të mëtejshëm të politikave monetare, aktivizimit të programeve të lehtësimit sasior apo lehtësimit të kërkesave makroprudenciale ndaj bankave, me qëllim përthithjen e humbjeve potenciale financiare dhe zbutjen e ngërçeve të financimit.

Në tregjet e këmbimit të monedhave dhe të lëndëve të para, euro përgjithësisht u vlerësua gjatë periudhës kundrejt monedhave kryesore si jeni japonez dhe franga zvicerane, si dhe kundrejt monedhave të një pjese të rajoneve në zhvillim. Në muajt e fundit, pritjet për një tkurrje të thellë të ekonomisë së SHBA-së gjatë tremujorit të dytë të vitit, ndikuan në forcimin e saj edhe ndaj monedhës amerikane. Rënia e ndjeshme e kërkesës globale, solli rënie të shpejtë të çmimeve të naftës në rreth 20 USD për fuçi në fillim të prillit 2020. Gjatë muajve të fundit, çmimi i naftës në tregje është rikuperuar në rreth

38 USD për fuçi (indeksi Brent, qershor '20), ndikuar nga lehtësimi i masave kundër pandemisë dhe rikuperimi ekonomik i Kinës, si edhe nga ulja e kuotave të prodhimit në kahun e ofertës.

Grafik 5. Ecuria e indekseve kryesore në tregjet e aksioneve



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Grafik 6. Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj monedhave të tjera



Burimi: Banka Qendrore Evropiane.

Me lehtësimin e masave të forta kufizuese nga shumica e vendeve dhe rifillimin e aktivitetit ekonomik në sektorët kryesorë, ekonomia botërore pritet të ndalë rënien dhe të hyjë në rrugën e ringritjes duke filluar nga gjysma e dytë e këtij viti në vijim e gjatë vitit 2021[9], mbështetur dhe nga vijimi i programeve të ndihmës dhe stabilizimi i tregjeve financiare. Gjithsesi shpejtësia e ringritjes ekonomike është subjekt i pasigurive të mëdha[10], që së pari lidhen me ecurinë (valët) e pandemisë dhe më tej me mënyrën se si ajo do të ndikojë sjelljen e tregjeve, të investitorëve dhe të konsumatorëve. Për më tepër, situatat e ndërlikuara për tregtinë botërore dhe proteksionizmin tregtar, të cilat ishin të pranishme edhe përpara pandemisë, janë komplikuar edhe më tej.

EUROZONA

Edhe ekonomia e Eurozonës ka shënuar një tkurrje të ndjeshme gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Në T1-2020, tkurrja e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) në Eurozonë rezultoi 3.1 % në terma vjetorë (3.6% në terma tremujorë) dhe të dhënat paraprake sugjerojnë një tkurrje shumë më të fortë në tremujorin e dytë. Kjo ecuri reflekton veçanërisht tkurrjen e ndjeshme të konsumit dhe investimeve që në mesin e muajit mars 2020, ku vendet më të prekuara ishin Franca, Italia dhe Spanja. Tregu i punës në Eurozonë gjithashtu u godit ndjeshëm nga masat e mbylljes dhe papunësia në nivel rajoni u rrit në 7.8% në qershor (nga 7.2% të rezultuar tre muaj më parë). Presionet inflacioniste mbetën të ndrydhura dhe në rënie, ndikuar kryesisht nga rënia e çmimeve të naftës.

[9] *FMN parashikon që rritja e ekonomisë botërore do të rezultojë -4.9% për vitin 2020 dhe +5.4% për vitin 2021 (parashikim i muajit qershor, 2020, World Economic Outlook update).*

[10] *Zgjerimi i pandemisë ka pakësuar zërat që presin një ringritje të ekonomisë në formën 'V', përkundrejt shtimit të zërave që presin një ringritje të saj në formë 'U' apo edhe 'L'.*

Në përgjigje të situatës, qeveritë e vendeve të Eurozonës ndërmorën një sërë masash fiskale e financiare për zbutjen e efekteve negative të pandemisë. Këto masa synonin kontrollin mbi rritjen e papunësisë dhe mbështetjen e konsumit, si edhe financimin me likuiditet të bizneseve me qëllim përballimin e rënies së të ardhurave. Paralelisht, Banka Qendrore Evropiane vijoi angazhimin e saj në kahun lehtësues të politikës monetare përmes veprimeve të lehtësimit sasior për të mbështetur sektorin financiar me likuditetin e nevojshëm. Parashikimet e Komisionit Evropian në verën e këtij viti, ishin më pesimiste se ato të pranverës. Sipas këtyre parashikimeve, ekonomia e Eurozonës pritet të tkurret me 8.7% gjatë këtij viti (-7.7% në parashikimin e pranverës), dhe të rritet me 6.1% në 2021. Vendet më të goditura parashikohet të jenë Italia, Spanja dhe Franca, ku ekonomia do të tkurret me 10%. Për Bashkimin Evropian, tkurrja e ekonomisë gjatë këtij viti parashikohet në 8.3% (-7.4% në parashikimin e pranverës), ndërsa rritja gjatë vitit 2021 pritet të jetë 5.8%. Presionet mbi nivelin e papunësisë në Eurozonë do të mbeten të larta, në kushtet kur skemat e mbështetjes së punësimit gjatë pandemisë, fillojnë të përfundojnë në vjeshtën e këtij viti. Gjithsesi, parashikimet kushtëzohen në mënyrë kritike nga ecuria e mëtejshme e pandemisë, përparimi drejt zhvillimit të një vaksine të sigurt dhe efikase, si edhe mundësia që autoritetet të ndërmarrin veprime të tjera për mbështetjen e ekonomisë (në vijim të planit të rikuperimit evropian prej 750 miliardë eurosh).

Në sektorin bankar, dinamika e kreditimit ka reflektuar efektet e pandemisë në sektorin privat jofinanciar. Kreditimi ndaj sektorit të bizneseve ka vijuar të rritet si rezultat i kërkesës së rritur për financim në kushtet e rënies së të ardhurave dhe pamundësisë për mbulimin e shpenzimeve. Prirje të kundërt ka karakterizuar kreditimin ndaj familjeve, ndikuar nga rënia e të ardhurave të tyre dhe rritja e pasigurisë për të ardhmen.

Tabelë 1. Disa tregues makroekonomikë për SHBA-në, Eurozonën dhe disa vende anëtare

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)		Papunësia (% vjetore)		Borxhi i qeverisë (% e PBB-së)	
	T1'20	T2'20	2020p	Mars'20	Qer'20	Mars'20	Qer'20	T4'19	T1'20
SHBA	-5.0	-32.9	-8.0	1.5	0.6	4.4	11.1	106.8	107.7
Eurozonë	-3.1	-15.0	-10.2	1.3	0.3	7.2	7.8	84.1	86.3
Gjermani	-2.2	-11.7	-7.8	0.8	0.8	3.8	4.2	59.8	61.3
Francë	-5.7	-19.0	-12.5	0.1	0.2	7.6	7.7	98.1	101.2
Itali	-5.5	-17.3	-12.8	0.2	-0.4	8.4	8.8	134.8	137.6
Greqi	-0.9	:	-10.0	0.2	-1.9	14.5	15.5	176.6	176.7

Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat,
'p'-parashikime (qershor 2020) të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Zyra e Analizave Ekonomike (BEA –Bureau of Economic Analysis). Zyra Amerikane e Statistikave të Punës (U.S. Bureau of Labor Statistics); ": ": mungesë informacioni.

BALLKANI PERËNDIMOR

Pas një ecurie ekonomike të qëndrueshme gjatë periudhës 2018-2019, rajoni i Ballkanit Perëndimor u godit nga kriza globale e pandemisë. Efektet negative të saj u materializuan që në T1-2020, ku rritja ekonomike e tyre u ngadalësua ndjeshëm, duke zbritur në agregat në 2.5% nga 4.3% në tremujorin e fundit

të vitit 2019. Konsumi privat mbetet kontribuuesi kryesor, ndërkohë që investimet kanë qenë të luhatshme, duke shënuar rënie në një pjesë të vendeve. Ngadalësimi ekonomik është reflektuar gjithashtu në përkeqësimin e kushteve në tregun e punës dhe rënien e punësimit. Presionet ndaj bilancit të pagesave u rritën ndjeshëm dhe të gjitha vendet e rajonit (me përjashtim të Serbisë) u shoqëruan me mbështetje financiare nga FMN dhe BE. Në përgjigje të situatës dhe për të zbutur pasojat e saj mbi bizneset dhe familjet, qeveritë e vendeve të rajonit aktivizuan paketa të ndryshme fiskale e monetare. Zgjerimi i stimujve fiskalë, shoqëruar dhe me rënien e përgjithshme të të ardhurave fiskale, kanë sjellë zgjerim të deficitit buxhetor dhe rritje të borxhit publik gjatë periudhës në shumicën e vendeve të rajonit. Presionet inflacioniste mbeten të dobëta. Në këto kushte, politikat monetare vijuan të mbeten lehtësuese dhe në disa prej vendeve, bankat qendrore ulën më tej normën bazë të interesit.

Tabelë 2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë dhe financiarë për vendet e Ballkanit Perëndimor

	PBB (reale, % vjetore)				Papunësia (në %)		Rritja e kredise (% vjetore)		Rap. i kredive me probleme (në%)	
	T4'19	T1'20	2020p	2021p	T4'19	T1'20	T1'20	T2'20*	T1'20	T2'20*
Bosnje-Herzegovinë	3.8	2.0	:	:	:	:	3.4	0.9	6.6	:
Maqedoni e Veriut	3.4	0.2	-3.9	4.0	16.6	16.2	6.5	5.9	4.8	:
Mal i Zi	3.1	2.7	-5.9	4.4	16.1	16.3	4.3	4.6	5.1	5.3
Kosovë	3.9	1.3	:	:	25.9	:	10.0	6.4	2.3	2.4
Serbi	6.2	5.0	-4.1	6.1	9.7	9.7	11.1	12.0	4.0	:
Shqipëri	-0.1	-2.5	-4.8	4.2	11.6	11.9	7.4	6.7	8.2	8.1

Burimi: Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse.
'p'- parashikimi i muajit qershor, 2020; ':' mungesë informacioni; "": të dhënat i referohen muajit maj 2020 (me përjashtim të Shqipërisë ku të dhënat janë për qershor 2020).*

Ecuria e kredidhënies bankare ka vijuar të jetë pozitive, por ritmi i rritjes është ngadalësuar në disa prej vendeve. Bilanci i bankave të rajonit është përmirësuar gjatë periudhës si rezultat i masave për pezullimin e përkohshëm të shlyerjes së kredive dhe ruajtjen e gjendjes së kredive me probleme.

2.2 MJEDISI MAKROEKONOMIK NË VEND

Pas tërmetit të muajit nëntor 2019, përhapja e pandemisë së koronavirusit thelloi goditjen mbi ekonominë shqiptare. Autoritetet publike ndërmorrën masa në sferën fiskale, monetare dhe prudenciale, për të zbutur efektin e kësaj goditjeje. Këto masa kanë ndryshuar parametrat fiskalë e financiarë, por kanë ruajtur ekuilibrin në kuadrin makroekonomik të vendit.

Ndikimi i situatës së krijuar nga pandemia e koronavirusit SARS-Cov-2 u reflektua në një tkurrje të aktivitetit ekonomik në vend. Për të dytin tremujor radhazi, PBB-ja erdhi në rënie vjetore, duke shënuar një tkurrje prej 2.52% në fund të T1-2020[11]. Në këtë ecuri, kontribuuan pakësimi i investimeve private dhe i shkëmbimeve tregtare në mallra e shërbime, krahas ngushtimit të ndjeshëm të konsumit final të popullatës dhe të qeverisë. Analiza sipas sektorëve të ekonomisë tregoi se performanca negative në degët kryesore të ekonomisë si "ndërtim", "tregti, transport, argëtim dhe çlodhje", "industri, energji dhe ujë" dhe "aktivitete financiare dhe të sigurimit" nuk arriti të zbutej nga kontributi pozitiv i degëve "bujqësi, pyje dhe peshkim" dhe "pasuri të paluajtshme".

[11] *Rritja reale vjetore e aktivitetit ekonomik në vend gjatë T1-2019 dhe T3-2019 ishte përkatësisht rreth 2.4% dhe 4.2%, ndërsa në T4-2019 ishte -0.10%.*

Kontributi i sektorit të jashtëm të ekonomisë[12] ka vijuar të jetë pozitiv në sajë të ngushtimit të mëtejshëm të deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave. Ky u ngushtua me rreth 9% në terma vjetorë, në nivelin 226 milionë euro, duke reflektuar efektin neto të ndikimit pozitiv nga ngushtimi i deficitit tregtar në mallra[13] dhe nga zgjerimi i suficitit në të ardhurat dytësore, pavarësisht zhvillimeve të pafavorshme në llogarinë e shërbimeve[14] dhe në të ardhurat neto nga investimet[15]. Prurjet valutore në formën e dërgesave të emigrantëve vlerësohen në rreth 152 milionë euro, lehtësisht në rritje ndaj një viti më parë (1%), por me rënie të ndjeshme kundrejt periudhës paraardhëse (16%). Në terma relativë, vlerësohet se deficiti i llogarisë korrente përbën rreth 7% të PBB-së, pa ndryshime të ndjeshme kundrejt një viti më parë. Deficiti në llogarinë korrente u financua nga flukset neto hyrëse në llogarinë financiare prej rreth 211 milionë eurosh dhe flukset neto hyrëse në llogarinë kapitale prej rreth 25 milionë eurosh. Në fund të periudhës, vlerësohet që mjetet e rezervës valutore mbulojnë vlerën e 6.5 muajve të importeve mesatare në mallra dhe shërbime.

Tërmeti i muajit nëntor 2019, shoqëruar me masat e ndërmarra për ruajtjen e shëndetit publik në kuadër të pandemisë duket se kanë rezultuar në një efekt neto negativ mbi zhvillimet ekonomike dhe tregun e punës. Ky efekt pasqyrohet në rënien e treguesit të besimit të sektorit privat jofinanciar, në nivele edhe më të ulëta se ato të krizës financiare të vitit 2009. Megjithatë, rritja në normën e papunësisë në nivelin prej 11.4% mbetet rreth vlerës mesatare të 12-mujorit të fundit.[16]

Në vijim edhe të pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, goditja e pandemisë mbi ekonominë shqiptare mund të ishte edhe më e fortë, nëse autoritetet publike nuk do të ndërmerrnin masa të natyrës fiskale, monetare e prudenciale.

Kështu, Qeveria shqiptare miratoi dy paketat e ndihmës dhe të garancisë financiare, që synonin zbutjen e goditjes mbi të ardhurat e punonjësve të sektorit privat dhe të të vetëpunësuarve, si edhe mbështetjen e sipërmarrjeve të goditura nga pandemia me kapital qarkullues. Nevoja për ruajtjen e nivelit të shpenzimeve publike dhe parashikimet për rënien e të ardhurave fiskale gjatë këtij viti, diktuan rishikimin e buxhetit të shtetit me qëllim parashikimin e niveleve më të larta të deficitit fiskal e të borxhit publik, si edhe përcaktimet e formave të nevojshme të financimit. Në fund të periudhës, për shkak të rritjes së shpenzimeve publike me 2% dhe rënies së të ardhurave fiskale me 14%, vlerësohet se deficiti buxhetor u ngjit në rreth 38.5 miliardë lekë (ose rreth 2.5% e

---

[12] *Sipas të dhënave deri në T1-2020.*

[13] *Deficiti tregtar u ngushtua me rreth 6% në terma vjetorë, me kontribut kryesor nga rënia e importeve të energjisë elektrike dhe e zërit "makineri e pajisje".*

[14] *Suficiti i tregtisë në shërbime ra me rreth 18 milionë euro, si rezultat i tkurrjes së balancave pozitive në "shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët" dhe "shërbime të tjera biznesi". Ndërkohë, shërbimet e udhëtimit u mbyllën me bilanc pozitiv prej 93 milionë eurosh, në rritje vjetore rreth 23%.*

[15] *Të ardhurat nga investimet regjistrojnë sërish një bilanc negativ, në rreth 94 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë (15%), kryesisht në formën e pagesave të dividendëve e fitimit të riinvestuar dhe pagesa interesash.*

[16] *Norma e papunësisë shënonte nivelin prej 11.2% në T4-2019 dhe 12.1% në T1-2019. Norma mesatare e papunësisë përgjatë harkut kohor T1'19 - T1' 20 vlerësohet në rreth11.5%.*

PBB-së), ndjeshëm mbi nivelet e regjistruara në dy gjashtëmujorët paraardhës.[17] Financimi i deficitit buxhetor është bërë tërësisht nga fondet e huaja, ku burime shtesë financimi u siguruan nëpërmjet huamarrjes nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe tregjet e huaja.

Pritshmëria për një ndikim të fortë të pandemisë mbi treguesit ekonomikë dhe financiarë të vendit nxiti Bankën e Shqipërisë që paralelisht të ndërmarrë një paketë masash për adresimin e situatës. Këto masa përfshinë lehtësimin e mëtejshëm të politikës monetare përmes uljes së normës bazë të interesit[18] ; vendosjen e një moratoriumi për pezullimin e shlyerjeve të kredive në rast të kërkesës së huamarrësit të ndikuar nga pandemia, fillimisht deri më 31 maj 2020 dhe në vijim deri më 31 gusht 2020; lehtësimin e kostos së operimit të sistemit të pagesave elektronike në monedhën vendase; dhe heqjen e kufizimeve për likuiditetin e injektuar në tregun ndërbankar. Për institucionet financiare jobankare, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka ndërmarrë veprime të posaçme mbikëqyrëse, me qëllim forcimin e rezistencës financiare të këtyre institucioneve. Në tërësi, këto masa krijuan kushte për ruajtjen e qëndrueshmërisë së veprimeve dhe të normave të interesit në tregun financiar dhe zbutjen e efekteve të goditjes së pandemisë mbi huamarrësit, bankat dhe investitorët.

Masat e mësipërme të autoriteteve publike përfaqësojnë një reagim të jashtëzakonshëm ndaj një goditjeje të paprecedentë mbi shëndetin publik dhe ekonominë e vendit. Masat janë të ngjashme dhe proporcionale me ato të marra në vende të tjera. Ato reflektojnë jo vetëm objektivin më afatshkurtër për të lehtësuar goditjen mbi ekonominë shqiptare, por edhe atë më afatgjatë për të ruajtur ekuilibrat e nevojshëm në kuadrin makroekonomik të vendit.

2.3 ZHVILLIMET NË SEKTORË TË VEÇANTË TË EKONOMISË

2.3.1 POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE[19]

Zgjerimi i pozicionit financiar neto sipas sektorëve është kontribut i rritjes së depozitave në monedhën vendase për individët dhe i kredisë në valutë për bizneset.

Gjatë periudhës, pozicioni tradicional financiar i individëve si kreditorë neto dhe i bizneseve si debitorë neto ndaj sistemit financiar, është zgjeruar. Rritja e depozitave dhe kredive ka qenë pozitive për të dy sektorët, por rritja e depozitave ka qenë shumë më e lartë për individët, ndërsa rritja e kredisë ka qenë e përqendruar tek bizneset.

Për sektorin e individëve, bankat raportojnë një zgjerim të depozitave (kryesisht në lekë) dhe të stokut të kredisë (kryesisht në valutë), përkatësisht me rreth 26.1 miliardë lekë dhe 3.7 miliardë lekë. Për bizneset, rritja me rreth 20.4

[17] *Një vit më parë (qershor 2019), deficiti buxhetor regjistronte vlerën prej rreth 3.45 miliardë lekësh; ndërsa, në dhjetor 2019 shënoi vlerën prej 31.54 miliardë lekësh.*

[18] *Ulja e normës bazë të interesit, nga 1.0% në 0.5%, në 25 mars 2020.*

[19] *Analiza i referohet zhvillimeve kryesore në pozicionin financiar të sektorit të individëve dhe të bizneseve. Për më shumë informacion mbi zhvillimet në sektorin bankar, lutem konsultoni kapitullin përkatës.*

miliardë lekë e kredisë (në pjesën më të madhe në valutë) u shoqërua me rritjen prej 5.3 miliardë lekësh të depozitave (tërësisht në lekë).

Si rezultat, në fund të muajit qershor 2020, pozicioni kreditor i sektorit të individëve u ngjit në nivelin e rreth 829 miliardë lekëve dhe pozicioni debitor i bizneseve u zgjerua në rreth 177 miliardë lekë.

Grafik 7. Pozicioni financiar sektorial (miliardë lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.2 INDIVIDËT REZIDENTË

Individët rezidentë rritën kursimet e tyre përgjatë periudhës me rreth 24 miliardë lekë. Rritja e depozitave, si në lekë dhe në valutë, vijon të japë kontributin kryesor në këtë zhvillim, pavarësisht uljes së investimeve në titujt afatgjatë të qeverisë dhe në fondet e investimeve. Edhe zhvillimet vjetore dëshmojnë se investimet në depozita (në të gjitha monedhat) mbeten forma e preferuar e kursimeve të individëve.

Struktura e kursimeve të familjeve shqiptare mbetet e përqendruar në instrumentet që ofron sektori bankar dhe më pak në format alternative të investimit që ofrohen nga operatorët e tjerë të tregut.

Megjithatë, ecuria e pasurisë neto të individëve duhet vlerësuar në raport me ngarkesën me borxh që ata kanë. Për këtë është kryer vrojtimi periodik përkatës, ku është intervistuar një kampion prej 1210 familjesh, i përzgjedhur metodologjikisht nga Instituti i Statistikave. Këtë herë, rreth 89% e tyre (1079 familje) kanë marrë pjesë në procesin e intervistimit duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Pesha e të përgjigjurve ndaj totalit të kampionit ka mbetur e pandryshuar krahasuar me vrojtimin e kaluar.

Të dhënat e vrojtimit tregojnë që rreth 23% e familjeve të përgjigjura deklarojnë se kanë të paktën një hua për të paguar, të siguruar nga burime të ndryshme. Kjo peshë ka rënë me respektivisht 1 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë, duke vijuar të mbetet nën mesataren historike të vrojtimit. Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rritje krahasuar me dy vrojtimet paraardhëse.

Grafik 8. Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe AMF.

Shënim: Vlerat për fondet e investimeve dhe pensionet private i përkasin T1-2020 (raportimi më i fundit i disponueshëm).

Në lidhje me ngarkesën e borxhit, rreth 80% e familjeve huamarrëse të përgjigjura kanë deklaruar se kësti i huasë ka mbetur i pandryshuar gjatë periudhës. Balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër të familjeve huamarrëse (20% e familjeve huamarrëse) ka rezultuar 1 pikë përqindje, duke sinjalizuar për një rritje të vlerës së kështit të kredisë.

Përdorimi i borxhit nga familjet shqiptare mbetet i kufizuar. Për familjet huamarrëse, gjatë periudhës është vënë re një rënie e aftësisë paguese. Për të ardhmen e afërt, duket sikur kërkesa për borxh do të jetë më e lartë, nga familje që nuk kanë pasur borxh më parë.

Më tej, rreth 55% e familjeve huamarrëse kanë deklaruar se aftësia e tyre paguese 'nuk ka ndryshuar' gjatë periudhës (gjashtëmujori i parë 2020) dhe kjo peshë ka rënë me 13 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Pjesa tjetër e të përgjigjurve, vlerësojnë në agregat përkeqësim të aftësisë së tyre paguese, duke reflektuar përkeqësimin e përgjithshëm të parametrave ekonomikë në vend për shkak të pandemisë së Covid-19.

Kjo është reflektuar dhe në pritjet pesimiste të familjeve lidhur me aftësinë e tyre paguese në të ardhmen. Kështu, 66% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese (në rënie me 9 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin e kaluar) në gjysmën e dytë të vitit 2020. Balanca neto e përgjigjeve të pjesës tjetër ka rezultuar – 8.4 pikë përqindje, gjë që tregon se në tërësi familjet presin përkeqësim të aftësisë së tyre paguese në 6 muajt e ardhshëm.

Grafik 9. Aftësia paguese në 6 muajt e kaluar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 10. Pritshmëritë për aftësinë paguese në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kërkesa e familjeve për huamarrje gjatë gjysmës së dytë të vitit, mund të jetë më e lartë. Rreth 58% e familjeve kanë deklaruar se "nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm", por 42% e tyre kanë deklaruar se e konsiderojnë në shkallë të ndryshme sigurie[20] mundësinë "për të marrë/rimarrë një hua", dhe kjo peshë është rritur kundrejt dy vrojtimeve paraardhëse (respektivisht me 2 pikë përqindje dhe me 9 pikë përqindje). Si rezultat, indeksi i mundësisë për të marrë/ rimarrë një hua ka rezultuar në 0.182, duke shënuar rritje krahasuar me dy vrojtimet paraardhëse dhe tejkalon vlerën e mesatares afatgjatë të tij.

[20] *Alternativat e dhëna janë: 'ka pak mundësi', 'ka shumë mundësi' dhe 'është e sigurt'.*

Grafik 11. Indeksi i planifikimit të marrjes së një huaje të re në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grupin e familjeve që planifikojnë të marrin një hua të re, rezulton se rreth 75% e tyre janë "huamarrës të rinj", pra që nuk kanë hua të papaguar në momentin e intervistimit dhe kjo peshë është rritur me 12 pikë përqindje në terma 6-mujorë dhe me 16 pikë përqindje në terma vjetorë.

2.3.3 BIZNESET/NDËRMARRJET

Për të vlerësuar gjendjen financiare, përdorimin dhe ngarkesën e borxhit tek ndërmarrjet, përdoret vrojtimi periodik i kryer me ndihmën e Institutit të Statistikave. Për këtë vrojtim, u përzgjodh një kampion prej 1374 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, rreth 80% e totalit morën pjesë në vrojtim duke iu përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit.

Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve vlerësohet në rritje në terma të kapitalit dhe të të ardhurave.

Pritshmëritë tejet optimiste për huamarrje të re në afat të shkurtër përfaqësojnë një zhvillim pozitiv.

Ndërmarrjet vlerësojnë se gjendja financiare e tyre gjatë periudhës u ndikua fort nga pandemia. Si rezultat, ecuria e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar paraqesin një rënie mjaft të theksuar për gjashtëmujorin e parë 2020 për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke u vlerësuar më e dukshme për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme. Të tre grupet e ndërmarrjeve shprehen për ngushtim të veprimtarisë së tyre, pa mundur të rrisin investimet për të zgjeruar aktivitetin Pavarësisht ecurisë së përkeqësuar të këtyre treguesve, pritshmëritë e të gjitha ndërmarrjeve paraqiten pozitive lidhur me shitjet dhe rezultatin financiar për gjashtëmujorin e dytë 2020, madje më optimiste në krahasim me vrojtimin e mëparshëm. Lidhur me zgjerimin e veprimtarisë, ndërmarrjet shprehin gjithashtu pritshmëri pozitive, por ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha paraqiten më pak optimiste në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar.

Gjatë periudhës, rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se e kanë financuar veprimtarinë e tyre nëpërmjet shitjeve. Duke qenë se shumica e ndërmarrjeve të përgjigjura në vrojtim i kanë raportuar shitjet në rënie, mbështetja vetëm në këtë burim për të financuar veprimtarinë ka rënë ndjeshëm për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit zë pjesën kryesore për periudhën dhe ka një peshë të konsiderueshme e të zgjeruar për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Për më shumë se gjysmën e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive, financimi është realizuar nëpërmjet kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura.

Nga pergjigjet e vrojtimit, rezulton që ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve huamarrëse vlerësohet në rritje përgjatë periudhës, duke u paraqitur më e theksuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vlera totale e huasë rezultoi afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit për 80% të ndërmarrjeve huamarrëse dhe e barabartë ose më e madhe për 20% të tyre. Raporti hua/kapital paraqitet më i lartë te ndërmarrjet e mëdha, ku 22% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh rezulton më e shprehur tek ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve dhe ato të tregtisë.

Tabelë 3. Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali sipas sektorëve

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MII 2018	20,7%	14,9%	15,0%	29,6%
6MI 2019	26,8%	18,5%	18,3%	28,8%
6MII 2019	20,4%	28,0%	13,4%	26,5%
6MI 2020	16,4%	22,9%	19,7%	22,2%

Burimi. Banka e Shqipërisë

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (76%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të tyre. Pesha e këtyre ndërmarrjeve ka shfaqur rritje prej 9 pikë përqindje krahasuar me vrojtimin paraardhës. Barra e pagesës së huasë duket se rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, ku pesha e ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave, zë 29% të totalit të grupit[21] ndërsa për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, kjo peshë shënon respektivisht 25% dhe 22%. Të pyetura nëse pagesa e huasë ka ndryshuar gjatë periudhës, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 85% e ndërmarrjeve të vogla, 82% e ndërmarrjeve të mesme dhe 93% e ndërmarrjeve të mëdha), pohojnë se ky shpenzim ka mbetur i pandryshuar. Përgjigjet e pjesës tjetër kanë rezultuar në balanca neto pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke treguar rritje të këtij shpenzimi në raport me të ardhurat.

[21] *Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: "20-50% të të ardhurave","50-80% të të ardhurave" dhe "mbi 80% të të ardhurave".*

Grafik 13. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, bazuar në përgjigjet e ndërmarrjeve, duket sikur kërkesa për kredi jep sinjale të mira rigjallërimi. Rreth 39% e ndërmarrjeve të përgjigjura deklarojnë se "nuk ka asnjë mundësi" që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme, por në krahasim me periudhën paraardhëse, kjo peshë ka rënë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Ky ngushtim ka qenë më i dukshëm për ndërmarrjet e mëdha. Për më tepër, vihet re një rritje e peshës së ndërmarrjeve që pohojnë se "ka pak mundësi" të marrin një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2020, si edhe e peshës së ndërmarrjeve të cilat shprehen se "ka shumë mundësi" që diçka e tillë të ndodhë në periudhën pasardhëse. Nga ana tjetër, të gjitha grupet e ndërmarrjeve, kanë shënuar një rënie për alternativën "është e sigurt", duke shprehur pasigurinë e situatës në planifikimin e huamarrjes.

Grafik 15. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të kredimarrjes në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Indeksi i planifikimit të kredimarrjes bankare në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në tërësi, indeksi i planifikimit të huamarrjes për të ardhmen afatshkurtër, është rritur për të gjitha ndërmarrjet, me kontributin më të madh nga ndërmarrjet e mëdha e më pas, ato të vogla.

3. TREGJET DHE SISTEMET E PAGESAVE

3.1 TREGJET

TREGU PRIMAR I LETRAVE ME VLERË

Në tregun primar të letrave me vlerë, mbizotërojnë titujt e borxhit të qeverisë shqiptare. Në këtë treg, emetimi i këtyre titujve për rezidentët u rrit me 75 miliardë lekë, në nivelin 206 miliardë lekë gjatë periudhës. Nga këto, rreth 12.6 miliardë lekë ishin emetim në monedhën euro, ndërsa pjesa tjetër në lekë. Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit të borxhit të brendshëm mbeti pothuaj e pandryshuar, në nivelin 2.3%. Megjithatë, kjo normë ishte 0.6 pikë përqindje më e lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar[22]. Emetimi i titujve të borxhit në lekë u ngjit në nivelin 193 miliardë lekë, duke qenë 48% më shumë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Në krahasim me emetimin e një viti më parë, rritja ishte rreth 20 miliardë lekë ose 12% më shumë. Pesha e borxhit afatshkurtër në totalin e borxhit të brendshëm në lekë që ishte në rënie gjatë dy viteve të fundit, është rritur në 71% gjatë gjysmës së parë të vitit.

Emetimi i titujve të borxhit të qeverisë u rrit ndjeshëm gjatë periudhës, por norma mesatare e interesit mbeti pothuaj e pandryshuar. Për emetimet e borxhit në lekë, rritja e emetimeve, është shoqëruar me rritjen e peshës së titujve afatshkurtër.

Grafik 17. Ecuria e normës mesatare të interesit të letrave me vlerë të borxhit (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 18. Përbërja e borxhit të brendshëm në lekë të emetuar gjatë 2016-6MI 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë

Nga titujt e borxhit të emetuar në lekë, 137 miliardë lekë ishin bono thesari, ndërsa 56 miliardë lekë ishin tituj borxhi afatgjatë.

[22] *Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 u regjistrua niveli më i ulët deri tani i normës mesatare të interesit, me 1.8%.*

Emetimet në bono thesari gjatë periudhës ishin 66% më shumë në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 dhe 12% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë. Rreth 92% e këtyre emetimeve ishin me afat maturimi 12 muaj dhe 5% ishin me afat maturimi 3 muaj (një maturitet që i kishte munguar tregut prej rreth 2 vitesh). Normat mesatare të interesit për emetimet 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore ishin përkatësisht 1.4%, 1.6% dhe 1.95%. Norma mesatare e interesit për emetimet afatshkurtra ishte rreth 1.92%, duke rënë me 0.05 pikë përqindje nga periudha e mëparshme. Në terma vjetorë, norma mesatare e interesit për titujt afatshkurtër shënoi rritje me 0.6 pikë përqindje. Në përgjithësi, oferta për investim në tituj afatshkurtër ka qenë e njëjtë ose më e lartë se kërkesa e qeverisë për huamarrje.

Grafik 19. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e bonove të thesarit në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të bonove të thesarit, për 6M I-2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Emetimet në tituj afatgjatë gjatë periudhës ishin 18% më shumë në krahasim me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019 dhe 2% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rreth 60% e këtyre emetimeve ishin me afat maturimi 2 dhe 3 vjet, të cilat shënuan rritje gjatë periudhës, ndërsa emetimet me afat maturimi 5 vjet ishin më të ulëta. Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit për titujt afatgjatë në lekë u rrit në nivelin 3.3%, nga 3.1% në gjashtëmujorin e kaluar dhe 2.8% një vit më parë. Obligacionet 2-, 7- dhe 10-vjeçare kanë shënuar rënie të lehtë në normat e interesit që variojnë nga 0.02 në 0.07 pikë përqindje. Titujt me maturitet 3- dhe 5-vjeçar kanë shënuar rritje në normat mesatare përkatësisht me 0.2 pikë përqindje dhe 0.6 pikë përqindje kundrejt gjashtëmujorit të kaluar. Në përgjithësi, oferta për investim në tituj afatgjatë pothuajse gjithmonë ka qenë më e lartë sesa kërkesa për huamarrje nga qeveria. Kjo u vu re veçanërisht për obligacionet me maturitet 2-vjeçar.

Grafik 21. Vëllimi dhe norma mesatare e peshuar e obligacioneve në tregun primar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Teprica mbi shumën e ofruar për investim dhe normat e interesit të obligacioneve, për 6M I-2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fillim të vitit, qeveria riemetoi në tregun e brendshëm, borxhin afatmesëm në euro në formën e obligacioneve 2-vjeçare. Borxhi në euro i emetuar në muajin prill të këtij viti ishte 100 milionë euro dhe norma mesatare e interesit ishte 1.96%. Ky ishte emetimi i vetëm në euro prej më shumë se 2 vitesh dhe përfaqëson rreth 6% të borxhit të brendshëm të emetuar gjatë periudhës. Pavarësisht kërkesës së lartë për huamarrje në euro nga qeveria, oferta për investim në këtë titull e tejkaloi shumën e shpallur me rreth 37%.

Grafik 23. Huamarrja e brendshme në euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HUAMARRJA NË TREGUN NDËRKOMBËTAR TË KAPITALIT

Tregjet ndërkombëtare të kapitalit funksionojnë në nivel global përtej kufijve gjeografikë. Aksesi në këto tregje, përmirëson (diversifikon) strukturën e borxhit në drejtim të karakteristikave të mbajtësve të tij dhe të monedhës, dhe mund të çojë në uljen e kostos mesatare të tij. Nga ana tjetër, emetimi në tregjet ndërkombëtare rrit transparencën në çmimin e borxhit dhe shërben si një mekanizëm disiplinimi për emetuesit e borxhit, publikë dhe privatë.

Në muajin qershor të këtij viti, qeveria shqiptare u prezantua në tregun ndërkombëtar të kapitalit përmes emetimit të një obligacioni të ri 7-vjeçar, me vlerë 650 milionë euro dhe kupon 3.5%. Megjithë kushtet sfiduese të tregut për

Grafik 24. Emetimet e Qeverisë Shqiptare në tregun ndërkombëtar të kapitalit, sipas viteve



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

ekonomitë në zhvillim gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, oferta e investitorëve ishte disa herë më e lartë nga kërkesa e Qeverisë Shqiptare. Qëllimi kryesor i këtij emetimi ishte mbulimi i nevojave buxhetore për financim, duke përfshirë rimëkëmbjen ekonomike pas goditjes së tërmetit të muajit nëntor 2019 dhe pandemisë SARS-CoV-2. Ky nuk është rasti i vetëm i hyrjes në tregjet ndërkombëtare të kapitalit. Emetimet e mëparshme në këto tregje janë realizuar në vitet 2010, 2015 dhe 2018. Megjithëse emetimi i këtij viti ka vlerë më të madhe krahasuar me emetimet e mëparshme, norma e tij e interesit ishte e njëjtë me atë të emetimit të vitit 2018 dhe në nivelin më të ulët të shënuar deri tani.

TREGU SEKONDAR I TITUJVE TË BORXHIT

Aktiviteti në tregun sekondar të titujve të borxhit të qeverisë shënoi rënie në vlerë dhe në numër transaksionesh.

Kurba e yield-eve në treg shfaq një pjerrësi normale, por investitorët vijojnë të shfaqin preferencë për t'i mbajtur titujt deri në maturim.

Gjatë periudhës, aktiviteti në tregun sekondar të titujve të borxhit të qeverisë shënoi rënie në vlerë dhe në numër transaksionesh. Vëllimi i transaksioneve të titujve afatshkurtër dhe afatgjatë, që u tregtuan në tregun sekondar me pakicë ishte rreth 3.1 miliardë lekë, ose 4% më pak krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 36% më pak kundrejt vitit të kaluar. Numri i transaksioneve ishte 1,027 ose 8% më i ulët në krahasim me gjashtëmujorin paraardhës. Ndikimin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë rënia në vëllimin dhe numrin e titujve afatshkurtër me përkatësisht 11% dhe 9%. Titujt afatgjatë të tregtuar gjatë periudhës shënuan rritje me 13% në vëllimin e tregtuar, por numri i transaksioneve zbriti me 3%.

Në transaksionet në tregun me pakicë të titujve mbizotërojnë ato në bono thesari, që zënë rreth 89% të vëllimit të tregtuar. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, numri i transaksioneve dhe i vëllimit të tregtuar të titujve ka rënë përkatësisht me 19% dhe 36%. Investitorët në tregun sekondar me pakicë vijojnë të shfaqin preferencë për t'i mbajtur letrat me vlerë deri në maturim (vetëm rreth 26% e tyre tregtohen).

Grafik 25. Vëllimi i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 26. Numri i transaksioneve të letrave me vlerë në tregun sekondar



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Zhvilluesit e tregut (*market makers*) kanë vijuar kuotimet ditore të titujve *benchmark* (obligacione referencë me maturitet 3 dhe 5-vjeçar). Megjithëse numri i transaksioneve të tyre ka rënë me 11% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, vëllimi i tregtuar është rritur me 15%.

Kuotimi me bazë ditore i titujve referencë mundëson llogaritjen e kurbës së *yield*-it, që shërben si referencë për titujt e tjerë të borxhit në treg dhe rrit transparencën duke dhënë informacion në kohë reale për çmimin e titujve. Kurba e *yield*-it ruan një pjerrësi normale, ku normat e interesit janë rritur për të gjitha maturitetet dhe periudhave më të gjata të investimit u korrespondojnë norma më të larta interesi.

Grafik 27. Vëllimi i transaksioneve në tregun sekondar sipas titujve të tregtueshëm



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 28. Nivelet e Yield-it (YTM) në datën 30.06.2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Aktiviteti në tregun ndërbankar regjistron rritje dhe normat e interesit u luhatën pranë nivelit të normës bazë.

TREGU NDËRBANKAR

Gjatë periudhës vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar është rritur, ndërsa normat e interesit janë luhatur pranë nivelit të normës bazë të interesit të vendosur nga Banka e Shqipërisë. Tregu ndërbankar vijon të mbizotërohet nga transaksionet 1-javore (83% e vëllimit të huamarrjes ndërbankare) ndjekur nga transaksionet 1-ditore (16%). Në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, vëllimi i transaksioneve shënoi rritje për shkak të rritjes me rreth 40% në vëllimin e transaksioneve 1-javore. Nga ana tjetër, transaksionet 1-ditore dhe 1-mujore kanë rënë në krahasim me periudhën e mëparshme. Bankat kanë vijuar të kryejnë dhe transaksione me maturitet 2-ditor apo 3-ditor, por me vëllime më të vogla, krahasuar me llojet e tjera. Normat e interesit kanë qëndruar pranë nivelit të normës bazë të interesit, duke ndjekur uljen e saj nga 1% në 0.5% në muajin mars 2020.

Grafik 29. Normat e interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Në tregun e këmbimeve valutore, Leku ndjeu goditjen e pandemisë duke u nënçmuar ndaj valutave kryesore. Gjithsesi, luhatshmëria e lartë rezultoi afatshkurtër.

TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, monedha evropiane dhe dollari amerikan janë mbiçmuar ndaj Lekut në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, konkretisht monedha evropiane me 1.7% dhe 1.8%, ndërsa dollari amerikan me 0.4% dhe 2.2%.

Në fillim të vitit 2020, vlera e lekut ishte e qëndrueshme kundrejt monedhave të huaja. Pas përhapjes së pandemisë SARS-CoV-2 dhe masave kufizuese për zbutjen e saj, në muajin mars, euro dhe dollari amerikan u mbiçmuan ndjeshëm ku euro këmbehej me mesatarisht 125.4 lekë dhe dollari me 115.4 lekë. Megjithatë, ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë dhe përshtatja e operatorëve të tregut, bënë që luhatshmëria të ishte afatshkurtër dhe qëndrueshmëria e kursit të këmbimit të rikthehej. Në fund të periudhës, monedha evropiane këmbehej me mesatarisht 124.2 lekë dhe dollari amerikan me 110.4 lekë.

Grafik 30. Ecuria e kursit të këmbimit në tregun e brendshëm valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë

TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Treguesit që përdoren për monitorimin e ecurisë së tregut të pasurive të paluajtshme japin sinjale të përziera në lidhje me kërkesën dhe ofertën në këtë treg gjatë periudhës. Nga ana e kërkesës, treguesit cilësorë reflektojnë kushte të shtrënguara të bankave për kredi për pasuri të paluajtshme dhe kërkesë në rënie nga individët për financimin e blerjes së banesave. Nga ana tjetër, teprica e kredisë për pasuri të paluajtshme ka shënuar rritje dhe agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme raportojnë rënie të numrit të pronave të pashitura dhe rritje të çmimit të shitjes. Për sa i përket ofertës në këtë treg, kredia për ndërtim shënoi rritje në krahasim me fundin e vitit 2019 dhe ndaj një viti më parë.

Indeksi i çmimit të banesave është rritur lehtë dhe treguesit e kredisë bankare për ndërtim dhe pasuri të paluajtshme e mbështesin këtë. Pavarësisht, treguesit cilësorë - nga vrojtimi për pasuritë e paluajtshme dhe vrojtimi i aktivitetit kreditues- raportojnë kushte të shtrënguara kreditimi, kërkesë të dobësuar për këtë lloj kredie dhe në përgjithësi për këndvështrim pesimist të agjentëve për momentin dhe të ardhmen afatshkurtër..

Të dhënat e sektorit bankar për periudhën tregojnë një nivel në rritje të tepricës së kredisë për pasuri të paluajtshme dhe përmirësim të cilësisë së saj gjatë periudhës dhe kundrejt një viti më parë. Stoku i kredisë për blerje pasurish të paluajtshme nga sektori i individëve shënoi rreth 112 miliardë lekë për gjysmën e parë të vitit 2020 dhe ishte rreth 3% më i lartë ndaj fundit të vitit 2019. Ecuria e kësaj kredie është favorizuar edhe nga norma interesi të ulëta dhe të qëndrueshme për këtë kategori kredie. Raporti i kredive me probleme për këtë lloj kredie ra në 4.4%, nga rreth 5% një vit më parë. Teprica e kredisë për ndërtim shënoi rritje me fundin e vitit 2019 dhe me një vit më parë. Pesha e kredisë për ndërtim zë 14% të tepricës së kredisë së bizneseve, duke mbajtur nivele thuajse të pandryshuara gjatë dy viteve të fundit.

Në fund të periudhës, stoku i kredive të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme shënoi rritje mbështetur në të njëjtën masë nga ecuria e kredive të kolateralizuara në monedhën vendase dhe të huaj. Brenda kësaj ndarjeje, 62% e stokut mbahet nga sektori i individëve dhe pjesa tjetër nga sektori i bizneseve.

Grafik 31. Ecuria e Indeksit Fischer të Çmimit të Banesave në rang vendi dhe për Tiranën

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Cilësia e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rezultatet e vrojtimit për ecurinë e tregut të pasurive të paluajtshme tregojnë që, për periudhën, agjentët e tregtimit të pasurive të paluajtshme kanë raportuar çmime shitjeje më të larta ndaj gjashtëmujorit të kaluar. Çmimet e banesave të llogaritura sipas Indeksit Fischer për shitjet e kryera gjatë periudhës, janë rritur me 4.9% në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 40% në krahasim me periudhën bazë (viti 2013). Për shitjet e realizuara në zonën e Tiranës, që përfshin qendrën, periferinë dhe zonat jashtë qytetit, indeksi regjistroi një rritje prej 6.5% ndaj periudhës paraardhëse dhe 43.4% ndaj periudhës bazë.

Ashtu siç pritej në këtë periudhë, agjentët u shprehën relativisht pesimistë për zhvillimet në tregun e pasurive të paluajtshme, duke vlerësuar situatën në këtë treg si të përkeqësuar. Agjentët mbeten pesimistë edhe për periudhën e ardhshme, por janë dukshëm më optimistë për të ardhmen e këtij tregu në terma më afatgjatë.

HAPËSIRË INFORMUESE 1. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË VROJTIMIT "TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME" DHE ECURIA E INDEKSIT TË ÇMIMIT TË BANESAVE PËR 6M I-2020

Informacioni mbi ecurinë e çmimeve dhe vlerësimin e situatës në tregun e pasurive të paluajtshme merret nëpërmjet vrojtimit në terren të një kampioni të përbërë nga 230 subjekte, që kanë si aktivitet kryesor tregtimin e pronave të paluajtshme dhe ndërtimin, shitjet e të cilave përfaqësojnë rreth 75%-80% të xhiros së të gjithë popullatës. Instituti i Statistikave mbulon intervistimin në terren, proceset kryesore të kampionimit dhe kontrollin fizik të pyetësorëve të plotësuar.

Vlerësimi i përgjithshëm. Vlerësimi i agjentëve për situatën e përgjithshme të tregut është raportuar ndjeshëm i përkeqësuar në krahasim me periudhën e kaluar, duke reflektuar pasigurinë e tregut në situatën e krijuar nga pandemia SARS-CoV-2. Në përgjigje të pyetjes "Si e vlerësoni situatën e tregut në krahasim me periudhën (gjashtëmujorin) e mëparshme?", balanca neto e përgjigjeve rezultoi negative [-54]%, dhe vetëm 6% e agjentëve kanë dhënë përgjigje pozitive (më mirë), ndërkohë që rreth 1/3 e përgjigjeve ishin neutrale – "pa ndryshim". Kjo vlerë e balancës shënon thyerje ndaj prirjes së viteve të fundit, në ngushtim të vazhdueshëm, dhe ndaj mesatares afatgjatë prej rreth [-19.6]%. I njëjti tregues i vlerësuar vetëm për subjektet që kanë raportuar shitje gjatë periudhës, rezultoi lehtësisht më pak negativ, në vlerën [-44]%, gjithashtu me prirje të kundërt (më pesimist) nga vitet e fundit.

Ecuria e çmimeve dhe e shitjeve. Në fund të periudhës, Indeksi Fischer i çmimit të banesave në rang vendi shënoi rritje me 40% në krahasim me nivelin e periudhës bazë (viti 2013) dhe rritje me 4.9% ndaj gjashtëmujorit të mëparshëm. Vëllimet e shitjeve kanë rënë lehtë në rang vendi, por janë rritur në zonat qendrore dhe jashtë qytetit të Tiranës. Indeksi i Çmimit për Tiranën u rrit me 43.4% ndaj

periudhës bazë dhe me 6.5% ndaj periudhës paraardhëse. Çmimet mesatare në Tiranë raportohen të rritura ndjeshëm në zonat jashtë qytetit (me mbi 50%), por janë raportuar në rënie të lehtë në zonat qendrore dhe periferi. Zonat bregdetare raportuan çmime mesatare rreth 15% më të ulëta, ndërsa zonat e tjera shfaqën ndryshime thuajse të papërfillshme.*

Numri i banesave të regjistruara. Agjentët raportojnë numër më të ulët banesash të reja të regjistruara në librat e tyre. Balanca neto e atyre që raportojnë rritje të numrit të banesave të regjistruara dhe atyre që raportojnë rënie të numrit të tyre, ishte rreth [-9.3]%, duke treguar rënie nga periudha e kaluar. Numri i pronave të pashitura, si për banesat, ashtu edhe për godinat tregtare, ka vijuar të shënojë rënie për disa gjashtëmujorë radhazi.

Koha mesatare e shitjes. Koha mesatare e shitjes së banesave në rang vendi raportohet të jetë mesatarisht 10.3 muaj dhe shënoi një rritje të lehtë ndaj gjashtëmujorit të kaluar. Për Tiranën, subjektet e intervistuara kanë raportuar një kohë mesatare shitjeje prej 10.4 muajsh ose 1.2 muaj më të gjatë se ajo e raportuar në gjashtëmujorin e kaluar. Për zonën e bregdetit dhe për zonat e tjera, koha e shitjes u raportua përkatësisht 10.7 dhe 11.4 muaj, me rritje të lehta nga periudha e kaluar.

Financimi nëpërmjet kredisë bankare. Sipas agjentëve, rreth 60% e pronave për banim dhe e atyre për përdorim tregtar të shitura prej tyre janë blerë me hua bankare. Kjo shifër shënon rënie në krahasim me vlerën prej 65% të raportuar në periudhën paraardhëse.

Pritjet për të ardhmen. Ndryshe nga periudhat e tjera, këtë herë agjentët kanë pritje negative për ecurinë e tregut në territorin ku ata veprojnë për të ardhmen afatshkurtër, por janë optimistë për periudhën më afatgjatë (deri në dy vjet). Numri i pronave që pritet të regjistrohen për shitje gjatë periudhës në vazhdim, vlerësohet se do të pësojë ulje (balanca neto rezultoi [-9.2]%). Agjentët nuk presin ndryshime të qenësishme të çmimeve të pronave të paluajtshme për banesat, kurse për pronat tregtare, balanca neto ishte pozitive (15.8%), duke reflektuar optimizëm nga ana e agjentëve.

Çmimi i qirasë. Çmimet e qirasë për periudhën raportohen të rritura nga të intervistuarit. Nevojitet të theksohet që këto përgjigje janë të përqendruara në zonën e kryeqytetit.

** "Zona të tjera" përfshin të gjitha zonat përveç Tiranës dhe zonës së Bregdetit.*

3.2 SISTEMET E PAGESAVE

Infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhën vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet.

Gjatë periudhës, infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë financiare dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan gjatë periudhës 59,543 transaksione pagesash me një vlerë prej 4,762 miliardë lekësh, ku përkatësisht numri dhe vlera e transaksioneve kanë pësuar një rënie prej 7.1% dhe 12.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës janë kleruar 339,580 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 162,000 lekësh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje në numër prej 1.59%, ndërkohë ka pësuar rënie në vlerë me përkatësisht 3.9%.

Grafik 33. Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH, në gjashtëmujorin e parë 2018-2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër (6M I vitet 2015-2020)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me instrumentet e pagesave, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020 janë kryer rreth 9.9 milionë pagesa me një vlerë totale prej 1,941 miliardë lekësh. Në krahasim me një vit më parë, numri i transaksioneve u rrit me 19%, ndërsa vlera e tyre ra me 9.4%. Këtë gjashtëmujor vërehet që për herë të parë pagesat me karta kanë zënë peshën kryesore në numër transaksionesh (48.1%), ndërkohë që transfertat e kreditit vijojnë të mbizotërojnë në instrumentet e pagesave në vlerë transaksionesh (me 94.7%). Pesha e transfertave të kreditit si instrument pagese ka pësuar rënie diktuar nga rënia në numër dhe në vlerë e këtyre instrumenteve në formën letër.

Nga ana tjetër, kemi një rritje të numrit dhe vlerës së transfertave të kredititi në formën joletër (internet banking, mobile banking), si dhe një rritje të ndjeshme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera me karta (përkatësisht me 43.7% në numër dhe 63.2% në vlerë) krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

4. SISTEMI FINANCIAR

Pesha e aktiveve të sistemit financiar ndaj PBB-së është rritur. Kontributin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë sektori bankar, IFJB-të dhe shoqëritë e sigurimit. Treguesit e performancës së sistemit financiar në terma të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira.

Pesha e totalit të aktiveve të sistemit financiar[23] ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) u rrit në 111.6% nga 107.2% në fund të vitit dhe 104.4% një vit më parë. Aktiviteti i sektorit bankar, i institucioneve financiare jobanka dhe i shoqërive të sigurimit mbështeti rritjen e aktiveve të sistemit financiar, ndërsa industria e fondeve nuk shënoi ndryshime të rëndësishme.

Në fund të periudhës, pesha e sektorit bankar u rrit në 99.4% nga 95.5%, ndërsa pesha e sektorit jobankar u rrit në 12.2% të PBB-së nga 11.7% në dhjetor 2019. Treguesit e performancës së sistemit financiar duke përfshirë ata të kapitalizimit, të përfitueshmërisë, të likuiditetit dhe të cilësisë së aktiveve mbeten në nivele të mira.

Grafik 35. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit, qershor 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Tabelë 4. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në %)

Autoriteti Licensues dhe Mbikëqyrës	Financial system	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Banka e Shqipërisë	Sektori bankar	88.1	92.1	94.8	97.6	97.3	100.5	99.4	96.0	95.5	99.4
	Institucione jobanka	2.7	2.7	2.7	3.0	2.9	3.0	3.1	3.5	4.2	4.4
	SHKK dhe Unioni	0.8	0.8	0.7	0.8	0.8	0.6	0.6	0.6	0.7	0.7
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.5	1.6	1.7	1.9	2.1	2.1	2.1	2.1	2.2	2.6
	Fondet e pensionit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.2
	Fonde investimi		1.2	3.9	4.8	5.0	4.7	5.0	4.5	4.3	4.4
Ndërmjetësimi financiar		93.1	98.6	103.8	108.2	108.0	111.0	110.3	106.9	107.2	111.6

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[23] *Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar dhe sektori jobankar (institucione financiare jobanka, shoqëritë e kursimit-kreditit, shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit dhe fondet e investimit). Baza e të dhënave për sektorin jobankar dhe të dhënat për PBB-në i përkasin tremujorit të parë të vitit 2020.*

4.1 SEKTORI BANKAR

4.1.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN BANKAR

Sektori bankar ushtroi funksionet e tij dhe zgjeroi veprimtarinë, pavarësisht ndikimit të pandemisë. Depozitat dhe fondet e veta mbeten burimet kryesore të financimit të veprimtarisë të sektorit bankar. Efekti statistikor i kursit të këmbimit rezultoi në kahe të ndryshme përgjatë dy tremujorëve të parë dhe të dytë të vitit 2020. Rënia e vendosjeve pranë jorezidentëve, ka ulur vlerën e pozicionit kreditor neto të sektorit bankar ndaj tyre.

Sektori bankar raportoi zgjerim të aktiveve me rreth 4% gjatë periudhës dhe rreth 7% ndaj një viti më parë. Pavarësisht situatës së vështirë të krijuar nga pandemia në vend, sektori ka vijuar të kryejë funksionet e tij mbështetëse për ekonominë me financim.

Vlera e raportuar e aktiveve u rrit me 50 miliardë lekë gjatë periudhës duke arritur në rreth 1,530 miliardë lekë. Kontributin kryesor në rritjen e aktiveve e ka dhënë zgjerimi i investimeve në tituj me rreth 80 miliardë lekë dhe aktiviteti kreditues me rreth 12 miliardë lekë. Vendosjet e sektorit bankar në banka dhe institucione të tjera financiare shënuan rënie. Gjithashtu, rritja e fondeve të provigjioneve për rrezikun e kreditit dha një kontribut negativ në ecurinë e aktiveve me rreth 3 miliardë lekë gjatë periudhës.

Tabelë 5. Struktura e bilancit të bankave dhe ndryshimi vjetor, qershor 2020

Aktivi	% e aktiveve	Ndryshimi vjetor,%	Pasivi	% e pasiveve	Ndryshimi vjetor,%
I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	28.2	-8.0	I. Veprime me thesarin dhe ndërbankare	6.3	16.3
II. Veprime me klientët (Kredia)	38.3	4.8	II. Veprime me klientët (Depozita)	80.2	7.4
- Nga e cila: për sektorin publik	1.5	-16.8	- Nga të cilat: të sektorit publik	2.1	22.7
- Nga e cila: për sektorin privat	36.8	6.3	- Nga të cilat: të sektorit privat	78.1	7.0
III. Veprimet me letrat me vlerë	31.7	32.3	III. Veprimet me letrat me vlerë	0.2	-67.2
IV. Fonde rezervë të krijuara	-2.1	-19.9	IV. Detyrime të tjera	1.1	24.9
V. Të tjera*	3.9	-15.4	V. Burimet e përhershme	11.8	5.2
			Nga të cilat: Borxhi i varur	0.9	-9.2
			Nga të cilat: Kapitali aksioner	10.3	6.0
Totali i aktiveve	100	7.4	Totali i pasiveve	100	7.4

Burimi: Banka e Shqipërisë.

* *Tek zëri "Të tjera" në bilanc i referohemi "Mjeteve të tjera", "Mjeteve të qëndrueshme" dhe "Interesa të përllogaritura".*

Efekti statistikor i kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të zërave kryesorë të bilancit valutor ishte pozitiv (për rreth 56 miliardë lekë) gjatë tremujorit të parë dhe negativ (për rreth 42 miliardë lekë) gjatë tremujorit të dytë të vitit, si pasojë e nënçmimit dhe mbiçmimit të monedhës vendase në secilin nga tremujorët. Në anën e aktivit, efekti i kursit ka qenë më i fortë në veprimet me thesarin dhe ato ndërbankare dhe në veprimet me klientët (kredinë), ndërsa në anën e pasivit, pothuajse i gjithë efekti statistikor i kursit të këmbimit është reflektuar në kundërvlerën në lekë të depozitave në valutë. Në fund të periudhës, aktivet dhe pasivet në valutë të sektorit bankar zinin përkatësisht 52% dhe 50% të totalit të bilancit, dhe këto raporte kanë shënuar rënie në krahasim me periudhat e kaluara.

Grafik 36. Efekti i kursit të këmbimit në ecurinë e zërave kryesorë të aktivit (majtas); dhe pasivit (djathtas), kundërvlera në lekë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat dhe fondet e veta vijojnë të përbëjnë burimet kryesore të financimit të veprimtarisë së sektorit bankar, duke zënë 92% të totalit të pasivit dhe kjo strukturë paraqitet e qëndrueshme gjatë periudhës. Varësia ndaj burimeve të huaja të financimit mbetet në nivele të ulëta. Këto burime janë kryesisht në formën e huave marrë nga institucione financiare dhe subjekte jorezidente. Nga ana tjetër, aktivet e vendosura pranë subjekteve jorezidente shënuan rënie të ndjeshme gjatë periudhës si rezultat i tkurrjes së vendosjeve në formën e depozitave me bankat dhe institucionet financiare dhe të kreditit. Në fund të periudhës, pretendimet ndaj jorezidentëve ishin sa 22% e totalit të aktiveve, ndërsa detyrimet ndaj jorezidentëve zinin më pak se 3% të totalit të bilancit. Pozicioni kreditor neto u ngushtua si në terma absolutë, ashtu dhe relativë duke arritur në rreth 19.4% të totalit të bilancit nga 21.3% një periudhë më parë.

Grafik 37. Struktura e detyrimeve jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 38. Pozicioni neto me jorezidentët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Vija e zezë vertikale pasqyron periudhën e transformimit të degës së BKT- së në filial.

4.1.1.1 Kapitalizimi i veprimtarisë

Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar dhe asnjë bankë e sektorit nuk rezulton me një normë mjaftueshmërie nën minimumin rregullator prej 12%. Në fund të gjysmës së parë të vitit 2020, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit shënoi 18.1% nga 18.5% në dhjetor 2019 dhe në qershor 2019. Bankat me kapital evropian dhe bankat sistemike kanë nivelin më të lartë të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Bankat me kapital shqiptar kanë nivelin më të ulët të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, por kjo normë ka pasur rritje të qëndrueshme gjatë viteve të fundit. Niveli i lartë i kapitalizimit të sektorit bankar është reflektuar në shpërndarjen e normave të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas intervaleve të caktuara. Aktualisht numërohen 10 banka, nga 12 të tilla, me një normë mjaftueshmërie mbi 15% dhe asnjë bankë e sektorit bankar nuk klasifikohet në intervalin 12-14%.

Gjatë periudhës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar shënoi rënie, i ndikuar kryesisht nga rritja e aktiveve të peshuara me koeficientët e rrezikut. Por të gjitha bankat respektuan kërkesat rregullative për nivelet e kapitalit.

Bankat me rëndësi sistemike dhe me kapital evropian paraqesin tregues më të lartë të kapitalizimit të veprimtarisë.

Në fillim të muajit prill, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi[24] të pezullojë deri në fund të muajit qershor 2020 shpërndarjen e fitimit (në formën e dividendit) nga ana e bankave. Si "fitim" vendimi përcakton fitimin e mbartur nga periudhat e mëparshme, fitimin e realizuar në vitin 2019 dhe fitimin e gjashtëmujorit të parë të vitit 2020. Kjo masë e Bankës së Shqipërisë kishte për qëllim të siguronte mbështetje për kapitalin e bankave, duke forcuar aftësinë e tyre për të përthithur humbjet e mundshme, dhe për të vijuar aktivitetin kredites për ekonominë gjatë kësaj periudhe.

Grafik 39. Ecuria e treguesve të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 40. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për grupet sipas rëndësisë dhe origjinës së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në ecurinë e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, efekti negativ i rritjes së aktiveve të peshuara me rrezik ishte më i madh në krahasim me efektin pozitiv të rritjes së kapitalit rregullator. Gjatë periudhës, kapitali rregullator u rrit në nivelin 152 miliardë lekë, duke dhënë një efekt pozitiv prej 0.8 pikë përqindjeje në

[24] *Vendim qarkullues i Këshillit Mbikëqyrës nr. 24, datë 8.4.2020 "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat", Buletini Zyrtar, vëllimi 22, numër 3, prill 2020.*

normën e mjaftueshmërisë së kapitalit. Ecuria e tij u mbështet kryesisht nga rritja e rezervave dhe fitimit të pashpërndarë. Nga ana tjetër, aktivet e peshuara me rrezik arritën në rreth 839 miliardë lekë, duke u rritur me 54 miliardë lekë nga niveli i regjistruar në dhjetor 2019. Rritja në këtë tregues dha një kontribut negativ prej 1.2 pikë përqindjeje në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Grafik 41. Kontributi i zërave të mjaftueshmërisë së kapitalit (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Kontributi vjetor në rritjen e kapitalit sipas instrumenteve përbërëse (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e aktiveve të peshuara me rrezik sipas rreziqeve nuk ka ndryshuar dhe vijon të mbizotërohet nga aktivet e peshuara për rrezikun e kredisë (87%). Aktivet e peshuara për rrezikun e tregut u zgjeruan me rreth 9 miliardë lekë, ndërsa aktivet e peshuara për rrezikun operacional ruajtën nivelin e fundit të vitit të kaluar. Aktualisht, peshat e tyre në totalin e aktiveve të peshuara me rrezik, llogariten përkatësisht 3% dhe 9%.

Në krahasim me fundin e dy gjashtëmujorëve paraardhës nuk janë raportuar ndryshime të ndjeshme në strukturën e aktiveve të peshuara për rrezikun e kredisë, si për sektorin në tërësi, ashtu edhe për bankat e grupuara sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit. Bankat e klasifikuara me rëndësi sistemike paraqesin ekspozim të lartë për kredinë ndaj shoqërive tregtare (korporatave), kredinë me probleme dhe kredinë ndaj institucioneve të tjera të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Bankat e tjera (josistemike) paraqesin ekspozim edhe ndaj portofolit me pakicë (*retail*), përveç ekspozimit ndaj kredisë dhënë korporatave. Bankat me kapital evropian kanë ekspozim më të lartë për klasën "kredi për korporata dhe kredi me probleme" dhe për klasën "portofoli me pakicë" (*retail*)", ndërsa bankat me kapital vendas krahas ekspozimeve të sipërpërmendura paraqesin ndjeshmëri ndaj portofoleve të klasifikuara me rrezik më të lartë dhe të pambuluara nga luhatjet e kursit të këmbimit.

Grafik 43. Shpërndarja e aktiveve të sektorit bankar sipas raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 44. Ekspozimet e klasave të kredisë për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, qershor 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar shqiptar karakterizohet nga një raport i përshtatshëm i levës financiare gjë që konfirmon ruajtjen e një niveli të mirë të kapitalizimit. Treguesi i levës financiare[25] në qershor 2020 ishte 9.7 herë, duke regjistruar një rritje të lehtë ndaj nivelit të fundit të vitit 2019, dhe pranë mesatares së 5 viteve të fundit të barabartë me 9.9 herë. Prirja në rënie në terma vjetorë e levës financiare reflekton rritjen më të shpejtë të kapitalit aksioner në raport me ecurinë e aktivit. Nga analiza e ecurisë së levës financiare për grupe të caktuara bankash vërehet se leva e vlerësuar për bankat sistemike përcakton nivelin dhe ecurinë e levës financiare për të gjithë sektorin bankar. Bankat me kapital shqiptar kanë nivelin më të lartë të levës financiare, për shkak të nivelit më të ulët të kapitalit aksioner në krahasim me bankat me kapital të huaj.

Grafik 45. Ecuria e levës financiare sipas përbërësve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 46. Ecuria e levës financiare për bankat sipas rëndësisë sistemike dhe origjinës së kapitalit, në herë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[25] *Treguesi i levës financiare matet si raport i aktiveve ndaj kapitalit aksioner.*

4.1.1.2 Rezultati financiar

Veprimtaria e sektorit bankar rezultoi me fitim gjatë periudhës, por ky fitim ishte më i ulët se një vit më parë. Në këtë ecuri, ndikoi rritja e shpenzimeve për provigjionet e rrezikut të kredisë, veçanërisht në tremujorin e parë të vitit.

Sektori bankar e mbylli gjashtëmujorin e parë të vitit me një rezultat financiar pozitiv (me fitim), por rreth 32% më të ulët në krahasim me një vit më parë. Të ardhurat neto nga interesat dhe të ardhurat nga veprimtaritë e tjera ishin të krahasueshme me ato të të njëtës periudhë të një viti më parë, por rritja në shpenzimet për provigjione për kredinë dhe për mjetet e tjera financiare ka dhënë ndikim negativ në rezultatin financiar të bankave. Rritja në shpenzimet për provigjione për kreditë pritet të ruajë këtë kah edhe gjatë pjesës së mbetur të vitit në kushtet e krijuara nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik dhe presionet mbi aftësinë paguese të huamarrësve. Pesha e aktiveve të bankave me rezultat negativ ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar mbetet e papërfillshme.

Sektori bankar raportoi një fitim prej rreth 7.2 miliardë lekësh, gati 3.4 mld lekë më i ulët se e njejta periudhë një vit më parë. Fitim raportuan 10 nga 12 bankat e sektorit. Faktor kryesor për uljen e rezultatit financiar u raportua rritja e shpenzimeve për provigjione. Aktiviteti kryesor bankar, të ardhurat nga interesat e klientëve, nuk shfaqi ndryshime të rëndësishme, ndërsa shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë u rritën. Rënia në fitimin e sektorit është pasqyruar edhe në uljen e treguesve mesatarë të rentabilitetit të sektorit bankar: RoA ra në 0.9% nga 1.5%, ndërsa RoE ra në 9.1% (nga 14.3% një vit më parë). Performanca e sektorit bankar është përmirësuar në tremujorin e dytë të periudhës, në kushtet e veprimit të moratoriumit që "ngrin" ndryshimet në kreditë me probleme dhe provigjionet përkatëse.

Rezultati neto nga interesat rezultoi 20.7 mld lekë, thuajse në nivelin e një viti më parë. Si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet për interesa kanë qenë në nivele të krahasueshme me vitin e kaluar. Marzhi neto nga interesat ra në 3.26% nga 3.38% një vit më parë, dhe rënia ka ardhur si rezultat i rritjes së aktiveve që sjellin të ardhura.

Grafik 47. Përbërësit e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 48. ROA sipas peshës së bankave në aktivet e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera (jo nga interesat) shënuan rënie shumë të lehtë. Brenda tyre, të ardhurat nga instrumentet financiare u rritën me 0.5 mld lekë, ndërsa ato nga gjoba, komisione etj., shënuan rënie. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë u rritën me 0.6 mld lekë, duke ulur më tej fitimin.

Shpenzimet në formën e provigjioneve ishin 2.7 mld lekë, nga një vlerë thuajse zero një vit më parë, duke ndikuar negativisht në fitimin e sistemit. Shpenzimet për provigjionimin e huave u rritën nga 0.5 në 2.4 mld lekë, ndërsa ato për mjete të tjera financiare u rritën nga –0.6 (rimarrje) në 0.3 mld lekë.

Kostot e veprimtarisë u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë. Raporti i shpenzimeve të veprimtarisë ndaj të ardhurave ishte 61%, në rritje të lehtë, si pasojë e rritjes së shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë.

Kostot e veprimtarisë u mbuluan në nivele të mira nga të ardhurat e veprimtarisë.

Grafik 49. Marzhi neto nga interesi



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 50. Treguesit e përfitueshmërisë

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 51. Shpenzimet ndaj të ardhurave të veprimtarisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.1.1.3 Kredia

Gjatë periudhës, stoku i kredisë u zgjerua kryesisht si rezultat i ngadalësimit të ritmit të shlyerjeve të kredive performuese. Fshirja e kredive të humbura nga bilancet ka vazhduar, por në vlera të ulëta. Nëse do të zhvishej nga ndikimi i kursit të këmbimit dhe i fshirjeve, rritja vjetore e tepricës së kredisë në fund të periudhës, do të ishte më e lartë.

Në fund të periudhës, teprica e kredisë shënoi një nivel më të lartë sesa niveli i gjashtë muajve dhe një viti më parë duke arritur në 590 miliardë lekë[26]. Ndikimin në zgjerimin e stokut të kredisë e ka dhënë jo vetëm ecuria e kredisë së re, por edhe ngadalësimi i ritmit të shlyerjeve të kredive të klasifikuara në klasën "standard" (edhe si rezultat i moratoriumit në shlyerjen e kredive). Ecuri veçanërisht e mirë është regjistruar në portofolin e kredisë me maturitet afatgjatë, kredisë në monedhë të huaj dhe kredisë për bizneset. Në krahasim me një vit më parë, rritje veçanërisht e lartë është vërejtur në klasat performuese të kredisë për bizneset, kredisë në lekë dhe asaj me maturitet afatgjatë.

Ndryshimet rregullative të miratuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat iu mundësojnë subjekteve financiare që, për kredimarrësit në vështirësi paguese, të mos aplikojnë përkohësisht kërkesat rregullative për klasifikimin dhe provigjionimin e kredive sipas cilësisë, kanë ndikuar në zgjerimin e stokut të kredive performuese. Këto masa synojnë që nga njëra anë të mbështesin agjentët ekonomikë për të përballuar më mirë rënien e të ardhurave për shkak të ngadalësimit të ekonomisë si rezultat i pandemisë, dhe nga ana tjetër të parandalojnë ose zbusin efektet negative të kësaj situate në cilësinë e portofolit të kredisë dhe aktivitetin e ndërmjetësimit financiar në përgjithësi.

Pavarësisht efekteve pozitive të këtyre masave të materializuara në një rënie të lehtë të stokut të kredive me probleme, karakteri i tyre i përkohshëm, përmasat e goditjes dhe kohëzgjatja e situatës sugjerojnë që gjendja financiare e kredimarrësve dhe cilësia e portofolit të kredisë do të ndikohen negativisht në një masë të konsiderueshme dhe për një periudhë relativisht të gjatë kohe.

Tabelë 6. Ecuria e kredisë sipas afatit, sektorit dhe valutës

		vlera (mld lekë)	Pesha ndaj totalit të kredisë		Ndryshimi (%)	
	Periudha	06/2020	06/2020	06/2020	Gjashtëmujor	Vjetor
Sipas monedhës	Kredi në Lek	287	49	47	2.2	8.8
	Kredi në valutë	304	51	53	2.9	1.8
Sipas subjektit	Sektori publik	23	4	5	-24	-17
	Biznese	376	64	63	4.8	6.6
	Individë	192	32	32	2.5	5.6
Sipas afatit	Afatshkurter	161	27	28	-1.6	0.4
	Afatmesme	96	16	17	0.5	0.8
	Afatgjatë	334	57	55	5.4	8.9
	Stoku i kredisë	591	100	100	2.6	5.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbiçmimi i monedhave të huaja (euro dhe USD) ndaj lekut ka dhënë efekt pozitiv në kundërvlerën në lekë të kredisë në valutë (rreth 4.4 miliardë lekë), gjatë harkut kohor të një viti.

[26] *Ritmet pozitive të rritjes së tepricës së kredisë janë përllogaritur duke përjashtuar efektin statistikor të thyerjes strukturore në sektorin bankar.*

Grafik 52. Ndryshimi 6–mujor në tepricën e kredisë sipas elementeve përbërëse



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Ecuria e kredisë sipas sektorëve, kontribut në pp, ndryshime gjashtëmujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pa efektin e kursit të këmbimit, ndryshimi vjetor në tepricën e kredisë do të ishte 4.3% (nga 5.1%) dhe në tepricën e kredisë në valutë do të ishte 0.3% (nga 1.8%).

Grafik 54. Ecuria e kredisë totale pa efektin e kursit dhe fshirjeve (majtas); dhe e kredisë në valutë pa efektin e kursit (djathtas), ndryshime vjetore, në %*



*Grafikët janë ndërtuar duke përjashtuar kredinë dhënë nga BKT- dega Kosovë.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, bankat kanë vijuar procesin e fshirjes së kredive të humbura nga bilancet, por në vlera të ulëta. Vlera e kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit ishte 8.3 miliardë lekë, dhe rreth 60% e këtij fluksi është realizuar gjatë dy muajve të fundit të vitit 2019. Vëllimi i kredive të fshira gjatë 12 muajve të fundit është sa 17% e tepricës së përgjithshme të kredive me probleme të raportuar nga bankat në fund të qershorit 2020. Nëse këto fshirje nuk do të ishin realizuar gjatë vitit, rritja vjetore e stokut të kredisë do të ishte 6.6% (nga 5.1%). Duke përjashtuar njëkohësisht efektin e kursit të këmbimit dhe atë të fshirjeve, rritja vjetore e kredisë do të shënonte vlerën 5.8%.

KREDIA PËR SUBJEKTET REZIDENTE – BIZNESI

Rritja e stokut të kredisë për rezidentët është mbështetur nga rritja e kredisë për individët dhe bizneset, kryesisht në monedhë të huaj.

Kredia për bizneset rezidente ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë.

Kredia për subjektet rezidente, duke përfshirë biznese, individë dhe sektorin publik, u zgjerua me 3.5% gjatë periudhës. Kjo kredi zë rreth 96% të totalit të kredisë.

Mbi 60% e kredisë për subjektet rezidente mbahet nga sektori i biznesit. Kredia për këtë sektor është zgjeruar me 5.9% ose rreth 20 miliardë lekë, dhe në fund të periudhës arriti në rreth 360 miliardë lekë. Rritja në këtë kategori ka ardhur nga zgjerimi në stokun e kredisë afatshkurtër (kredi për kapital qarkullues dhe për blerje pajisjesh) dhe në stokun e kredisë për blerje pasurish të paluajtshme. Kredia për investime në pasuri të paluajtshme dhe ajo për blerje pajisjesh zënë peshën kryesore (secila 27%) të tepricës së kredisë për bizneset, dhe gjatë periudhës janë zgjeruar me përkatësisht 5% dhe 8%.

Grafik 55. Ecuria e kredisë për bizneset rezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vitin e fundit, bizneset kanë marrë 22% më shumë kredi të re për kapital qarkullues dhe 20% më shumë kredi të re për investime në pasuri të paluajtshme, krahasuar me një vit më parë dhe kjo rritje ka dhënë ndikimin kryesor në ndryshimin vjetor të stokut të kredisë për këto kategori.

Gjatë viteve të fundit janë vërejtur ndryshime në strukturën e kredisë për bizneset. Kategoritë "overdraft" dhe "kredi për blerje pajisjesh" kanë regjistruar rritje të portofolit në monedhën vendase dhe pakësim të portofolit në monedhë të huaj. Në stokun e kredisë për investime në pasuri të paluajtshme është vërejtur zgjerim i kredisë së dhënë në valutë dhe tkurrje e stokut të kredisë në lekë.

Grafik 56. Ecuria vjetore e kredisë për bizneset sipas qëllimit të përdorimit dhe valutës, (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e kredisë sipas madhësisë së aktivitetit gjatë periudhës, evidenton një rritje në peshën e kredisë dhënë biznesit të mesëm, përkundër rënies në peshën e biznesit të madh. Biznesi i vogël nuk regjistron ndryshime thelbësore[27]. Ndërkohë, analiza sipas afatit dështon se të tre llojet e bizneseve kanë ulur peshën e kredisë afatshkurtër, ndërsa biznesi i vogël dhe i madh kanë rritur atë afatgjatë[28]. Biznesi i mesëm ka rritur peshën e kredisë afatmesme, përkundër rënies së asaj afatshkurtër dhe afatgjatë.

Grafik 57. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për subjektet rezidente – Individët dhe sektori publik

Kredia për individët rezidentë u zgjerua me 2.5% gjatë periudhës. Rritja më e shpejtë është regjistruar në kredinë për pasuri të paluajtshme, e cila ka pasur kontributin kryesor në ecurinë e kredisë për individët për periudhën. Teprica e kredisë për pasuri të paluajtshme u rrit me rreth 3.5% gjatë periudhës dhe 6% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 120 miliardë lekë.

Gjatë periudhës 2015-2018 është vënë re rritje e vazhdueshme e kredisë për individë nga njëra anë, dhe pakësim i stokut të kredisë për biznese nga ana tjetër. Kjo ecuri, pavarësisht rifillimit të huamarrjes më të lartë nga bizneset, ka sjellë ndryshime në strukturën e kredisë sipas sektorëve, në favor të kredisë për individë. Kredia për individë në qershor 2020 zinte 34% të tepricës së kredisë, nga 27% në vitin 2015.

[27] *Këto vlera shënonin përkatësisht: 51.5% (B. i madh); 25.0% (B. i mesëm) dhe 23.6% (B. i vogël) në dhjetor 2019; ndërsa në qershor 2019, ato ishin përkatësisht: 51.9%; 23.1%; dhe 25.0%.*

[28] *Në terma vjetorë, biznesi i vogël ka rritur peshën e kredisë afatgjatë (3.3%), ndërsa biznesi i mesëm dhe ai i madh kanë rritur peshën e kredisë afatshkurtër (7.3% përkatësisht).*

Grafik 58. Ecuria e kredisë për individët rezidentë sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia për sektorin publik vijon të përbëjë një peshë shumë të ulët në totalin e kredive (3%), ndërkohë që gjatë vitit të fundit, kjo kredi është pakësuar me rreth 15%.

KREDIA PËR SUBJEKTET JOREZIDENTE

Kredia për subjektet jorezidente ka vijuar të shënojë rënie edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Në fund të muajit qershor, kredia për jorezidentët ishte rreth 20 miliardë lekë dhe zinte 3.4% të tepricës së kredisë së sektorit bankar, nga 4% në fund të gjashtëmujorit paraardhës. Sipas sektorit, afatit dhe monedhës, rënia më e madhe është regjistruar në kredinë për bizneset, kredinë në monedhë të huaj dhe kredinë afatgjatë, të cilat janë kategoritë me peshë të madhe në stokun e kredisë për subjektet jorezidente.

Grafik 59. Kredia për rezidentët dhe jorezidentët (majtas); dhe kredia për jorezidentët sipas afatit (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Kredia e pambrojtur në valutë ka vijuar rënien, duke u tkurrur me 5% gjatë periudhës dhe rënia është kontribuar kryesisht nga kredia e marrë nga bizneset për qëllime tregtie. Ndërkohë, kredimarrësit "individë" kanë zgjeruar stokun e kredisë së pambrojtur në valutë gjatë periudhës. Si rezultat, pesha e kredisë së pambrojtur ndaj tepricës së përgjithshme të kredisë është tkurrur lehtë gjatë periudhës (me 1.6 p.p) në 21%, ndërsa pesha e saj ndaj portofolit të kredisë në valutë ra në 41% nga 45% në dhjetor 2019.

Edhe pse në rënie të vazhdueshme, ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit vijon të mbetet në nivele të larta dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm.

HAPËSIRË INFORMUESE 2. SEKTORI BANKAR DHE KREDIA E PAMBROJTUR NË VALUTË

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, kredia e pambrojtur në valutë ra me 6 miliardë lekë, në nivelin 125 miliardë lekë, kryesisht për shkak të tkurrjes së kredisë së pambrojtur në monedhën evropiane (me 4.6%). Kredia e pambrojtur në USD ka regjistruar gjithashtu rënie gjatë periudhës (me 6%), por për shkak të peshës së ulët në totalin e kredisë së pambrojtur, kontributi i saj është i vogël. Kredia për bizneset përbën 66% të tepricës së kredisë në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ndërsa kredia për individët dhe ajo për qeverinë zënë përkatësisht 30% dhe 4%.*

Tkurrja e tepricës së kredisë së pambrojtur lidhet kryesisht me rënien me 7% të kredisë së pambrojtur për bizneset. Kredia e pambrojtur për individët gjatë periudhës u rrit me rreth 3%, ndërsa ajo për qeverinë u tkurr me 23%. Në terma vjetorë, kredia e pambrojtur në valutë u tkurr me 8%, si pasojë e rënies në kredinë për bizneset dhe në kredinë në monedhën euro.

Grafik 60. Ecuria e kredisë së pambrojtur në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 61. Përbërja e kredisë së pambrojtur në valutë sipas qëllimit të përdorimit (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Kredia e pambrojtur e dhënë për investime në pasuri të paluajtshme vijon të mbajë peshën kryesore (rreth 54%) të totalit të kredisë së pambrojtur në valutë, pasuar nga kredia për tregti (me 26%). Pjesa tjetër e kredisë së pambrojtur në valutë është dhënë për zhvillim biznesi, konsum dhe qëllime të tjera. Kontribut në ecurinë e tepricës së kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit

gjatë periudhës dhanë: rënia e kredisë së pambrojtur për "tregti" dhe kredisë për "qeverinë", përkatësisht me 16% dhe 23%. Kredia e pambrojtur në valutë për "investime në pasuri të paluajtshme" ishte e vetmja kategori e kredisë së pambrojtur që shënoi rritje gjatë periudhës (+2%).

Grafik 62. Ecuria gjashtëmujore e kredisë së pambrojtur në valutë (kontributi sipas sektorëve)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 63. Kredia e pambrojtur në valutë për pasuri të paluajtshme dhe cilësia e saj



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme është dhënë për blerje të pasurive të paluajtshme rezidenciale dhe komerciale dhe për blerje toke. Peshën kryesore të saj e zë kredia e pambrojtur për pasuri të paluajtshme rezidenciale dhënë individëve (47%), e cila u zgjerua me 4% gjatë periudhës dhe dha kontributin kryesor në ecurinë e kredisë së pambrojtur për pasuri të paluajtshme për periudhën. Ndërkohë, kredia për pasuri të paluajtshme komerciale (pesha e së cilës në totalin e kredisë së pambrojtur për pasuri të paluajtshme shënon 35%) ka rënë gjatë gjysmës së parë të vitit. Mbiçmimi i kursit të këmbimit të euros dhe dollarit amerikan ka dhënë një efekt pozitiv në vlerën e raportuar të kredisë së pambrojtur në valutë. Në mungesë të nënçmimit të kursit të këmbimit të monedhës vendase, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, kredia e pambrojtur në valutë do të ishte tkurrur me 7% nga 4.6%.

* *Teprica e kredisë në euro për të cilën të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, zë 88% të tepricës së kredisë të pambrojtur në valutë.*

KREDIA E RE

Gjatë periudhës është vënë re rënie e kredisë së re, në lekë dhe në valutat kryesore, e ndikuar kryesisht nga kredia në formën "overdraft" për bizneset.

Kredia e re e dhënë nga bankat gjatë gjysmës së parë të vitit 2020 ishte rreth 100 miliardë lekë, në rënie me 25% gjatë periudhës dhe gati 15% kundrejt një viti më parë. Rënia është vënë re në monedhën Lek dhe në valutat kryesore. Mbyllja e aktivitetit tek shumë biznese në vijim të kufizimeve për mospërhapjen e pandemisë, gjatë periudhës mars-maj të këtij viti, dhe situata e vështirë ekonomike e krijuar në vend dhe në botë, kanë ulur kërkesën e bizneseve, por edhe të individëve për kredi të re, pavarësisht rënies së normës mesatare të interesit. Fluksi i raportuar i kredisë së re gjatë këtyre muajve shënoi nivele më të ulëta se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Tkurrja në fluksin e kredisë së re gjatë periudhës është ndikuar kryesisht nga rënia e kredisë për sektorin e bizneseve (rreth 23%), i cili ka pakësuar kërkesën për kredi afatshkurtër, dhe kryesisht atë të formës "overdraft". Kredia e dhënë për këtë qëllim zë peshën kryesore në kredinë e re për bizneset (36%).

Kredia e re e akorduar për individët ishte rreth 20% më pak në krahasim me fluksin e gjashtëmujorit të kaluar. Ky zhvillim është ndikuar nga tkurrja e fluksit të kredisë për blerje banesash. Kredia e re për blerje banesash zë peshën kryesore të kredisë së re dhënë individëve (42%). Rreth 60% e kredisë së re përfaqësohet nga kredia në monedhën vendase, ndërkohë që rënia e fluksit është konstatuar si në kredinë e re në lekë, ashtu edhe atë në valutë.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës ka shënuar rënie.

Rënia më e fortë në normën mesatare të interesit është regjistruar për kredinë e re në lekë dhe për kredinë e re për bizneset.

Grafik 64. Kredia e re për bizneset (majtas) dhe individët (djathtas) sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma e peshuar e interesit për kreditë e reja të dhëna gjatë periudhës[29] shënoi rënie, e ndikuar nga të gjitha llojet e kredisë. Norma mesatare e peshuar e interesit të kredive të reja në qershor ishte rreth 0.5 pikë përqindje më e ulët sesa ajo e regjistruar në dhjetor 2019. Rënia më e fortë në normën mesatare të interesit është regjistruar në normat e interesit për kredinë e re në lekë dhe në ato për kredinë e re për bizneset. Në qershor 2020, norma e peshuar e interesit regjistroi vlerën 5.0%, ndërsa gjatë periudhës ajo është luhatur rreth nivelit 5.2%.

Grafik 65. Ecuria e normës së peshuar të interesit për kreditë e reja



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të klasifikuara sipas monedhës, norma e interesit për kreditë e reja në lekë vijon të shënojë nivele më të larta se dy monedhat e tjera (euro dhe USD), por kjo normë interesi ka shfaqur një prirje të dallueshme

[29] *E llogaritur si mesatare gjashtëmujore.*

rënëse gjatë vitit të fundit. Në qershor 2020, norma e interesit të kredive të reja në lekë shënoi 5.4%, nga 6.0% një vit më parë. Kjo ecuri është ndikuar në mënyrë të veçantë nga politikat akomoduese të ndërmarra nga banka qendrore, e cila në muajin mars uli normën bazë të interesit, nga 1.0% në 0.5%.

Norma e interesit për kredinë e re për individët vijon të mbetet më e lartë në krahasim me atë të kredisë për bizneset. Gjatë periudhës, kjo normë është luhatur rreth nivelit 5.7%, dhe vlera e regjistruar në muajin qershor mbetet nën nivelin e shënuar në dhjetor 2019. Norma mesatare e kredive të reja për sektorin e biznesit është luhatur rreth vlerës mesatare prej 5% gjatë gjysmës së parë të vitit[30].

Grafik 66. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas monedhës



Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafik 67. Ecuria e normave të interesit për kreditë e reja, sipas subjektit



Burimi: Banka e Shqipërisë

4.1.1.4 Depozitat

Depozitat e mbajtura në sektorin bankar kanë shënuar norma të larta rritjeje gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Rritja është mbështetur nga depozitat e individëve në formën e llogarive rrjedhëse dhe të depozitave pa afat, të mbajtura kryesisht në monedhën vendase. Në fund të muajit qershor, niveli i depozitave shënonte rreth 1,230 mld lekë, duke u rritur me 30 mld lekë gjatë periudhës dhe me 70 mld lekë në krahasim me një vit më parë. Rreth gjysma e stokut të përgjithshëm të depozitave përbëhet nga depozitat me afat, të cilat, me përjashtim të disa luhatjeve të vogla, kanë ruajtur të njëjtin nivel që nga fundi i vitit 2018. Si rezultat, pesha e depozitave me afat ndaj stokut të përgjithshëm të depozitave ka vijuar të bjerë, ndërsa pesha e depozitave pa afat dhe e llogarive rrjedhëse është rritur.

30 *Ndërkohë, norma mesatare e peshuar e interesit për kredinë dhënë bizneseve gjatë gjysmës së dytë të 2019-ës, shënoi nivelin 5.2%.*

Tabelë 7. Të dhëna mbi ecurinë e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës

Periudha	Qershor'20		Qershor'20/ Dhjetor'19		Janar - Qershor'20/ Janar - Qershor'19	
Lloji i depozitës	Mld lekë	Pesha ndaj totalit (%)	Ndryshim (%)	Kontribut (p.p.)	Ndryshim (%)	Kontribut (p.p.)
Llogari rrjedhëse	443	36	7	3	11	4
Depozita pa afat	156	13	5	1	21	2
Depozita me afat	614	50	-	-	-	-
Sektori publik	32	3	18	0	19	0
Biznese	167	14	3	0	5	1
Individë	1,031	84	3	2	6	5
Depozita në lekë	607	49	5	2	6	3
Depozita në valutë	623	51	1	1	7	3
Stoku i depozitave	1,230	100	3	3	6	6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e rritjes vjetore të stokut të depozitave gjatë periudhës, ishte rreth 6%, ndërkohë që për vitet 2018 dhe 2019 kjo normë nuk e ka kaluar vlerën +0.5%. Depozitat në monedhën vendase kanë ruajtur normat pozitive të rritjes vjetore të vërejtura që në muajt e parë të vitit 2019, dhe zgjerimi i tyre ka qenë veçanërisht i shpejtë gjatë tremujorit të dytë të vitit. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, depozitat në valutë regjistruan një nivel të krahasueshëm me atë të fundit të vitit të kaluar dhe kanë dhënë një kontribut modest në rritjen e depozitave gjatë periudhës. Lëvizjet e forta në kursin e këmbimit të lekut me monedhat USD dhe euro gjatë muajve mars dhe prill rezultuan në efekte të konsiderueshme, por me kahe të kundërta të kursit në kundërvlerën në lekë të depozitave në valutë. Efekti statistikor i kursit gjatë kësaj periudhe ishte pozitiv dhe në vlera dukshëm më të larta në krahasim me dy gjashtëmujorët e mëparshëm.

Rritja e depozitave ka qenë e lartë gjatë periudhës, e mbështetur kryesisht nga depozitat pa afat të individëve dhe në monedhën vendase.
Pesha e depozitave pa afat dhe llogarive rrjedhëse vijon të zgjerohet përkundër rënies së peshës së depozitave me afat.

Rritja e llogarive rrjedhëse dhe e depozitave pa afat ka vijuar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2020. Në krahasim me një vit më parë, gjatë kësaj periudhe llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat u zgjeruan me mesatarisht 11% dhe 21%, ndërsa në krahasim me fundin e vitit 2019, këto depozita ishin përkatësisht 7% dhe 5% më të larta. Pas një periudhe disavjeçare rënieje të vazhdueshme, depozitat me afat janë stabilizuar pranë nivelit 610-615 miliardë lekë, që ka mbetur pothuajse i pandryshuar që nga fundi i vitit 2018. Normat e interesit për depozitat me afat në lekë dhe në valutë vijojnë të mbeten në nivele të ulëta dhe niveli mesatar i tyre ka mbetur pothuajse i pandryshuar gjatë gjysmës së parë të vitit. Depozitat e individëve përbëjnë rreth 85% të totalit të depozitave dhe kanë vijuar të japin kontributin kryesor në rritjen e depozitave gjatë periudhës.

Grafik 68. Ecuria e depozitave sipas afatit, sektorit dhe valutës (kontributi në normën vjetore të ndryshimit)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Depozitat në lekë dhe ato në valutë kanë kontribuar në pothuajse të njëjtën masë në rritjen mesatare vjetore të depozitave gjatë gjysmës së parë të vitit. Gjatë 5 viteve të fundit, si depozitat në lekë, ashtu edhe ato në euro që zënë mbi 90% të depozitave në valutë, kanë ruajtur prirje pozitive dhe të krahasueshme të rritjes, por rritja e depozitave në lekë ka qenë disi më e shpejtë gjatë 12 muajve të fundit. Rritja vjetore e depozitave në euro ka qenë vazhdimisht pozitive, por norma e rritjes së depozitave në valutë është ndikuar negativisht nga ndryshime strukturore si edhe nga efekti statistikor i kursit të këmbimit. Ky i fundit, për shkak të mbiçmimit të fortë të monedhës vendase ndaj dy valutave kryesore ka bërë që stoku i depozitave në valutë i konvertuar në lekë të shënojë norma negative rritjeje gjatë pjesës më të madhe të viteve 2018-2019. Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, dhe veçanërisht gjatë tremujorit të dytë, si pasojë e nënçmimit të përkohshëm të monedhës vendase, efekti statistikor i kursit mbi vlerën e raportuar të depozitave, ka qenë pozitiv.

Grafik 69. Ecuria e depozitave në lekë dhe në euro (në mld njësi)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 70. Efekti i kursit të këmbimit në depozitat në valutë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga të dhënat e detajuara të depozitave të individëve sipas valutës dhe afatit vërehet që depozitat me afat në lekë kanë mbetur pothuajse të pandryshuara, ndërsa ato me afat në valutë paraqesin një prirje të dallueshme në rënie. Për depozitat pa afat,[31] rritja më e fortë vijon të vërehet në pjesën në valutë të stokut të depozitave. Që nga fundi i vitit 2017, stoku i depozitave pa afat të individëve në valutë është zgjeruar me rreth 40%, ndërsa ai i depozitave në lekë me rreth 30%. Rënia në stokun e depozitave me afat, si për pjesën në lekë, ashtu edhe për atë në valutë nuk e kalon vlerën 10%.

Grafik 71. Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës (indeks)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 72. Ecuria e depozitave të individëve sipas afatit dhe valutës (kontribut në rritjen vjetore)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat e interesit për depozitat me afat në lekë janë luhatur rreth nivelit 0.7% gjatë gjysmës së parë të vitit, duke shënuar rënie të lehtë ndaj vlerës mesatare të vitit të kaluar. Për depozitat me afat në euro, amplituda e normës mesatare të interesit të depozitave me afat ka qenë më e lartë në krahasim me periudhat e kaluara, por prirja për rënie e këtyre normave, duket se ka vijuar edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit.

Grafik 73. Flukset e depozitave të reja dhe norma mesatare e interesit për depozitat me afat në lekë dhe euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[31] *Për të lehtësuar interpretimin këtu janë përfshirë edhe llogaritë rrjedhëse.*

HAPËSIRË INFORMUESE 3. INDEKSI I SHËNDETIT BANKAR

Indeksi i shëndetit bankar përfaqëson një vlerësim të përgjithshëm të kushteve bazë dhe faktorëve të qenësishëm të rrezikut që ndikojnë në stabilitetin e sektorit bankar dhe atë të bankave individuale. Indeksi përbëhet nga pesë tregues, të cilët përfaqësojnë pesë dimensione të sektorit bankar: kapitali; cilësia e aktiveve; përfitueshmëria; likuiditeti dhe eficienca (MISHRA et al. (RBI); 2013):

Indeksi përmbledhës i treguesve kryesorë që përdoren për të ndjekur ecurinë dhe situatën e stabilitetit bankar është përkeqësuar lehtësisht gjatë periudhës dhe në krahasim me një vit më parë. Vlera e tij u ngjit në nivelin 0.44, nga 0.42 në dhjetor 2019 dhe 0.43 që shënonte në fund të qershorit 2019. Treguesit përbërës të indeksit, të cilët kanë shfaqur ecuri më të dobët, vitin e fundit janë: likuiditeti dhe përfitueshmëria. Kjo e fundit ka dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e vlerës së indeksit të shëndetit të bankave, duke arritur në 0.59 nga 0.48 në qershor 2019. Përkeqësimi i treguesit të përfitueshmërisë përgjatë një viti, është ndikuar nga rënie në fitimin e bankave. Në të njëjtën kohë, rënie është vënë re edhe për marzhin neto nga interesat.*

Treguesi i përfitueshmërisë jep kontributin kryesor në rrezik, i cili gjatë dy viteve të fundit raporton përkeqësim të vazhdueshëm dhe për rrjedhojë rritje të kontributit në rrezik. Treguesi i likuiditetit gjithashtu ka pasur ecuri të dobët vitin e fundit, ndikuar nga rënia e raportit të aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve. Cilësia e aktiveve paraqitet e përmirësuar dhe kontributi i këtij treguesi në rrezik ka shënuar rënie. Që prej fillimit të vitit 2015, kontributi i këtij treguesi në rrezik ka rënë ndjeshëm dhe në mënyrë të vazhdueshme, duke shkuar nga niveli 0.71 në mars 2015 në nivelin 0.44 në qershor 2020. Përmirësimin më të dukshëm në harkun kohor të një viti e ka treguesi "eficienca", i cili reflekton një menaxhim më eficient të shpenzimeve të shprehur në rënie të shpenzimeve të veprimtarisë dhe kryesisht të atyre për personelin, duke kontribuar në përmirësimin e shëndetit të bankave. Treguesi i "kapitalit" raporton shëndet të njëjtë me atë të një viti më parë, dhe vlera e tij ka mbetur e pandryshuar krahasuar me periudhën paraardhëse dhe një vit më parë. Brenda nëntreguesve të kapitalit evidentojmë zgjerim të levës financiare, zgjerim të raportit "kapitali bazë ndaj kapitalit rregullator" dhe rënie të lehtë në raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Grafik 74. Indeksi i shëndetit bankar*



*Rritja e vlerës së treguesit tregon stabilitet më të ulët. Gjerësia e çdo dimensioni nënkupton kontributin e tij ndaj rrezikut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 75. Harta e shëndetit bankar*



*Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë gjashtë viteve të fundit (2013-2019), indeksi i agreguar i shëndetit bankar ka regjistruar prirje në rënie, që do të thotë përmirësim i shëndetit dhe qëndrueshmëri më e lartë e bankave. Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, indeksi i agreguar i shëndetit bankar shfaq ecuri më të dobët, e cila vlen të monitorohet vazhdimisht për të parandaluar rreziqet që mund t'i kanosen sektorit bankar.

Indeksi i shëndetit për bankat sistemike është përkeqësuar në krahasim me një vit më parë. Për këtë grup bankash vërehet përkeqësim në treguesin e "përfitueshmërisë" dhe atë të "eficencës", ndërkohë që "cilësia e aktiveve" dhe "likuiditeti" janë përmirësuar. Bankat e tjera (josistemike) raportojnë përmirësim të indeksit në harkun kohor të një viti. Përmirësimi reflekton përmirësimin e likuiditetit, cilësisë së aktiveve dhe eficiencës. Ndërkohë, treguesi i kapitalizimit dhe ai i përfitueshmërisë paraqesin shëndet më të dobët për këtë grup bankash në harkun kohor të një viti. Bankat sistemike kanë vlerën më të ulët të indeksit, gjë që tregon shëndet më të mirë dhe stabilitet më të lartë në krahasim me grupin tjetër të bankave.

Grafik 76. Harta e shëndetit bankar e ndarë në grupe, sipas rëndësisë sistemike të bankave



Larg nga qendra nënkupton rritje të rrezikut, në një interval nga 0 në 1
Burimi: Banka e Shqipërisë.

* *Rënia e vlerës së indeksit nënkupton përmirësim të shëndetit bankar dhe anasjelltas.*

4.1.2 RREZIQET E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT BANKAR

4.1.2.1 Rreziku i kredisë

Edhe pse me ritme të ngadalta, cilësia e kredisë vijoi të përmirësohej në gjashtëmujorin e parë të vitit. Megjithatë, ky tregues kërkon monitorim të vazhdueshëm, pasi efektet negative të shkaktuara nga pandemia, pritet të jenë të dukshme në periudhën në vijim.

Në fund të periudhës, stoku i kredive me probleme ishte rreth 48 miliardë lekë, pothuaj i pandryshuar gjatë periudhës. Ndikimin kryesor në këtë qëndrueshmëri të vlerës së kredive me probleme, e kanë dhënë përcaktimet në moratoriumin e shlyerjes së kredive, të cilat iu kanë dhënë mundësi bankave të pezullojnë përkohësisht evidentimin e kredive me probleme dhe ndryshimet brenda tyre. Në këto nivele, kredia me probleme është rreth 24% më e ulët se niveli i një viti më parë. Kjo rënie e kredive me probleme gjatë 12 muajve të fundit,

e përqendruar në gjysmën e dytë të vitit 2019, është ndikuar nga fshirjet e kredive[32], shlyerjet dhe ristrukturimi i tyre.

Në mars 2020, në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik për shkak të pandemisë dhe vështirësive të pritshme të kredimarrësve për të përballuar pagesat e kredive, Banka e Shqipërisë ndërmori disa masa dhe ndryshime rregullative, të cilat synojnë lehtësimin e barrës së kredimarrësve të ndikuar nga pandemia, rritjen e rezistencës financiare të bankave dhe vijimin e aktivitetit kreditues nga ana e sektorit bankar. Këto masa konsistonin në:

- nxjerrjen e një moratoriumi, që mundëson pezullimin e përkohshëm të pagesave të shlyerjes së kredive për huamarrësit e ndikuar nga pandemia, fillimisht deri në fund të majit 2020, dhe më tej deri në fund të gushtit 2020;
- miratimin e ndryshimeve rregullative që iu mundësojnë bankave të ruajnë klasifikimin e kredive dhe nivelet e provigjioneve të kredive me probleme, gjatë kësaj periudhe. Qëllimi është që, deri në fund të këtij viti, bankat dhe klientët e tyre huamarrës të gjejnë forma ristrukturimi të kredive të caktuara që rivendosin shpejt aftësinë paguese të kredimarrësve të ndikuar nga pandemia;
- pezullimin e shpërndarjes së fitimit të bankave deri në fund të këtij viti, me qëllim që në rast materializimi të humbjeve financiare, madhësia e kapitalit të jetë e përshtatshme jo vetëm për të përthitur humbjet, por edhe për të mbështur kredidhënien e re.

Masat e mësipërme, janë të ngjashme me ato të rekomanduara nga institucionet ndërkombëtare si edhe të marra në vende të ndryshme të botës. Duke qenë se këto masa janë të përkohshme dhe ecuria e pandemisë është e pasigurt, është e nevojshme që kjo periudhë të shfrytëzohet nga bankat për të administruar në mënyrë të përshtatshme dhe transparente rrezikun e kredisë, duke provigjionuar në mënyrë të kujdesshme. por aktive.

Për shkak të 'ngrirjes' së kredive me probleme dhe vijimit të kreditimit, raporti i kredive me probleme (RKP) zbriti në 8.1% në fund të periudhës, nga 8.4% në fund të vitit të kaluar. Në kushtet kur disa nga bankat kanë vijuar të provigjionojnë veçanërisht në tremujorin e parë të vitit, raporti i mbulimit të kredive me probleme me provigjione u ngjit në 65%, nga 59% që shënonte në muajin dhjetor 2019. Fshirjet e kredive me probleme gjatë periudhës kanë qenë të papërfillshme. Përmirësimi në cilësinë e kredisë për periudhën është vërejtur kryesisht në portofolin e kredisë për biznese, kredisë në valutë dhe kredisë me maturitet afatshkurtër.

[32] *Fshirja e kredive të humbura nga bilancet e bankave u intensifikua gjatë muajve të fundit të vitit të kaluar, ndikuar kryesisht nga ndryshimet rregullative që ulën në 2 vjet maksimumin e kohës së qëndrimit në bilanc të kredive të klasifikuara si 'të humbura'. Gjatë 12 muajve të fundit, janë fshirë rreth 8.3 miliardë lekë kredi të humbura, të përfaqësuara kryesisht nga kreditë e bizneseve në valutë. Gjithsej, që nga fillimi i procesit të fshirjes (janar 2015), janë fshirë 65 miliardë lekë kredi të humbura (e cila është sa 140% e vlerës aktuale të kredive me probleme).*

Grafik 77. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 78. Struktura e kredive me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahasuar me një vit më parë, raporti i kredive me probleme ra me 3.1 pikë përqindje dhe rënia reflekton kryesisht tkurrjen në stokun e kredive me probleme. Vitin e fundit është vënë re një zhvendosje e peshës midis klasave të kredive me probleme, nga klasa "nënstandard" drejt atyre me rrezik më të lartë. Pesha e kredive "të humbura" dhe atyre "të dyshimta" në stokun e kredive me probleme u ngjit në përkatësisht 47.3% dhe 24%, nga 45% dhe 20% një vit më parë.

Për të gjitha ndarjet sipas afatit, subjektit dhe monedhës, është vënë re përmirësim i konsiderueshëm në cilësinë e këtij aktivi në harkun kohor të një viti. Cilësia e kredisë paraqitet më e dobët për kredinë për bizneset, kredinë në valutë dhe kredinë me afat të mesëm maturimi, megjithatë për dy ndarjet e para është vënë re rënia më e fortë në stokun e kredive me probleme.

Grafik 79. Raporti i kredive me probleme sipas sektorit, monedhës dhe afatit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për kredinë në valutë të pambrojtur nga luhatjet në kursin e këmbimit, cilësia është përmirësuar ndjeshëm ndaj një viti më parë dhe është rritur lehtë gjatë periudhës. Rolin kryesor në këtë ecuri e ka pasur zvogëlimi i stokut të kredive me probleme. RKP-ja për këtë lloj kredie shënoi 7.9% në fund të periudhës (nga 10.9% në qershor 2019), diktuar kryesisht nga ecuria e kredisë së pambrojtur për blerje pasurish të paluajtshme, në monedhën evropiane.

Sipas qëllimit të përdorimit, kredia me probleme e pambrojtur për investime në pasuri të paluajtshme zë peshën kryesore në totalin e kredisë me probleme të pambrojtur (62%), dhe mban njëkohësisht nivelin më të lartë të RKP-së (9%). Megjithatë, cilësia e kredisë për këtë ndarje është përmirësuar ndjeshëm, me 3.8 pikë përqindje, përgjatë një viti. Ecuri pozitive në cilësinë e kredisë është regjistruar edhe për ndarjet e tjera të kredisë së pambrojtur, ku në harkun kohor të një viti, RKP-ja u ul:

- në nivelin 9% (nga 13%) për kredinë e pambrojtur për zhvillim biznesi,
- në 7.5% (nga 10.3%) për kredinë e pambrojtur për tregti,
- në 3.7% (nga 4.9%) për kredinë e pambrojtur konsumatore.

Grafik 80. RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 81. RKP për kredinë e pambrojtur ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për portofolin e kredisë së dhënë për jorezidentët, cilësia e kredisë mbetet në nivele të administrueshme dhe vitin e fundit stoku i kredive me probleme ka shënuar rënie. Gjatë periudhës, cilësia e kredisë për jorezidentët mbeti e pandryshuar dhe RKP-ja shënoi nivelin prej 3%. Stoku i kredive me probleme për këtë kategori është i gjithi i klasifikuar në klasën e kredive të humbura. Pothuajse i gjithë stoku i kredive me probleme për subjektet jorezidente mbahet nga bizneset dhe këto kredi janë lëvruar në monedhën evropiane.

Gjatë periudhës, masa e mbulimit të kredive me probleme me fonde rezervë u zgjerua me 5.8 pikë përqindje, duke reflektuar zgjerimin me 9% në stokun e fondeve rezervë. Raporti i provigjionimit për bankat individuale luhatet midis intervalit 50% dhe 85%.

Grafik 82. Ecuria në kohë e raportit të provigjionimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 83. Ndryshimi vjetor i stokut të kredive me probleme dhe RKP për subjektet jorezidente



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbulimi me kapital i kredive me probleme neto[33] u zgjerua në 9.1 herë nga 7.4 herë në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019. Ky zgjerim reflektoi kryesisht rënien e shpejtë në kredinë me probleme neto[34]. Në qershor 2020, raporti i kredive me probleme neto ndaj tepricës së kredisë shënoi 2.8% duke qenë, rreth 0.6 pikë përqindje më pak sesa raporti i muajit dhjetor 2019.

Mbulimi me kolateral i kredisë, që përfaqëson një element kritik në instrumentet mbrojtëse të sektorit bankar nga rreziku i moskthimit të huasë, ka vijuar të zgjerohet edhe gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit, duke regjistruar nivelin më të lartë që prej vitit 2012 (rreth 80%). Krahasuar me një vit më parë, raporti i mbulimit me kolateral[35] të kredive u rrit me rreth 2.6 pikë përqindje. Kreditë me kolateral në formën e pasurive të paluajtshme zënë peshën kryesore, rreth 66% të kredisë së kolateralizuar dhe 53% të tepricës së kredisë. Stoku i kësaj lloj kredie u zgjerua me rreth 5.3% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, teprica e kredisë së pakolateralizuar është tkurrur me rreth 7% krahasuar me qershorin 2019.

Cilësia e kredisë së kolateralizuar ka vijuar të përmirësohet gjatë periudhës dhe krahasuar me një vit më parë. RKP-ja për kredinë e kolateralizuar shënoi 7.2% në fund të vitit, nga rreth 10.7% një vit më parë. Rënia në stokun e kredive me probleme për kredinë e kolateralizuar ka nisur që prej vitit 2016. Në krahasim me një vit më parë, raporti i kredive me probleme për kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme "tokë" shënoi rënien më të shpejtë, me rreth 6.6 pikë përqindje në nivelin 11.7%. Ky është niveli më i ulët i raportuar gjatë dhjetë viteve të fundit.

[33] *Kreditë me probleme pas zbritjes së provigjioneve.*

[34] *Si rrjedhojë e tkurrjes së tepricës së kredive me probleme neto me gati 15% dhe zgjerimit të kapitalit rregullator me rreth 4%, raporti "kredi me probleme neto/kapitali rregullator" ra në 11% nga 13% që shënonte në fund të vitit 2019.*

[35] *Kolateral në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), para në dorë etj.*

Cilësia e kredisë paraqitet në përmirësim të vazhdueshëm edhe për kreditë e tjera të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme, duke regjistruar nivelet më të ulëta të raportit të kredive me probleme gjatë dekadës së fundit. Kredia e kolateralizuar me para fizike vijon të mbajë nivelin më të ulët të raportit të kredive me probleme (0.5%) dhe në të njëjtën kohë peshën më të ulët të kredisë së kolateralizuar. Edhe cilësia e kredisë së pakolateralizuar ka shënuar përmirësim në krahasim me fundin e periudhës paraardhëse dhe në krahasim me një vit më parë. Megjithatë, kjo lloj kredie mban nivelin më të lartë të raportit të kredive me probleme (11.9%).

Grafik 84. Teprica e kredisë dhe raporti i kredive me probleme, sipas llojit të kolateralit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 4. EFEKTET E MASAVE PËR KLASIFIKIMIN E HUASË, PROVIGJIONIMIN DHE KONTABILIZIMIN – PËRVOJA NDËRKOMBËTARE

Shumica e vendeve që kanë zbatuar masa/instrumente lehtësuese për huamarësit dhe trajtimin përkatës prudencial, i kanë bërë këto përgjithësisht në përputhje me instruksionet e Komitetit të Bazelit, Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Kontabilitetit (IASB), dhe më tej të autoriteteve përgjegjëse rajonale/kombëtare. Për klasifikimin e kredisë si 'me probleme', veçanërisht për elementin që lidhet me 90 ditë në vonesë, instruksionet sugjerojnë që kjo të lidhet me 'skedulin e ndryshuar të pagesës', pra duke konsideruar detyrimet e ndryshuara të borxhit pas zbatimit të masës lehtësuese. Në këtë mënyrë, përsa kohë që moratoriumi është në fuqi dhe pagesat e kredisë janë pezulluar, numërimi i 'ditëve në vonesë' për kredinë ndërpritet. Po kështu, edhe elementi tjeter i klasifikimit të kredisë që lidhet me 'paaftësinë për të paguar' të huamarrësit (pavarësisht se nuk ka mbushur 90 ditë vonesë në pagesë), duhet të bazohet në vlerësimin e bankës nëse huamarrësi është i paaftë të paguajë sipas skedulit të ndryshuar të pagesave të kredisë. Përsa kohë që banka vlerëson se vështirësitë në pagesë të huamarrësit janë të përkohshme dhe adresohen mjaftueshëm me riskedulimin e pagesave, huatë mund të mbeten në të njëjtën kategori klasifikimi, me kërkesa të pandryshuara provigjionimi.

Në lidhje me kontabilizimin, standardi që përdoret në shumë vende të botës, duke përfshirë edhe vendet anëtare të Bashkimit Evropian, është IFRS 9. Ky

standard ka hyrë në fuqi në 1 janar 2018 dhe po përmbushet përmes një faze tranzitore. Në SHBA, Bordi i Standardeve Financiare të Kontabilitetit (FASB) ka adoptuar kuadrin e tij të humbjeve të pritshme të kredisë, i njohur si Current Expected Credit Losses (CECL). Për bankat e mëdha amerikane (të listuara në bursë) kuadri hynte në fuqi në 1 janar 2020, ndërsa për të tjerat hyn në fuqi në 1 janar 2022, gjithmonë përmes një faze tranzitore.

IFRS 9 i ndan huatë në tre kategori: performuese/standard (Klasa 1), nënstandard (Klasa 2) dhe joperformuese/impaired (Klasa 3). Në ndryshim nga metodologjia e mëparshme (IFRS 39), e cila kërkonte krijimin e provigjioneve të rrezikut të kredisë mbi bazën e 'humbjeve të realizuara' në ditën e raportimit (incurred losses - IL), IFRS 9 iu kërkon bankave që të ngrejnë provigjione mbi bazën e pritjeve për humbjet nga kredia (Expected Credit Losses-ECL) për 12 muajt e parë të jetës së kredisë në Klasën 1, dhe për të gjithë kohëzgjatjen/jetën e kredisë në Klasat 2 dhe 3. Për këtë arsye, kriteret që shkaktojnë kalimin e kredisë nga Klasa 1 në Klasat 2 dhe 3 janë të rëndësishme.*

Në mënyrë që kredia të kalojë nga Klasa 1 në Klasën 2, duhet të ketë ndodhur: a) një Rritje e Konsiderueshme në Rrezikun e Kredisë (Significant Increase in Credit Risk – SICR), që nga momenti i regjistrimit të kredisë (recognition) kur ajo ofrohet apo blihet; b) vonesa në pagesën e kredisë ka kaluar 30 ditë (por ky është një afat përcaktues; ose c) banka ka bërë një modifikim të termave të kredisë (forbearance). Nje kredi klasifikohet në Klasën 3 nëse vonesa në pagesën e kredisë kalon 90 ditë ose edhe më herët nëse verifikohet një ngjarje që vlerësohet se sjell paaftësi paguese për huamarrësin (default).

Tabelë 8. IFRS 9 – klasifikimi, provigjionimi dhe akumulimi i interesave

	Klasa 1 – Performuese	Klasa 2 – Nënstandarde	Klasa 3 – Joperformuese Secila nga ngjarjet më poshtë shërben si evidencë/provë për dështimin e kredisë
Klasifikimi (cilësia e kredisë)	-Kredi performuese & nuk ka një SICR që nga momenti i origjinimit të kredisë	- Ka ndodhur një SICR që nga momenti i origjinimit të kredisë; - SICR nuk është përcaktuar por faktorë cilësorë të ndryshëm japin informacion të rëndësishëm për vlerësimin e SICR; - Huatë në vonesë me më shumë se 30 ditë, konsiderohen se përfaqësojnë një SICR.	-Vështirësi të ndjeshme financiare të huamarrësit; -Thyerje e kontratës si dështim ose vonesë (duke konsideruar se vonesat në pagesë përtej 90 ditëve, përfaqësojnë dështim); - Banka i ka dhënë huamarrësit disa lehtësi, për shkak të vështirësive të tij (forbearance); - Është e mundshme që huamarrësi të aplikojë për falimentim; - Zhdukja e një tregu aktiv për instrumentin financiar, për shkak të vështirësive; - Vlera ose origjinimi i një aseti financiar me një skonto shumë të lartë që reflekton humbjet e pësuara të kredisë.
Provigjionimi	ECL për 12 muaj	ECL për gjithë jetën e kredisë	ECL për gjithë jetën e kredisë.
Akumulimi i të ardhurave nga interesi	Mbështetuar mbi vlerën bruto të huasë		Mbështetur mbi vlerën neto të huasë (vlera bruto minus provigjionet e aplikueshme)

Burimi: "Payment holiday in the age of Covid: implications for loan valuations market trust and financial stability", BIS, May 2020

*Një tjetër dallim midis IFRS 9 dhe CECL është mënyra e njohjes së të ardhurave nga interesi tek huatë joperformuese. Sipas IFRS 9, të ardhurat nga interesi akumuohen mbi baza bruto për kreditë në Klasat 1 dhe 2, dhe mbi baza neto (duke zbritur provigjionet) për kreditë në Klasën 3. Sipas standardit aktual në SHBA (që mbështet metodologjinë IL dhe CECL), trajtimi i të ardhurave nga interesi nuk specifikohet. Në mungesë të standardit kontabël, bankat në SHBA ndjekin udhëzimet rregullative të agjencive bankare amerikane (FED, OCC, FDIC, NCUA) që ndalojnë vijimin e akumulimit të të ardhurave nga interesi (dhe kërkon zbritjen e atij që është njohur, por që ende nuk është mbledhur) për ekspozimet problematike të kreditit (në vonesë pagese prej më shumë se 90 ditë)**. Nga ana tjetër, edhe në rast të pagesave të shtyra për shkak të moratoriumit, IFRS 9 iu lejon bankave të akumulojnë interesa për pagesat e humbura. Kjo rrit rrezikun e zhvillimeve të ardhshme (të perspektivës) nëse huamarrësit janë të paaftë të paguajnë.*

Vlerësohet që në ndryshim nga modeli i kontabilizimit IL, modeli ECL është shumë më pak prociklik, duke qenë se bankave iu kërkohet të provigjionojnë përpara se kredia të dështojë. Në këto kushte, efekti në rezultatin financiar të bankave dhe kapitalin e tyre do të jetë më pak volatil dhe si rezultat aftësia e tyre për të mbështetur kreditimin do të jetë më e qëndrueshme përgjatë ciklit financiar.

Por ky efekt nuk përfitohet në kushtet e një goditjeje kaq të fortë sa kjo e Covid-19. Në fakt, sipas IFRS 9, në kushtet e zhvillimeve shumë të paqarta ekonomike si rezultat i pandemisë, do të duhej që bankat të riklasifikonin një pjesë të konsiderueshme të kredive të tyre nga 'standard' në 'nënstandard' dhe madje edhe në 'joperformuese', për shkak të pritjeve më negative për rrezikun e kredisë gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Për kreditë e ristrukturuara ku ka rezultuar ulje e Vlerës Aktuale Neto të ekspozimit pas ristrukturimit, banka duhet të shtojë provigjionet për vlerën e ndryshimit. Gjithashtu, do të duhej që ato të rikalibronin parametrat e tyre për vlerësimin e ECL. Së bashku, këto do të shkaktonin një rritje të ndjeshme të provigjioneve për rrezikun e kredisë, të cilat mund të shkaktonin humbje financiare për bankat dhe zvogëlim (deri në mungesë) të kapitalit.

Në këto kushte, nevojitet pragmatizëm për të ulur prociklikalitetin dhe për të gjetur një ekuilibër të drejtë midis një situate financiare e cila shoqërohet me mungesë të kreditimit dhe potencialisht probleme në sistemin finanicar nga njëra anë, dhe nevojës për të ruajtur standardin e rëndësishëm të kontabilizimit të provigjionimit të rrezikut të kredisë me këndvështrim nga e ardhmja, nga ana tjetër.

Në përgjithësi, në juridiksionet që zbatojnë IFRS-të, autoritetet kanë nxjerrë udhëzime të posaçme, duke synuar të evidentojnë fleksibilitetin që ofron IFRS 9. Kështu në Kanada, në Bashkimin Evropian dhe në Mbretërinë e Bashkuar, Komiteti i Bazelit dhe IASB kanë qartësuar që përdorimi i programeve të shtyrjes së pagesave të kredive nuk duhet të evidentohet automatikisht si një SICR dhe si rezultat nuk ka përse të shkaktojë domosdoshmërisht një zhvendosje të kredisë nga Klasa 1 drejt atyre 2 dhe 3. Gjithashtu, është evidentuar që vlerësimi i ECL në përgjithësi dhe i SICR në veçanti, kërkon mbledhjen e një informacioni që është 'i arsyeshëm dhe i justifikuar' (reasonable and supportable) mbi bazën e zhvillimeve të shkuara, aktuale dhe të ardhshme, në përgjithësi masat e autoriteteve në juridiksionet që zbatojnë IFRS 9 kanë synuar shmangien e pritshmërive ekstremisht pesimiste mbi zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe vlerësimin e ECL-ve. Për shembull, në Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar, autoritetet iu kanë kërkuar bankave të konsiderojnë jo vetëm efektet e Covid-19,

por edhe masat mbështetëse të qeverisë, kur përcaktojnë parashikimet e tyre. Po kështu, EBA ka tërhequr vëmendjen e bankave evropiane mbi rëndësinë që kriza të konceptohet si e përkohshme dhe që të dhënat për një informacion/ vlerësim të drejtë, aktualisht mungojnë.

Tabelë 9. Juridiksionet IFRS – ndikimi i masave mbi Provigjionet, të Ardhurat dhe Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë (KBN1)

	Ndikimi në Provigjione	Ndikimi në të Ardhurat Neto	Ndikimi në KBN1
Bankat mund të akumulojnë interesa mbi pagesat e kredive që janë shtyrë*		Rritje	Rritje
Programet e shtyrjes së pagesave nuk sjellin automatikisht zhvendosjen e kredive drejt Klasës 2	Ulje	Rritje	Rritje
Përdorimi i kujdesshëm i informacionit në lidhje me përcaktimin e provigjioneve ECL, duke konsideruar situatën e jashtëzakonshme, por të përkohshme dhe mbështetjen qeveritare	Ulje	Rritje	Rritje
Për kërkesat për kapital mbi kreditë që mbështeten nga garancia sovrane, duhet përdorur koeficienti i rrezikut të Qeverisë (Kom.Bazelit)			Rritje
Programet e shtyrjes së pagesave që lidhen me Covid-19, nuk duhet të shkaktojnë përfshirjen në "ditë-vonesë" për qëllimin e llogaritjes së provigjioneve të rrezikut të kredisë (Kom.Bazelit)			Rritje
Rregullat tranzitore mbi ndikimin e provigjioneve ECL tek KBN1 (Kom.Bazelit)			Rritje

Burimi: "Expected loss provisioning under a global pandemic", BIS, April 2020
*- Akumulohet interesi mbi vlerën bruto të kredisë për Klasat 1 dhe 2, dhe mbi vlerën neto të kredisë për Klasën 3.

Në SHBA, autoritetet kanë ndermarrë veprime ligjore (Coronavirus Aid, Relief and Economic Security - CARES Act, mars 2020), të cilat iu japin bankave të mëdha e të listuara mundësinë e vonesës së zbatimit të CECL deri në fund të 2020-ës. Në vijim, agjencitë bankare amerikane kanë nxjerrë një rregull të përbashkët që iu mundëson bankave që nisin zbatimin e CECL brenda 2020, të zbusin efektet e CECL në kapitalin e tyre për një periudhë 2-vjeçare. Pra, ndonëse bankat e mëdha amerikane mund të llogarisin provigjione mbi bazën e CECL për të siguruar transparencën në pasqyrat e tyre financiare (meqë janë të listuara në Bursë), çdo rritje e provigjioneve mbi vlerën e llogaritur sipas IL nuk do të reflektohet në vlerën e kapitalit rregullator të bankës përgjatë kësaj periudhe.

Tabelë 10. SHBA – ndikimi i masave mbi Provigjionet, të Ardhurat dhe Kapitalin Bazë të Nivelit të Parë (KBN1)

	Ndikimi në Provigjione	Ndikimi në të Ardhurat Neto	Ndikimi në KBN1
Mundësia e shtyrjes së zbatimit të CECL deri në T4-2020 për bankat e mëdha të listuara	Ulje	Rritje	Rritje
Modifikime të përkohshme për huamarrësit që ishin të rregullt deri para Covid-19, nuk do të sjellin kategorizimin si "ristrukturim borxhi problematik"	Ulje	Rritje	Rritje
Për kërkesat për kapital mbi kreditë që mbështeten nga garancia sovrane, duhet përdorur koeficienti i rrezikut të Qeverisë (Kom.Bazelit)			Rritje
Programet e shtyrjes së pagesave që lidhen me Covid-19, nuk duhet të shkaktojnë përfshirjen në "ditë-vonesë" për qëllimin e llogaritjes së provigjioneve të rrezikut të kredisë (Kom.Bazelit)			Rritje
Rregullat tranzitore mbi ndikimin e provigjioneve ECL tek KBN1 (Kom.Bazelit)			Rritje

Burimi: "Expected loss provisioning under a global pandemic", BIS, April 2020

Në nivel ndërkombëtar, Komiteti i Bazelit ka qartësuar trajtimin rregullativ të moratoriumeve të pagesave apo garancive qeveritare, në kuadër të kërkesave të bankave për kapital. Komiteti gjithashtu ka miratuar disa ndryshime, kërkesat tranzitore përsa i takon njohjes së provigjioneve ECL në kapitalin rregullator, duke iu mundësuar atyre rikthimin në kapitalin rregullator deri në 100% të vlerës së provigjioneve që i atribuohen qasjes ECL për vitet 2020 dhe 2021. Nëse këto zbatohen nga të gjitha vendet anëtare të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, kjo nënkupton që vetëm provigjionet që kontabilizohen sipas modelit IL do të reflektohen në llogaritjen e Kapitalit Bazë të Nivelit të Parë të bankave në vitet 2020 dhe 2021.

Në përgjithësi, të gjitha masat e marra në vende të ndryshme, synojnë të ulin presionin mbi bankat në lidhje me kërkesat për provigjionimin sipas metodologjisë ECL dhe të ardhurat e tyre, duke i lejuar juridiksionet e ndryshme që të neutralizojnë ndikimin nga provigjionet ECL mbi kapitalin rregullator të bankave për periudhën 2020-2021.

* *Në ndryshim nga IFRS 9, CECL në SHBA iu kërkon bankave që të ngrejnë provigjionet e rrezikut të kredisë, për të gjithë kohëzgjatjen e kredisë, që në ditën e parë të regjistrimit të saj.*

** *Edhe kuadri rregullativ mbikëqyrës në Bankën e Shqipërisë ndjek një qasje tëngjashme.*

4.1.2.2 Rreziku i likuiditetit

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar mbetet ne nivele të mira, dhe treguesit perkates gjenden ndjeshem mbi limitet rregullative.

Prania e bollshme e aktiveve likuide, zbut rrezikun potencial që buron nga vlerat negative në hendekun e maturimit mes aktiveve dhe pasiveve në afatin e shkurtër.

Pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar vlerësohet në nivele të kënaqshme. Treguesit e likuiditetit në lekë dhe valutë mbeten mbi nivelet minimale rregullative. Burimi kryesor i financimit mbeten depozitat, të cilat mbulojnë dy herë vëllimin e kredive të sektorit. Në fund të muajit qershor 2020, raporti "hua/depozita" shënoi 48%, në rënie të lehtë ndaj gjashtëmujorit të kaluar dhe ndaj nivelit të një viti më parë. Sipas monedhës, ky raport shënon 47.2% për monedhën vendase dhe 48.7% për valutën.

Raporti "hua/depozita" për monedhën lekë është ndjeshëm më i ulët se vlerat e para gjashtë muajve (48.5%), pasi depozitat janë rritur më shpejt se kredia. Kundrejt një viti më parë, ndryshimet për këtë raport paraqiten të vogla, pasi kredia dhe baza e depozitave në lekë kanë shfaqur ecuri të ngjashme. Vlera e këtij raporti në valutë u rrit lehtë për periudhën dhe ra me 2.3 pikë përqindje ndaj një viti më parë, duke pasqyruar ritmin më të lartë të rritjes së depozitave në valutë krahasuar me atë të huave në valutë.

Nivelet e aktiveve likuide në bilancet e bankave vijojnë të mbeten të larta duke reflektuar ecurinë e ngadaltë të aktivitetit kreditues. Në fund të muajit qershor 2020, raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar ishte 33.3% ose rreth 2.4 pikë përqindje më i ulët ndaj një gjashtëmujori më parë. Kjo ecuri reflekton rënien e aktiveve likuide në bilancet e bankave së bashku me zgjerimin e totalit të aktiveve. Rënia e aktiveve likuide ka ulur edhe raportin e aktiveve likuide ndaj totalit të detyrimeve afatshkurtra me 3.3 pikë përqindje duke e çuar atë në nivelin 46.1%.

Pavarësisht se bankat po operojnë në kushtet e një likuiditeti të bollshëm, hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve, sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur, në raport me totalin e aktiveve në afatin e shkurtër, vijon të mbetet në nivele të larta. Hendeku negativ mes aktiveve dhe detyrimeve afatshkurtra sipas segmenteve të maturitetit kontraktual të mbetur[36] për periudhën deri në 3 muaj, u rrit nga 17% në 26% të aktiveve. Nga ana tjetër, hendeku mes aktiveve dhe detyrimeve për periudhën 3 muaj – 1 vit u ul për periudhën në 2% të totalit të aktiveve. Hendeku i përgjithshëm vijon të jetë pozitiv, mbështetur nga vlerat e larta pozitive për maturitetet më afatgjata, dhe mbetet në vlerën 5% të aktiveve të sektorit bankar.

Grafik 85. Tregues të likuiditetit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 86. Mospërputhja në maturim mes aktiveve dhe detyrimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës është vërejtur një rritje në diferencën midis maturimit mesatar të aktiveve dhe të detyrimeve, si pasojë e zgjerimit të maturitetit mesatar të aktiveve. Në fund të muajit qershor, kjo diferencë ishte rreth 23.1 muaj, nga 21.4 muaj në fund gjashtëmujorit të kaluar. Maturiteti i mbetur i depozitave, të cilat përfaqësojnë kategorinë më të rëndësishme të detyrimeve, është ngushtuar në 7.7 (nga 8.3) muaj gjatë periudhës. Maturiteti i mbetur i kredisë u ul gjithashtu, në 45.7 muaj (nga 46.5).

Ecuria në kahe të kundërta e maturimit mesatar të kredive dhe aktivit shpjegohet nga rritja e peshës së letrave me vlerë në aktivet e sektorit bankar. Afatet e maturimit të këtyre të fundit janë rritur, ndërsa ato të huave rezultojnë më të shkurtuara. Nga ana tjetër,

Grafik 87. Maturimi mesatar i mbetur



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[36] *I llogaritur si raporti i 'diferencës midis aktiveve dhe pasiveve' ndaj 'totalit të aktiveve' për secilën shportë të maturitetit të mbetur. Në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve janë përfshirë edhe zërat jashtë bilancit.*

ulja e maturimeve të huave mund të tregojë hezitim të sektorit bankar për të kredituar në terma më afatgjatë, duke qenë se aftësia paguese, për shkak të zhvillimeve të fundit, mund të bjerë në të ardhmen. Ashtu si në gjashtëmujorin e kaluar, sektori bankar nuk raportoi linja financimi nga grupet zotëruese.

4.1.2.3 Rreziqet e tregut

RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Pozicioni i hapur neto në valutë i sektorit bankar ka rënë, mbetet në nivele të kufizuara dhe ndjeshëm nën limitin rregullativ.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit është rritur si pasojë e rritjes së treguesit të ekspozimit tek bankat me rëndësi sistemike.

Nivelet e pozicionit të hapur neto në valutë tregojnë për një ekspozim në rënie dhe të kufizuar ndaj ndikimit të drejtpërdrejtë në bilanc të luhatjeve të kursit të këmbimit. Si treguesi i agreguar për të gjitha bankat, ashtu edhe treguesi për grupet e bankave sipas madhësisë ka vlera shumë më të ulëta në krahasim me vlerën prej 30% të kapitalit rregullator të përcaktuar si kufi i sipërm nga rregullorja përkatëse.

Gjatë gjysmës së parë të vitit, pozicioni i hapur në valutë ra me rreth 2 pikë përqindje, duke zbritur në 5.4% të kapitalit rregullator. Në krahasim me një vit më parë, treguesi ishte rreth 0.9 pikë përqindje më i lartë. Ecuria e treguesit diktohet nga grupi i bankave sistemike, të cilat kanë ruajtur pozicion të hapur valutor "në blerje". Ky pozicion ishte sa 6.7% e kapitalit rregullator, ose 3.3 pikë përqindje më pak nga niveli prej 10% i fundit të vitit 2019 dhe 0.3 pikë përqindje më i ulët nga niveli 7% i një viti më parë. Grupi i bankave të tjera (josistemike) paraqet një ekspozim më të ulët ndaj kursit të këmbimit, me një pozicion neto të hapur valutor "në blerje" sa 0.4% e kapitalit rregullator. Në fund të vitit të kaluar, bankat josistemike regjistruan një pozicion neto "në blerje" sa 1.6% e kapitalit të tyre rregullator.

Grafik 88. Pozicioni i hapur valutor ndaj kapitalit rregullator për sektorin dhe grupet



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tërthortë të kursit të këmbimit është rritur me 0.4 pikë përqindje në krahasim me gjashtë muaj më parë, ndërsa krahasuar me një vit më parë treguesi ishte 0.3 pikë përqindje më i ulët. Në fund të periudhës, treguesi i mospërputhjes valutore[37] për të gjitha monedhat ishte sa 16.5% e totalit të aktiveve nga përkatësisht 16.1% dhe 16.8%, gjashtë muaj dhe një vit më parë. Aktivet dhe pasivet në valutë shënuan të njëjtën normë rritjeje (rreth 2%), por ndikimin kryesor në rritjen e treguesit e ka dhënë rritja e kredisë në valutë për rezidentët (me rreth 4%), e cila rrit rrezikun

[37] *Treguesi i mospërputhjes valutore mat shkallën e mbulimit të pasiveve në valutë të sektorit bankar, me aktivet në valutë të netuar me kredinë në valutë për rezidentët. Një vlerë e ulët e raportit të këtij treguesi ndaj aktiveve tregon ekspozim të ulët ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit. Metodologjia e llogaritjes së treguesit të mospërputhjes është publikuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.*

e tërthortë që vjen nga luhatjet e kursit të këmbimit. Monedha evropiane ka një kontribut dhe korrelacion shumë më të lartë me indeksin e përgjithshëm, pasi në krahasim me monedhat e tjera, ajo zë një peshë të konsiderueshme në bilancin dhe aktivitetin e bankave. Megjithatë, gjatë periudhës indeksi për euron ra lehtë me 0.1 pikë përqindje në nivelin 16.2%. Kontributin kryesor në rritjen e vlerës së indeksit të përgjithshëm gjatë pjesës së parë të vitit e dha rritja e indeksit për dollarin amerikan në nivelin 0.4% nga 0.1% në periudhën paraardhëse. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vlerat e indekseve për euron dhe USD ishin përkatësisht 16.5% dhe 0.6%. Indeksi i mospërputhjes valutore për monedhat e tjera, ka qenë i qëndrueshëm në kohë dhe në nivele shumë të ulëta, duke reflektuar rrezik të papërfillshëm të ekspozimit në këto monedha.

Grafik 89. Ecuria e komponentëve të indeksit për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 90. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore sipas monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në ecurinë e indeksit të mospërputhjes valutore, kontributin kryesor vijon ta japë grupi i bankave sistemike. Ky grup paraqet një rrezik të tërthortë të kursit të këmbimit më të ulët, pasi regjistron vlera më të ulëta të indeksit në krahasim me grupin e bankave josistemike. Në fund të periudhës, indeksi total për bankat sistemike ishte sa 12.7% e aktiveve të grupit nga 10.4% në periudhën e mëparshme dhe 11.6% para një viti. Sipas monedhave, kontributin kryesor për këtë grup e ka dhënë rritja e indeksit në monedhën evropiane me 1.3 pikë përqindje në nivelin 12.5% të aktiveve, ndërsa indeksi në USD është rritur me 0.7 pikë përqindje. Në fund të gjashtëmujorit të parë 2020 indeksi për grupin e bankave josistemike shënoi 28.3% të aktiveve. Në krahasim me gjashtë muaj dhe një vit më parë, ky tregues ka rënë me përkatësisht 0.7 pikë përqindje dhe 0.3 pikë përqindje.

Grafik 91. Mospërputhja valutore sipas grupeve dhe monedhave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 92. Ecuria e indeksit të mospërputhjes valutore për grupet bankare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të normës së interesit ka shënuar rritje gjatë periudhës. Megjithatë ai mbetet i kufizuar dhe në nivele të ulëta ndaj kapitalit rregullator, duke qëndruar ndjeshëm nën limitin rregullativ.

Sektori bankar paraqet një ndjeshmëri të shtuar ndaj luhatjeve të mundshme të normës së interesit për pozicionin neto me normë fikse interesi, për maturitetin afatmesëm dhe afatgjatë, dhe në monedhën evropiane.

Ekspozimi i bankave ndaj rrezikut të normës së interesit është rritur ndjeshëm gjatë periudhës, por vijon të vlerësohet i kufizuar. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator të sektorit bankar shënoi 5.9%, duke qëndruar 3 pikë përqindje më lart nivelit të regjistruar në fund të vitit të kaluar. Kontributin kryesor në rritjen e treguesit e dha diferenca e peshuar e aktiveve me pasivet me normë interesi të fiksuar (FIR)[38]. Nga ana tjetër, edhe pozicioni neto me normë interesi të ndryshueshme (VIR) shënoi rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me FIR, duke ruajtur kahun pozitiv të dy viteve të fundit.

Në kushtet kur pozicioni total neto është pozitiv, pra vëllimi i pretendimeve që arkëtojnë interesa është më i madh se ai i detyrimeve për të cilat paguhen interesa, sektori bankar do të ishte i ekspozuar ndaj një rënieje të menjëhershme të normave të interesit. Por, në kushtet kur mbulimi me kapital rregullator i këtyre pozicioneve mbetet i lartë dhe hapësira për ulje të mëtejshme të normave të interesit është objektivisht e kufizuar, kostot që mund t'i vijnë sektorit bankar për shkak të uljes së mëtejshme të normave të interesit, mund të përthithen lehtësisht.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit, sektori bankar u karakterizua nga një rritje e dukshme e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit. Treguesi i ekspozimit arriti në nivelin më të lartë të viteve të fundit në nivelin 5.9% të kapitalit rregullator të sektorit bankar. Gjatë gjysmës së parë të vitit, bankat sistemike dhe bankat e tjera kanë shfaqur ekspozim në rritje krahasuar me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Grupi i bankave të tjera (josistemike) shfaq ekspozim më të lartë krahasuar

[38] *Pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit klasifikohen në pozicione me normë interesi fikse (FIR) dhe pozicione me normë interesi të ndryshueshme (VIR), sipas afatit dhe sipas monedhave.*

me grupin e bankave sistemike, në nivelin 6.7% të kapitalit të tyre rregullator. Bankat e tjera kanë zgjeruar ekspozimin duke shënuar rritje me përkatësisht 2.2 pikë përqindje dhe 3.5 pikë përqindje krahasuar me gjashtë muaj dhe një vit më parë. Ndërkohë, ecuria e treguesit për sektorin është diktuar nga grupi i bankave sistemike. Ky grup ka zgjeruar ndjeshëm ekspozimin e tij në nivelin 5.7% të kapitalit rregullator në rritje me 3.3 pikë përqindje dhe 4.3 pikë përqindje krahasuar përkatësisht me gjashtë muaj dhe një vit më parë.

Të dyja grupet e bankave kanë shfaqur ekspozim më të lartë në diferencën midis aktiveve dhe pasiveve me normë të fiksuar interesi (FIR), e cila për periudhën ishte sa 3% e kapitalit rregullator për bankat sistemike dhe sa 6% e kapitalit rregullator për bankat e tjera. Ekspozimi ndaj aktiveve dhe pasiveve me normë të ndryshueshme të interesit (VIR) në fund të gjashtëmujorit të parë është më i ulët në krahasim me ekspozimin ndaj luhatjeve të normës fikse, dhe shënoi 2.7% për bankat sistemike dhe 0.7% të kapitalit rregullator për bankat e tjera.

Grafik 93. Pozicioni total neto i peshuar në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 94. Ecuria sipas grupeve e pozicionit neto të peshuar ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhave, pozicioni total neto ndaj kapitalit rregullator është ndikuar nga pozicioni neto në monedhën evropiane, e cila për herë të parë në këto 5 vite ka regjistruar vlera pozitive[39]. Krahasuar me fundin e vitit 2019 ky pozicion u zgjerua me 2.5 pikë përqindje, në nivelin 2.1% të kapitalit rregullator të sektorit bankar. Pozicioni neto në euro ka vlera pozitive për bankat sistemike, për të cilat pozicioni në këtë monedhë është pozicioni më i madh midis pozicioneve sipas monedhave, dhe zë 2.4% të kapitalit të tyre rregullator. Për grupin e bankave josistemike, ky tregues shënoi vlerën 1% të kapitalit rregullator. Treguesi i ekspozimit ndaj luhatjes së normave të interesit në monedhën vendase qëndroi në të njëjtin nivel me atë të fundit gjashtëmujorit të kaluar duke shënuar 2.8% të kapitalit rregullator. Megjithatë, ai vijon të mbetet ekspozimi kryesor për sektorin bankar, për shkak të pozicionit të madh në këtë monedhë të grupit të bankave josistemike. Gjatë periudhës, për këto banka, pozicioni në lekë u zgjerua me

[39] *Aktivet dhe ZJB të ndjeshme ndaj normës së interesit janë më të mëdha se sa pasivet dhe ZJB në euro.*

0.3 pikë përqindje dhe arriti në nivelin 6.1% të kapitalit rregullor. Ndërkohë, bankat sistemike rritën me 0.2 pikë përqindje ekspozimin e tyre në lekë në nivelin 1.8% të kapitalit rregullator. Pozicioni në dollarë amerikanë i sektorit bankar u rrit me 0.5 pikë përqindje në nivelin 1.2% të kapitalit rregullator, me kontribut kryesor nga bankat sistemike të cilat e rritën ekspozimin e tyre me 2.6 pikë përqindje, në nivelin 2.4% të kapitalit rregullator. Nga ana tjetër, bankat jo-sistemike kanë ruajtur një ekspozim të qëndrueshëm në kohë dhe në vlera shumë të vogla negative (-0.1% të kapitalit rregullator të tyre).

Grafik 95. Hendeku sipas grupeve dhe monedhave ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 96. Pozicioni neto i peshuar sipas afatit ndaj kapitalit rregullator, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas afatit të maturimit, ekspozimi më i madh ndaj luhatjes së normave të interesit vjen nga shporta me maturitet afatgjatë, e cila shënoi 9% të kapitalit rregullator, në rritje me 0.8 pikë përqindje ndaj periudhës paraardhëse. Megjithatë, pozicioni i ponderuar neto ndaj kapitalit rregullator është ndikuar kryesisht nga pozicioni me maturitet afatshkurtër, i cili shënoi rritje me 1.3 pikë përqindje, në nivelin 1.2% të kapitalit rregullator, nga pozicioni i vogël negativ që mbante në periudhën paraardhëse (-0.1%). Për instrumentet me maturitet afatmesëm vërehet zvogëlim i pozicionit negativ midis mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit. Ky tregues ishte sa -4.3% e kapitalit rregullator, duke qenë përkatësisht 0.9 pikë përqindje. dhe 0.3 pikë përqindje më i vogël, kundrejt pozicionit të gjashtë muajve dhe një viti më parë. Kontributin kryesor për këtë maturitet e dha ngushtimi me 1.7 miliardë lekë i pozicionit neto të peshuar për normat fikse të interesit (FIR) në monedhën evropiane.

Rreziku i tërthortë ndaj ndryshimit të normave të interesit[40] ka shënuar rënie gjatë periudhës. Norma e peshuar e interesit të kredisë ra me 0.5 pikë

[40] *Ky rrezik i referohet ndikimit që ndryshimi në normën e interesit, jep tek klientët e bankave. Për shembull, pavarësisht se rritja e normës së interesit mund të ketë një ndikim pozitiv mbi bilancin e bankës (për shkak të vlerës pozitive të pozicionit neto mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit), kjo rritje do të ketë efekt negativ tek aftësia paguese e huamarrësve të bankës kur kredia është dhënë me normë interesi të ndryshueshme (rreziku i tërthortë).*

përqindje krahasuar me gjashtë muaj më parë në nivelin 5%, ndërsa norma e peshuar e depozitave qëndroi në të njëjtin nivel prej 0.5%. Si rezultat, *spread* i përgjithshëm ka rënë me të njëjtin nivel prej 0.5 pikë përqindjeje kundrejt gjashtë muajve më parë në nivelin 4.5%. Kundrejt një viti më parë, ku *spread*-i shënonte 4.6%, rënia është vetëm 0.1 pikë përqindje.

Sipas monedhave, kontributi kryesor në rënien e *spread*-it ka ardhur nga rënia e *spread*-it për monedhën vendase, me 1.1 pikë përqindje në nivelin 4.7% dhe rënia e *spread*-it për monedhën evropiane me 0.4 pikë përqindje në nivelin 3.9%. Në ndryshim nga këto dy monedha, për *spread*-in në usd vërehet një rritje prej 1 pikë përqindjeje në nivelin 4.3% si rezultat i rritjes së normës së ponderuar të interesit të kredisë në dollarë amerikanë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit. Niveli më i lartë i *spread*-it për monedhën usd vërehet në muajin maj, si rezultat i rritjes së normës së interesit të kredisë dhe numrit të bankave që kanë dhënë kredi në këtë monedhë.

Grafik 97. Norma e peshuar e interesit të kredisë dhe depozitave me afat dhe *spread* i normave të interesit, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 98. Diferenca e normave të peshuara të interesit të kredisë me depozitat me afat sipas monedhave, në pikë përqindje



Burimi: Banka e Shqipërisë.

HAPËSIRË INFORMUESE 5. MATJA E RREZIKUT TË SEKTORIT BANKAR NËPËRMJET TREGUESIT Z

Një nga treguesit më të përdorur për të matur nivelin e rrezikut të institucioneve financiare dhe distancën e tyre nga falimentimi potencial, është treguesi Z (Z-Score). Studiues të ndryshëm kanë propozuar mënyra të ndryshme të matjes së këtij treguesi, por pjesa më e madhe e metodave mbështeten mbi ecurinë e përfitueshmërisë dhe raportit të kapitalizimit të institucioneve ose segmenteve të veçanta të sistemit financiar. Formula klasike për të llogaritur vlerën e treguesit Z (formula 1) tregon numrin e devijimeve standarde me të cilat duhet të bjerë niveli i kapitalizimit të bankës deri sa banka të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet. I ndërtuar në këtë formë, treguesi Z paraqet në mënyrë sasiore (në njësi indeksi) distancën e bankës nga falimentimi. Sa më e madhe të jetë vlera e treguesit Z, aq më e qëndrueshme është gjendja financiare e bankës dhe aq më i ulët është rreziku që banka të falimentojë, ose probabiliteti i paaftësisë paguese – Π (formula 2).

(Formula 1) $Z = \frac{RoA = K/A}{\sigma RoA}$ *(Formula 2)* $\pi = \frac{1}{2*Z^2}$

Ku RoA është kthimi nga aktivet, K/A është kapitali aksioner ndaj aktiveve mesatare dhe σRoA është devijimi standard i treguesit RoA. Këtu është analizuar dekompozimi i treguesit Z sipas dy përbërësve bazë, që janë përbërësi i përfitueshmërisë (RoA/σRoA) dhe përbërësi i kapitalizimit ((K/A)/σRoA).

Për të llogaritur treguesin Z për sektorin bankar dhe bankat e veçanta që operojnë në Shqipëri, Banka e Shqipërisë është mbështetur mbi disa metoda bashkëkohore që konsiderojnë ndryshimin në kohë të profilit të rrezikut të institucioneve financiare. Nga ana teknike, kjo llogaritje realizohet duke zëvendësuar vlerat aktuale të treguesit të përfitueshmërisë me mesatare rrëshqitëse të disa periudhave (muajve, tremujorëve apo viteve), të cilat mbulojnë një hark kohor 3-5 vjeçar. Për rastin e Shqipërisë, duke u nisur edhe nga gjatësia e serive dhe frekuenca e të dhënave, harku kohor i përzgjedhur për të ndërtuar mesataren rrëshqitëse dhe devijimin standard të RoA-s është 16 tremujorë ose 4 vite. Në hapin e parë të studimit është llogaritur treguesi Z për secilën nga bankat në sektorin bankar shqiptar për periudhën T1:2004 – T2:2020. Në hapin e dytë, janë bërë tre vlerësime të ndryshme për treguesin e agreguar Z për sektorin bankar, si dhe janë ndërtuar tregues të agreguar për grupe bankash si bankat sistemike, bankat josistemike, bankat me kapital të huaj etj. Në hapin e tretë është analizuar kontributi i bankave të veçanta në rrezikun e përgjithshëm të sektorit bankar sipas metodës së "përjashtimit të një banke". Në të njëjtin kontekst është analizuar edhe kontributi i bankave sistemike në nivelin e përgjithshëm të rrezikut të sektorit bankar.

Grafik 99. Treguesi Z për bankat e veçanta gjatë periudhës T4:2017 – T2:2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafi 100. Treguesi Z i agreguar gjatë periudhës T4:2017 – T2:2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga rezultatet për bankat e veçanta vërehet se për pjesën më të madhe të bankave treguesi Z ka shënuar rënie gjatë viteve 2010-2011, ka qëndruar në nivele të ulëta gjatë viteve 2013-2014 dhe ka nisur të rritet nga fillimi i vitit 2015 e këtej. Vlerat minimale, maksimale dhe mesatare të treguesit Z për bankat e veçanta janë përkatësisht 0.6, 58, dhe 14.6, ndërkohë që për të gjithë periudhën rezulton se 11 banka e kanë pasur vlerën e treguesit mbi 10 dhe 8 banka e kanë pasur këtë vlerë mbi 15. Pavarësisht se niveli dhe luhatshmëria e raportit të përfitueshmërisë (RoA) luan një rol të rëndësishëm në ecurinë e treguesit Z,

vërehet që përbërësi i kapitalizimit zë peshën dërrmuese dhe jep kontributin kryesor në nivelin e përgjithshëm të rrezikut për secilën bankë. Në pothuajse të gjitha rastet kur është evidentuar përmirësim i shëndetit të bankave që është ekuivalent me rënie të rrezikut të falimentimit, përmirësimi shpjegohet me rritje të raportit të kapitalizimit nga ana e bankës. Përkeqësimi i indeksit, nga ana tjetër, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rënien e përfitueshmërisë, rritjen e luhatshmërisë së përfitueshmërisë ose të dyja ngjarjet së bashku. Përsa i përket probabilitetit të paaftësisë paguese, treguesi Π ka arritur vlerat më të larta gjatë viteve 2011-2014 dhe ka rënë ndjeshëm në vitet 2019-2020.

Tabelë 11. Vlerat mesatare të treguesit të agreguar Z dhe të probabilitetit të paaftësisë paguese

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	H1:2020
Z (njësi indeksi)	19	15	13	10	10	11	12	14	16	17	17	21	21
Π (njësi indeksi)	0.1	0.2	0.3	0.5	0.5	0.5	0.4	0.3	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Llogaritja e treguesit Z të agreguar për të gjithë sektorin bankar është realizuar sipas tre mënyrave. Treguesi TZ-score llogaritet në të njëjtën mënyrë si treguesi Z për bankat individuale, duke përdorur si RoA dhe K/A treguesit për të gjithë sektorin bankar. Treguesi AZ - Score M.P. është llogaritur si mesatare e peshuar e treguesve Z të bankave individuale, ku si koeficientë peshimi janë përdorur peshat e aktiveve të bankave në totalin e aktiveve të sektorit. Treguesi AZ - Score P.B. është llogaritur si mesatare e thjeshtë e treguesve Z të bankave individuale. Nga një analizë e detajuar e dekompozimit dhe e korrelacionit të secilit prej treguesve të agreguar me treguesit Z të bankave individuale, rezulton që treguesi AZ - Score P.B. është treguesi më i përshtatshëm për të vlerësuar nivelin e rrezikut të sektorit bankar. Edhe treguesi i agreguar duke përdorur pesha të barabarta, sugjeron që shëndeti i sektorit bankar ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm që nga fundi i vitit 2014 – fillimi i vitit 2015. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, vlera mesatare e treguesit Z është 21 njësi indeksi, që, së bashku me mesataren e vitit 2019, është vlera më e lartë historike që nga fundi i vitit 2007. Ashtu si edhe për bankat e veçanta, përmirësimi i shëndetit dhe rënia e rrezikut për sektorin bankar është ndikuar nga përmirësimi i nivelit të kapitalizimit të sektorit bankar.

Grafik 101.Dekompozimi i treguesit të agreguar Z sipas përbërësit të përfitueshmërisë dhe të kapitalizimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 102. Kontributi i bankave sistemike në nivelin e përgjithshëm të rrezikut sipas treguesit Z



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një vlerë e shtuar e analizës së rrezikut në sektorin bankar nëpërmjet treguesit Z është vlerësimi i kontributit të bankave të veçanta ose grupeve të bankave me karakteristika të caktuara në rrezikun e përgjithshëm të sektorit bankar. Treguesi i agreguar Z i ndërtuar vetëm për bankat sistemike sugjeron që niveli i përgjithshëm i rrezikut për këtë grup bankash ka qenë vazhdimisht më i ulët në krahasim me rrezikun e pjesës tjetër të sektorit bankar, duke qenë se gjatë gjithë periudhës së analizuar, vlerat e treguesit Z për bankat sistemike qëndrojnë mbi vlerat e treguesit të agreguar Z të sektorit bankar. Në mënyrë simetrike, treguesi Z i llogaritur duke përjashtuar bankat sistemike, ka vlera më të ulëta ose tregon rrezik më të lartë sesa treguesi i vlerësuar për të gjitha bankat. Përfundimi që bankat sistemike në tërësi kanë kontribuar për forcimin e qëndrueshmërisë dhe zbutjen e rrezikut sistemik në sektorin bankar, shpjegohet jo vetëm me nivelet e mira dhe të qëndrueshme të përfitueshmërisë së këtyre bankave, por edhe me raportet mesatarisht më të larta të kapitalizimit të tyre në krahasim me pjesën tjetër të sektorit bankar, të kushtëzuara nga kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë për bankat sistemike dhe/ose ato me ekspozim ndaj rreziqeve të veçanta.*

Treguesi Z për sektorin bankar, për banka të veçanta dhe për sektorin bankar duke përjashtuar banka ose grupe bankash, do të përdoret në vazhdimësi si pjesë e paketës së identifikimit dhe monitorimit të rreziqeve sistemike në kuadrin e zbatimit dhe vlerësimit të efektit të masave me natyrë makroprudenciale. Në mënyrë të veçantë, analiza e grupit të bankave sistemike do të mbështesë analizën dhe kuadrin makroprudencial të vlefshëm për bankat sistemike në çdo fazë të përcaktimit të bankave sistemike dhe shtesave të kapitalit për rëndësinë sistemike.

* *Shiko vendimin e Guvernatorit nr. 1714, datë 25.3.2020 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit".*

4.1.3 REZISTENCA E SEKTORIT BANKAR

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës tregojnë se sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm ndaj goditjeve të mundshme makroekonomike, veçanërisht gjatë vitit të parë të ushtrimit. Gjatë vitit të dytë të ushtrimit, nën supozimet më ekstreme të skenarëve më të përkeqësuar, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar shfaq rënie të ndjeshme dhe nevojat për kapital në banka të veçanta janë të konsiderueshme.

Ushtrimi i provës së rezistencës vlerëson qëndrueshmërinë e sektorit bankar në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit për periudhën 2020-2021. Ushtrimi kryhet duke u mbështetur në tre skenarë: skenarin bazë, skenarin e moderuar dhe atë të rënduar. Supozimet e marra në konsideratë në secilin prej tyre paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Dy skenarët e fundit kanë një probabilitet më të ulët ndodhjeje dhe supozime më ekstreme. Në ndryshim nga periudhat e mëparshme të kryerjes së provës së rezistencës, në supozimet e ushtrimit aktual është bërë një përpjekje për të përfshirë edhe goditjen e pandemisë, nëpërmjet kanaleve të mundshme të transmetimit në ekonominë e vendit përgjatë vitit 2020 dhe 2021. Është e kuptueshme që skenarët janë ndërtuar duke supozuar që masat e marra nga Banka e Shqipërisë në drejtim të pezullimit të ndryshimit të kredive me probleme dhe të provigjionimit të tyre, nuk ekzistojnë ose kanë përfunduar. Për këtë arsye, vitet 2020 dhe 2021 mund të lexohen përkatësisht edhe si 'viti i parë' dhe 'viti i dytë' i ushtrimit.

Grafik 103. Supozimet për ndërtimin e provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Skenari bazë supozon një tkurrje ekonomike për vitin 2020 dhe një normë rritjeje ekonomike pozitive në vitin 2021. Në këtë skenar, rritja ekonomike shoqërohet me rritje të kreditimit dhe përmirësim të cilësisë së portofolit të kredisë bazuar në veprimet e shlyerjes dhe të fshirjeve. Në skenarin e moderuar, rritja ekonomike vlerësohet negative përgjatë të dy viteve të ushtrimit; ndërsa në skenarin e rënduar vlerat e tkurrjes së ekonomisë për të dy vitet e ushtrimit, thellohen.

Supozimeve për ecurinë e dobët ekonomike në skenarin e moderuar dhe në skenarin e rënduar, u janë shtuar kombinimet me supozimet përkatëse për një nënçmim të kursit të këmbimit të monedhës vendase, rritje të normave të interesit dhe përgjysmim të ritmit të kreditimit deri në një mungesë të kredidhënies apo tkurrje të saj. Këto zhvillime reflektohen në një përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë. Më konkretisht, raporti i kredive me probleme përkeqësohet deri në fund të vitit të dytë të ushtrimit me 8.6 pikë përqindje (për skenarin e moderuar) dhe me 12.4 pikë përqindje (për skenarin e rënduar) ndaj vlerave faktike të fundit të gjashtëmujorit të parë 2020. Këto supozime ndikojnë në një rënie të vlerave të treguesve të kapitalizimit për banka dhe sektorin bankar në tërësi, kryesisht gjatë vitit 2021. Në skenarët e përkeqësuar, efekteve të rënies së cilësisë së kredisë, iu bashkohen edhe efektet që vijnë nga rreziqet e tregut dhe ato operacionale.

Rezultatet e ushtrimit të provës së rezistencës në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit tregojnë se:

1. Zhvillimet gjatë vitit të parë ushtrimor dhe nevojat për kapital shtesë [41]

- *Në skenarin bazë*, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) të sektorit bankar paraqitet i qëndrueshëm dhe mbi vlerën faktike të fundit të

[41] *Përllogaritjet për "kapital shtesë", i referohen limitit rregullator specifik të RMK-së të secilës bankë.*

gjashtëmujorit të parë 2020. Konkretisht, kjo normë për sektorin bankar arrin në 22.3% në fund të vitit të parë të ushtrimit. Për bankat sistemike, kjo normë mesatare shënon 22.8%, ndërsa për bankat e tjera ka një vlerë prej 20.8%. Këto zhvillime reflektojnë supozimet mbi rritjen e përmirësuar të kredisë për pjesën e dytë të vitit, përmirësimin e mëtejshëm të portofolit të kredisë me probleme dhe ecurinë e favorshme të kursit të këmbimit. Këto zhvillime tregojnë një qëndrueshmëri dhe nivele të larta të kapitalizimit për të gjithë sektorin dhe për bankat individuale, duke marrë në konsideratë nivelin minimal të kërkuar dhe kërkesat rregullative shtesë.

- *Në skenarin e moderuar*, RMK për sektorin bankar shënon një nivel prej 15.6% në fund të vitit 2020. RMK mesatare për bankat sistemike ka një nivel prej 16.5%, ndërsa për bankat e tjera ky tregues është 13.1%. Këto norma vijojnë të ruhen brenda kërkesave rregullative të përcaktuara, pavarësisht supozimeve të këtij skenari për tkurrje të aktivitetit ekonomik, nënçmim të monedhës vendase, përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë dhe humbje nga portofoli në tituj. Bazuar në supozimet e mësipërme dhe rezultatet e përftuara, zhvillimet në banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali, të cilat në total vlerësohen deri në 7 miliardë lekë.
- *Në skenarin e rënduar*, sektori bankar mbetet i kapitalizuar, por RMK e tij bie në 13.9% në fund të vitit të parë të ushtrimit. Norma mesatare e mjaftueshmërisë së kapitalit për bankat sistemike në këtë skenar është 14.8%, ndërsa për bankat e tjera bie në 11.3%. Zhvillimet makroekonomike të rënduara të përfshira në këtë skenar, ndikojnë në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit të kredisë. Ky skenar supozon gjithashtu një humbje në portofolin e titujve dhe një rritje të ekspozimit ndaj rrezikut operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital dyfishohen kundrejt skenarit të moderuar.

2. Zhvillimet gjatë vitit të dytë ushtrimor dhe nevojat për kapital shtesë

- *Në skenarin bazë*, kapitalizimi i bankave paraqitet i qëndrueshëm duke shënuar 20.1% për bankat sistemike dhe 18.8% për bankat e tjera. Sektori bankar në tërësi arrin një normë kapitalizimi prej 19.8% në fundin e vitit 2021, duke u mbështetur në supozimet mbi një rritje pozitive të kreditimit, si edhe cilësinë e përmirësuar të portofolit të kredisë dhe qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit edhe përgjatë vitit 2021.
- *Në skenarin e moderuar*, RMK e sektorit bankar shënon një nivel prej 12.9% në fund të vitit 2021. Grupi i bankave sistemike ka një RMK mesatare prej 13.7%, ndërkohë që kjo normë për grupin e bankave të tjera është 10.7%. Kjo normë ndikohet nga supozimet për një tkurrje të aktivitetit ekonomik, mungesë të kredidhënies, nënçmim të monedhës vendase, përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë dhe humbje nga portofoli në tituj. Bazuar në këto supozime, rezultatet tregojnë që banka të veçanta evidentojnë nevojën për injektim kapitali deri në fund të vitit 2021, i cili gati trefishohet kundrejt vitit të parë.
- *Në skenarin e rënduar*, RMK për sektorin bankar bie nën 12% në fund të vitit të dytë të ushtrimit. Supozimet mbi zhvillimet makroekonomike mjaft të rënduara dhe tkurrja e kredidhënies, të përfshira në këtë skenar, ndikojnë

në përkeqësimin e ndjeshëm të cilësisë së portofolit të kredisë. Gjithashtu, edhe ky skenar supozon humbje në portofolin e titujve dhe rritje të ekspozimit ndaj rrezikut operacional. Në këtë rast, nevojat për kapital shtesë janë 2.5 herë më të larta se ato të vitit të parë të ushtrimit.

Grafik 104. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit, sipas skenarëve të provës së rezistencës



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahas ushtrimit të mësipërm të provës së rezistencës, Banka e Shqipërisë përdor edhe një qasje tjetër përmes të cilës provohet ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj goditjeve të veçanta në treguesit e tregut dhe ata financiarë, të palidhur mekanikisht mes tyre. Ky ushtrim fiton rëndësi të veçantë në rastet kur lidhja midis treguesve makroekonomikë (për shembull, ecuria e PBB-së, e kursit të këmbimit, e normave të interesit) dhe treguesve financiarë (për shembull, kredia, raporti i kredive me probleme, të ardhurat, treguesit e kapitalit) është bërë më e pasigurt. Kjo qasje është gjithashtu e rëndësishme për të vlerësuar ecurinë e rezistencës së sektorit bankar ndaj goditjeve të njëjta, përgjatë disa periudhave të kohës. Në ushtrimin e kryer, goditjet që janë provuar kanë qenë të ndryshme, duke përfshirë lëvizjet e pafavorshme me një vlerë të caktuar të kredive me probleme, të kursit të këmbimit, të normës së interesit, si edhe një kombinim të tyre. Goditjet mund të kalibrohen në mënyrë të tillë për të kuptuar se kur mund të shfaqet banka e parë që ka nevojë për kapital, kur mund të shfaqet banka e parë sistemike që ka nevojë për kapital. Kjo qasje shërben për të kuptuar më në detaje se ndaj cilës goditje bankat individuale janë më të ndjeshme dhe ndaj cilës janë më rezistente.

Në tërësi, të dyja qasjet e ushtrimit të provës së rezistencës evidentojnë rëndësinë që ka struktura e aktiveve të bankave dhe performanca financiare e tyre, në rezistencën që ato tregojnë ndaj goditjeve të supozuara. Më e rëndësishmja, rezultatet e këtyre ushtrimeve informojnë vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë në lidhje me masat e ndryshme mbikëqyrëse ndaj bankave të caktuara dhe sektorit bankar.

4.2 SEKTORI JOBANKAR

4.2.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË SEKTORIN JOBANKAR

Periudha[42] është karakterizuar nga një ecuri përgjithësisht e mirë e pjesës jobankare të sistemit financiar. Rritja më e lartë është vërejtur në segmentin e institucioneve financiare jobanka dhe në atë të shoqërive të sigurimit, ndërkohë që edhe industria e fondeve paraqitet e qëndrueshme.

Sektorët e tregtisë, shërbimeve dhe bujqësisë vijojnë të përfaqësojnë aktivitetet kryesore ekonomike që tërheqin kredi nga jobankat dhe SHKK-të, ndërkohë që cilësia e kredisë së dhënë nga këto subjekte deri në fund të tremujorit të parë ishte relativisht e mirë, por në rënie të lehtë ndaj një tremujori dhe një viti më parë. Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i kufizuar dhe nuk ka shënuar ndryshime gjatë kësaj periudhe. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj atij bankar, vijon të mbetet i lartë, duke qenë se vendosjet e jobankave pranë sektorit bankar, në formën e depozitave dhe instrumenteve të kapitalit, zënë rreth 20% të bilancit të jobankave.

INSTITUCIONE TË MBIKËQYRURA NGA BANKA E SHQIPËRISË

IFJB-të zgjeruan veprimtarinë e tyre në vijim të rritjes së ndërmjetësimit financiar. Rezultati financiar pozitiv vijon prirjen rritëse, duke u materialiuzuar në një nivel të kënaqshëm të kapitalizimit të veprimtarisë.

Cilësia e portofolit të kredisë së IFJB-ve ka nevojë të monitorohet në vijimësi, në kushtet kur raporti i kredive me probleme mbetet mbi nivelin e treguesit për sektorin bankar.

Institucionet Financiare Jobanka (IFJB) kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre në sajë të ecurisë pozitive të aktivitetit kreditues dhe investimeve në formën e depozitave me afat në banka. Në fund të tremujorit të parë, sistemi financiar përmbante 30 IFJB me një total aktivesh prej 67 miliardë lekësh. Bilanci i institucioneve financiare jobanka ishte përkatësisht 3% dhe 22% më i lartë krahasuar me fundin e vitit 2019 dhe një vit më parë. Pjesa më e madhe e këtij segmenti të sistemit financiar përbëhet nga IFJB-të që kryejnë aktivitet kreditues, ndjekur nga ato që kryejnë pagesa dhe transferta. Rreth 70% e kapitalit aksioner të këtyre subjekteve është kapital vendas.

IFJB-të janë më aktive në financimin me hua të aktiviteteve të shërbimit (rreth 28%) dhe tregtisë me shumicë dhe pakicë (16%). IFJB-të e mbyllën periudhën me një rezultat financiar pozitiv (rreth 0.7 miliardë lekë) dhe më të lartë krahasuar me një vit më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë së këtyre subjekteve vijon të mbetet në nivele të kënaqshme.

Cilësia e portofolit të kredisë shënoi një rënie të lehtë, pasi raporti i kredive me probleme në fund të tremujorit të parë të vitit 2020 arriti në 10.2% nga 10% dhe 9% një tremujor dhe një vit më parë.

[42] *Të dhënat për sektorin jo-bankar i përkasin T1-2020, gjë që bën të pamundur vlerësimin paraprak të efekteve të situatës së jashtëzakonshme të shkaktuar nga Pandemia SARS-CoV-2 në aktivitetin e këtij sektori.*

Grafik 105. Struktura e IFJB-ve sipas llojit të aktivitetit që kryejnë, mars 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 106. Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, mars 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veprimtaria e shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) shënoi zgjerim në terma tremujorë dhe vjetorë mbështetur nga rritja e kredisë neto (veprimet me anëtarët) dhe rritja e investimeve në formën e depozitave me afat pranë sektorit bankar. Rezultati financiar i SHKK-ve ishte pozitiv dhe shënoi përmirësim në krahasim me një vit më parë. Kreditë neto për anëtarët dhe investimet në banka përfaqësojnë zërat kryesorë të aktiveve të këtyre institucioneve. Sektori që ka tërhequr pjesën më të madhe të financimit nga veprimet me anëtarët është sektori i bujqësisë, ndjekur nga sektori i shërbimeve. Në fund të periudhës, në Shqipëri tregu numëronte 14 shoqëri kursim-krediti dhe 1 union.

Aktiviteti i SHKK-ve rezulton pozitiv në terma të kreditimit dhe të rezultatit financiar të periudhës. Për vet natyrën e aktivitetit të SHKK-ve, portofoli i kredisë performon më mirë se kredia e sektorit bankar, pavarësisht një prirjeje të lehtë rritëse në raportin e kredive me probleme.

Cilësia e portofolit të kredisë shënoi një rënie të lehtë, pasi raporti i kredive me probleme në fund të tremujorit të parë të vitit 2020 arriti në 5.4% nga 4.7% një tremujor më parë dhe nuk shënon ndryshime thelbësore kundrejt marsit 2019.

Grafik 107. Struktura e aktiveve të SHKK-ve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 108. Struktura e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, mars 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

INSTITUCIONE TË MBIKËQYRURA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Aktiviteti i institucioneve të mbikëqyrura nga AMF-ja reflekton një ecuri pozitive, me zgjerim të aktivitetit në terma të aktiveve si edhe të numrit të subjekteve të licencuara në fondet e investimit dhe të pensioneve private suplementare.

Aktiviteti i shoqërive të sigurimit ka shënuar rritje gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 mbështetur nga rritja e llogarive rrjedhëse në banka dhe investimet në pasuri të paluajtshme dhe në obligacione të qeverisë. Në tregun vendas operojnë 12 shoqëri sigurimi të licencuara që kryejnë aktivitet të jetës (4 shoqëri) dhe jojetës (8 shoqëri). Aktivet e këtyre institucioneve[43] shënuan rritje vjetore prej 19% dhe arritën në 39 miliardë lekë. Investimet në banka vijojnë të zënë peshën kryesore (rreth 30%) në bilancin e shoqërive të sigurimit. Primet e shkruara bruto[44], me kontributin kryesor nga primet e jojetës (93%), që përfaqësojnë burimin kryesor të financimit të aktivitetit të shoqërive të sigurimit, u tkurrën me rreth 7% në terma vjetorë.

Fondet e investimit[45] ruajtën të pandryshuar nivelin e aktiveve neto ndaj fundit të vitit 2019 në nivelin 67 miliardë lekë. Ecuri pozitive regjistruan investimet në letra me vlerë të qeverisë në formën e obligacioneve dhe mjetet monetare. Në sistemin financiar shqiptar numërohen 6 fonde investimi aktive. Tregu i fondeve të investimit është një treg me përqendrim relativisht të lartë, duke qenë se dy nga fondet e investimit kanë rreth 80% të totalit të aktiveve neto të fondeve. Aktivet e fondeve të investimit investohen kryesisht në obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të cilat ofrojnë kthim më të lartë, në krahasim me investimet alternative.

Grafik 109. Struktura e aktiveve të fondeve të investimeve, mars 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 110. Pesha në treg e fondeve të investimeve sipas vlerës neto të aktiveve, mars 2020



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[43] *Bilanci i shoqërive të sigurimit i përket tremujorit të parë të vitit 2020.*
[44] *AMF, Buletini Statistikor, Tregu i Sigurimeve, Janar-Qershor 2020.*
[45] *AMF, "Tregu i sipërmarrjeve të investimeve kolektive", 31 Mars 2020, publikuar 14 Maj 2020.*

Fondet e Pensioneve Private Suplementare[46] kanë zgjeruar veprimtarinë e tyre gjatë periudhës. Në sistemin financiar shqiptar numërohen 4 fonde pensioni aktive. Aktivet neto të këtyre fondeve në fund të tremujorit të parë të vitit 2020 arritën në rreth 3 miliardë lekë ose 6% më shumë se niveli i aktiveve në fund të vitit 2019. Aktiviteti i fondeve të pensionit dominohet nga investime në titujt e borxhit të qeverisë.

Në 22 shkurt 2018, filloi aktivitetin Bursa Shqiptare e Titujve (ALSE), e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) në korrik 2017. Aktiviteti i Bursës gjatë periudhës ka konsistuar në transaksionet me titujt e borxhit të qeverisë. Bursa numëron 4 anëtarë, që janë banka dhe një shoqëri komisionere. Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë tremujorit të parë të vitit 2020[47], vlera e obligacioneve të tregtuara ishte rreth 108 milionë lekë dhe e bonove të thesarit rreth 119 milionë lekë. Në instrumentet e tregtuara në bursë, si në numër dhe vlerë, dominojnë transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

4.2.2 NDËRLIDHJA E SISTEMIT FINANCIAR

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar mbetet i kufizuar dhe nuk ka shënuar ndryshime gjatë periudhës. Në krahun e aktivit të bankave, ky ekspozim përfaqësohet kryesisht nga huatë akorduar institucioneve financiare jobankare, të cilat zënë vetëm 1% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Në krahun e detyrimeve të bankave, ekspozimi është në formën e fondeve të mbledhura prej bankave (llogarive të ndryshme, depozita me apo pa afat), dhe zë rreth 2% të vlerës së bilancit të sektorit bankar. Ky raport ruan këtë nivel prej rreth dy vitesh dhe konsiderohet si shumë i ulët në krahasim me nivelet kufi të aplikuara nga Banka e Shqipërisë për të monitoruar rrezikun e ekspozimit dhe përqendrimit të aktivitetit midis segmenteve të ndryshme të sistemit financiar.

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit jobankar në vend mbetet i kufizuar dhe pa ndryshime gjatë periudhës.

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe në rritje përgjatë vitit të fundit.

Grafik 111. Investimet e sektorit jobankar në banka dhe letrat me vlerë të qeverisë në raport me totalin e aktiveve të sektorit jobankar (pesha në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Grafik 112. Investimet e institucioneve të sektorit jobankar në sektorin bankar ndaj totalit të aktiveve të tyre (në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[46] *AMF, Raporti Statistikor "Tregu i Pensioneve Private Vullnetare", 31 Mars 2020, publikuar më 7 Korrik 2020.*

[47] *AMF, Periodiku mujor Nr.132, mars-prill 2020.*

Ndjeshmëria e sektorit jobankar ndaj veprimtarisë së sektorit bankar mbetet e lartë dhe është rritur në krahasim me një vit më parë. Ekspozimi i jobankave ndaj sektorit bankar në fund të T1-2020 ishte sa 19% e aktiveve të sektorit jobankar nga 19.5% në fund të vitit 2019 dhe 18% një vit më parë. Shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK) kanë ekspozimin më të madh ndaj sektorit bankar pasi vendosjet e tyre në formën e depozitave dhe instrumenteve të kapitalit në banka, përbëjnë përkatësisht 30% dhe 21% të aktiveve përkatëse. Për institucionet financiare jobanka (IFJB) është vërejtur një rënie e ekspozimit dhe njëkohësisht e ndjeshmërisë ndaj zhvillimeve në sektorin bankar, duke qenë se këto subjekte kanë pakësuar llogaritë rrjedhëse në sektorin bankar. Ekspozimi i sektorit jobankar ndaj sektorit bankar monitorohet rregullisht nga Banka e Shqipërisë në kuadrin e vlerësimit periodik të rreziqeve sistemike dhe monitorimit të përmbushjes së objektivave të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale.

5. POLITIKAT MAKROPRUDENCIALE DHE VLERËSIMI I RREZIQEVE

5.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË VENDET E BE-SË DHE RAJON[48]

Analiza në vijim paraqet rreziqet kryesore të identifikuara në raportet e stabilitetit financiar dhe instrumentet e politikave makroprudenciale të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian (BE) dhe në rajon. Për këtë qëllim, janë analizuar një sërë raportesh të vlerësimit të rreziqeve, të përgatitura nga Banka Qendrore Evropiane (ECB), Bordi Evropian për Rrezikun Sistemik (ESRB), Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Organizata Ndërkombëtare e Komisionit të Letrave me Vlerë (IOSCO), etj. Raportet e shqyrtuara datojnë nga viti 2018 deri në gjysmën e parë të vitit 2019.

5.1.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Në këtë kuadër, rreziqet kryesore të identifikuara nga vendet e BE-së, janë si në vijim:

I. Mundësia që mjedisi me norma tepër të ulëta të interesit, të shoqërohet me devijime të theksuara në vleresimin dhe profilin e rrezikut të produkteve financiare;
II. Shqetësimi për qëndrueshmërinë e nivelit të borxhit publik dhe privat, veçanërisht pas situatës së COVID-19;
III. Zvogëlimi i kapaciteteve ndërmjetësuese të sektorit bankar si rezultat i niveleve të ulta në përfitueshmërinë nga aktiviteti, çka përbën një rrezik të shtuar për stabilitetin financiar të Eurozonës;
IV. Rritja e sipërmarrjes së rrezikut nga sektori financiar jobankar, shoqëruar me rritje të rreziqeve në terma të likuiditetit dhe të kreditit në portofolin e tyre të investimeve.

Për sa i përket masave makroprudenciale të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së, vërehet lehtësim i përgjithshëm i tyre gjatë periudhës së pandemisë, edhe pse gjatë vitit 2019 masat makroprudenciale vijuan rritjen e kërkesave të tyre. Në periudhën përpara COVID-19, shumica e masave të ndërmarra ishin të një natyre shtrënguese dhe kryesisht adresuan rreziqet ciklike. Megjithatë, pas krizës COVID-19 pjesa më madhe e vendeve evropiane kanë ulur në minimum kërkesat makroprudenciale të kapitalit për t'i mundësuar sistemit financiar rimëkëmbjen nga kjo situatë. Instrumentet makroprudenciale të

[48] *Për qëllime të kësaj analize, në vendet e rajonit janë përfshirë edhe Italia e Greqia, në kuadër të ekspozimeve të sektorit bankar shqiptar ndaj tyre.*

përdorura më shpesh janë kryesisht instrumentet e kapitalit shtesë kundërciklik, të rrezikut sistemik, të institucioneve me rëndësi sistemike, dhe instrumente që adresojnë huamarrësin.

Grafik 113. Masat kryesore të ndërmarra në vendet e BE-së, sipas llojit



Burimi: ESRB.

Lista e vendeve më aktive në zbatimin e instrumenteve makroprudenciale kryesohet nga vendet si: Norvegjia, Franca, Portugalia dhe Danimarka.

Grafik 114. Numri i masave të ndërmarra nga vendet anëtare të BE-së



Burimi: ESRB.

5.1.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË RAJON

Për sa i takon vendeve të rajonit, duke konsideruar informacionin sipas raportimeve të fundit, rreziqet e identifikuara prej tyre janë të ngjashme me ato që identifikohen nga Banka e Shqipërisë për shkak të ngjashmërisë së karakteristikave ekonomike. Disa prej rreziqeve kryesore të identifikuara janë si në vijim:

I. Rreziku ndaj kursit të këmbimit;
II. Niveli i ulët i fitimeve në sistemin financiar shoqëruar me rritje të ulët nominale të portofolit dhe nivel i lartë i kredive me probleme;
III. Nivele të larta të borxhit publik dhe përkeqësim i konsiderueshëm për shkak të COVID-19;
IV. Niveli i lartë i përqendrimit të ekspozimeve në disa prej sektorëve të ekonomisë, duke ndikuar në këtë mënyrë nivelin aktual të kredive me probleme.

Gjatë këtij gjashtëmujori, nuk ka pasur ndryshime në numrin e instrumenteve makroprudenciale të aktivizuara në vendet e rajonit. Ndër vendet e rajonit që nuk janë pjesë e BE-së, konstatohet që Serbia e Maqedonia e Veriut vijojnë të jenë më aktive në lidhje me aktivizimin e kërkesave për kapital shtesë për qëllime makroprudenciale. Në këto vende, instrumentet e përdorura më shpesh lidhen me administrimin e rreziqeve sistemike të natyrës strukturore.

Grafik 115. Instrumentet makroprudenciale me bazë kapitalin sipas vendeve të rajonit



Burimi: Faqet zyrtare të bankave qendrore të vendeve të shqyrtuara.

5.2 VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE MASAT MAKROPRUDENCIALE NË SHQIPËRI

5.2.1 VLERËSIMI I RREZIQEVE NË SHQIPËRI

Banka e Shqipërisë, harton dhe zbaton politikën makroprudenciale, e cila analizon e vlerëson rrezikun sistemik dhe zbaton masat për parandalimin e zbutjen e tij, në dy drejtime:
I. parandalon akumulimin e rreziqeve në sistemin financiar, dhe
II. forcon rezistencën e sistemit financiar.

Nga pikëpamja e parandalimit të akumulimit të rreziqeve, autoriteti qendror harton analiza që synojnë identifikimin e zhbalancave financiare të treguesve

që reflektojnë akumulimin e rreziqeve në sektorin bankar. Nga rezultatet e kësaj analize vërehet se në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, sektori bankar ka vijuar të ruajë një nivel të mirë kapitalizimi dhe likuiditeti, të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat afatshkurtra, megjithë situatën e krijuar nga masat anti COVID-19. Ndër çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje vazhdon të jetë nxitja e kredidhënies për bizneset, zgjerimi i hendekut negativ midis aktiveve dhe pasiveve sipas maturitetit të mbetur, reduktimi i përdorimit të monedhës së huaj në ekonominë vendase, dhe monitorimi më nga afër i aktiveve likuide në valutë.

5.2.2 MASAT MAKROPRUDENCIALE NË SHQIPËRI

Nga pikëpamja e forcimit të rezistencës së sektorit bankar ndaj rreziqeve me natyrë ciklike e strukturore, dhe uljen e tyre, Banka e Shqipërisë ka miratuar rregulloren "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", si edhe paketën e masave për rritjen e përdorimit të monedhës vendase në veprimtarinë financiare bankare. Rregullorja përmban një kornizë për zbatimin e: (a) shtesës konservuese të kapitalit (KONS); (b) shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC); (c) shtesës për bankat sistemike (SIST); dhe (d) shtesës për rrezikun sistemik (SRS). Të gjitha shtesat makroprudenciale të kapitalit duhet të përmbushen me instrumente të kapitalit bazë të nivelit të parë dhe të shprehen si përqindje e ekspozimeve të peshuara me rrezik të bankës. Zbatimi i njëkohshëm i tyre përfaqëson shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit ose SHKOMAK.

Kërkesa për shtesën konservuese të kapitalit zbatohet për të gjitha bankat dhe hyri në fuqi me miratimin e rregullores së lartpërmendur. Vlera maksimale e kësaj shtese është 2.5%, dhe rregullorja parashikon që shtesa të plotësohet në hapa prej 0.5 pikë përqindje në vit duke filluar nga muaji mars i vitit 2020[49]. Shtesa kundërciklike e kapitalit për Shqipërinë aktualisht është e barabartë me 0% dhe shpallet në fund të çdo tremujori përmes një vendimi të Guvernatorit. Vendimi për përcaktimin e bankave sistemike dhe shtesat e kapitalit për rëndësinë sistemike, shpallet një herë në vit, në fund të tremujorit të parë. Në vijim të vendimit të qershorit 2019, Guvernatori mori vendimin e radhës në 25 mars të vitit 2020, i cili zgjeron nga katër në pesë numrin e bankave me rëndësi sistemike dhe përcakton shtesën e kapitalit për këto banka me vlera nga 0.5% në 1.5%.

Për herë të parë, bankat raportuan përmbushjen e shtesave makroprudenciale të kapitalit për periudhën raportuese "mars 2020". Raportimi do të kryhet mbi baza tremujore dhe raportimi i fundit i përket muajit qershor 2020. Nga ky raportim rezultoi se të gjitha bankat përmbushin shtesën e kombinuar të kapitalit – SHKOMAK, duke qenë se raporti i përmbushjes rezulton mbi 100%.

Nga rezultatet e raportuara, vërehet që bankat me nivelin më të lartë të përmbushjes së SHKOMAK, janë bankat të cilat kanë një raport mjaftueshmërie

[49] *Gjatë periudhës 29 mars 2020 – 31 dhjetor 2020, bankat duhet të plotësojnë shtesën konservuese të kapitalit deri në masën 0.5%.*

kapitali (RMK) të lartë, dhe nuk kanë kërkesa të tjera të detyrueshme të kapitalit (Shtylla II e Bazelit) për të përmbushur. Këto kushte u mundësojnë këtyre bankave të kenë një raport të "kapitalit neto të disponueshëm" më të lartë në krahasim me bankat e tjera me RMK më të ulët.

ANEKS 1: ZHVILLIMET NË KREDINË KONSUMATORE DHE RREZIQET PËR STABILITETIN FINANCIAR NË KUSHTET E KRIZËS SË SHKAKTUAR NGA PAMDEMIA SARS-COV-2

Goditja që pandemia i dha situatës financiare të familjeve/individëve pritet të shkaktojë një ulje të konsumit, dhe shtron nevojën e gjetjes së burimeve për mbështetjen e tij. Analiza në vijim fokusohet tek ecuria e kredisë konsumatore, si një burim i mundshëm në këtë rast.

Në Shqipëri, kredia konsumatore u zgjerua ndjeshëm gjatë viteve 2014-2018[50], duke dhënë dhe kontributin kryesor në rritjen e kredisë për individë, për t'u ngadalësuar më pas që prej vitit 2019. Një rënie drastike në flukset e kredisë së re konsumatore ka ndodhur që në muajin e parë pas shpërthimit të krizës së shkaktuar nga Covid-19 (mars 2020, rënie vjetore prej 33.7%). Në fund të tremujorit të dytë 2020, vëllimi i kredisë së re konsumatore u tkurr edhe më tej me 39.7%. Kontributin kryesor në ecurinë e kredisë së re konsumatore gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit e ka dhënë tkurrja e kredisë së re për konsumin e mallrave jo të qëndrueshme. Kjo e fundit shënoi një rënie vjetore prej 49.2% në fund të muajit qershor. Rënie regjistruan njëherazi dhe kredia për konsumin e mallrave të qëndrueshme (30.6%) dhe overdraftet (22.5%).

Grafik 116. Disa tregues të kredisë konsumatore



Shënim: 1.Grafiku majtas paraqet flukset e kredisë konsumatore të re në terma vjetorë.
2. Grafiku djathtas paraqet treguesin e fluksit të kredisë konsumatore ndaj konsumit (boshti majtas); indeksi i kërkesës për kredi konsumatore dhe i standardeve të kredidhënies për kredinë konsumatore (boshti djathtas). Në boshtin djathtas të grafikut, vlera negative tregon që bankat kanë shtrënguar standardet e kredidhënies dhe anasjelltas. Po ashtu, vlera pozitive tregon rritje të kërkesës për kredi, ndërsa balanca negative tregon uljen e saj.
Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

[50] *Më shumë detaje në lidhje me ecurinë historike të kredisë konsumatore në Shqipëri janë diskutuar në numrin paraardhës të raportit të stabilitetit financiar.*

Tkurrja e kredisë konsumatore menjëherë pas goditjes në ekonomi të shkaktuar prej pandemisë, reflekton natyrën e saj prociklike, duke qenë se është një kredi që mbështet konsumin. Ky prociklikalitet ka qenë evident për të dhënat e Shqipërisë, nëse do të shohim ecurinë e raportit të kredisë së re konsumatore ndaj konsumit të individëve (grafiku lart djathtas). Të dhënat e disponueshme deri në fund të T1-2020 mbi konsumin privat, ende nuk reflektojnë plotësisht zhvillimet e lidhura me masat e marra për të parandaluar përhapjen e pandemisë. Efekti negativ i pandemisë në ekonomi pritet të rmaterializohet në një rënie të mëtejshme të treguesit për T2-2020 në një tkurrje më të theksuar të kreditimit në kushtet kur kërkesa për kredi konsumatore ka pësuar një rënie rekord (sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues[51] realizuar nga BSH), rritje të pasigurisë si dhe shtrëngim të standardeve të kredidhënies nga sektori bankar.

Edhe pjesa tjetër e sistemit financiar (shoqëritë e kursim-kreditit) ka lëvruar më pak kredi konsumatore menjëherë pas shpërthimit të krizës Covid-19. Kredia e re konsumatore e dhënë nga kjo pjesë e sistemit financiar ka njohur rritje dyshifrore vitet e fundit, megjithatë ajo pësoi një tkurrje prej 12% në mars 2020. Teprica e kredisë konsumatore dhënë nga kjo pjesë e sistemit financiar në total përbën rreth 10% të kredisë konsumatore të dhënë nga sektori bankar.

Grafik 117. Përbërja e kredisë konsumatore sipas qëllimit të përdorimit (majtas) dhe kontributi i komponentëve në rritjen e kredisë konsumatore për rezidentët, sipas qëllimit të përdorimit (në pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Referuar kostos së kredisë, bankat kanë vijuar të operojnë në një mjedis me norma interesi të ulëta. Interesi mesatar për kredinë konsumatore ka qenë i luhatshëm gjatë 2 tremujorëve të fundit, duke shënuar një rënie në muajin prill për t'u ringritur më pas në nivele të ngjashme me një vit më parë. Gjatë kësaj periudhe, normat e interesit për kredinë konsumatore (kryesisht e pakolateralizuar) kanë qenë mesatarisht 4 pikë përqindje më të larta sesa interesat e aplikuara për kredinë hipotekare.

[51] *Për më shumë detaje, konsultoni "Vrojtimin për aktivitetin kreditues", në adresën: https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/*

Gjatë periudhës është vërejtur një rritje e ndjeshme e kontratave të reja ku periudha e mosndryshimit të normës së interesit kufizohet vetëm për një periudhë kohe të caktuar deri në një vit. Në fund të qershorit 2020, këto zinin 42% të totalit të kredive konsumatore të reja krahasuar me nivelin mesatar prej 19% përgjatë 2 viteve të fundit.

Grafik 118. Norma mesatare e interesit për kredinë e re dhënë individëve (majtas) dhe struktura e periudhave të fiksimit fillestar të normës së interesit për kreditë e reja për konsum (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhës, kreditë konsumatore në lekë mbizotërojnë në portofolin e bankave të sektorit. Në fund të muajit qershor 2020, kredia konsumatore në valutë përbën 13.6% të kredisë konsumatore, një vlerë më e ulët se pesha mesatare përgjatë vitit të kaluar prej rreth 15%. Më shumë se gjysma e kredive konsumatore në valutë (rreth 58%) është e klasifikuar si e pambuluar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, megjithatë këto të fundit zënë vetëm 8% të stokut të kredisë konsumatore. Rreziku që vjen prej luhatjeve të pafavorshmë të kursit të këmbimit, nga këndvështrimi i aftësisë paguese të huamarrësit, mbetet i kufizuar.

Përsa i përket cilësisë së kredisë, kredia konsumatore ka njohur nivele relativisht më të ulëta të kredive me probleme, pavarësisht natyrës së saj me rrezik më të lartë dhe ka dhënë historikisht kontribut minimal në rritjen e stokut të kredive me probleme në totalin e bilancit të sektorit bankar. Raporti i kredive konsumatore me probleme ka hyrë në një fazë rënëse që prej gjysmës së dytë të vitit 2013, duke shënuar vlerën prej 5.4% në fund të qershorit 2020.

Grafik 119. Raporti i kredive konsumatore me probleme (majtas); dhe kontributi i kredive konsumatore në rritjen e stokut të kredive me probleme në total (djathtas, në p.p)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga të dhënat e mësipërme, duket sikur kredia konsumatore do të vijojë të jetë një instrument i rëndësishëm për mbështetjen e konsumit në ekonomi. Potenciali për rritjen e saj mbetet i mirë, dhe normat e interesit gjenden në nivelet më të ulëta historike. Nga ana tjetër, faktorët e rrezikut me të cilët po përballet ekonomia në këto kohë, janë specifikë. Pasiguria tek operatorët ekonomikë, në kushtet e pandemisë, vijon të jetë e lartë. Për këto arsye, kërkesa për kredi konsumatore më shumë gjasë do të vijojë të jetë e dobët edhe për disa muaj. Në këto kushte, është e nevojshme të monitorohet cilësia e kredisë dhe të përshtatet oferta e saj në varësi të zhvillimeve.

ANEKS 2. TREGUESIT KRYESORË TË SHËNDETIT FINANCIAR

në përqindje	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Treguesit me bazë kapitalin														
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	17.1	17.2	16.2	15.4	15.6	16.2	18.0	16.8	15.7	16.0	17.0	18.7	18.5	18.1
Kapitali i nivelit të parë ndaj aktiveve të peshuara me rrezik	16.0	16.3	15.3	14.5	14.3	14.6	14.9	13.8	13.5	14.1	15.5	17.4	17.3	17.0
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.6	8.6	9.6	9.4	8.7	8.6	8.4	8.6	9.5	9.7	10.2	10.1	10.5	10.3
Cilësia e aktiveve														
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.1	21.7	28.2	35.9	52.0	55.6	40.2	38.3	24.3	23.1	15.7	15.5	13.6	10.9
Huatë me probleme (bruto) ndaj huave totale	3.4	6.6	10.5	14.0	18.8	22.5	23.5	22.8	18.2	18.3	13.2	11.1	8.4	8.1
Përfitueshmëria														
Kthimi nga kapitali (ROE) (bazë vjetore)	20.7	11.4	4.6	7.6	0.8	3.8	6.4	10.5	13.2	7.2	15.7	13.0	13.5	9.1
Kthimi nga aktivet (ROA) (bazë vjetore)	1.6	0.9	0.4	0.7	0.1	0.3	0.5	0.9	1.2	0.7	1.5	1.3	1.4	0.9
Pozicioni i hapur neto ne valute te huaj ndaj kapitalit														
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.7	4.3	3.9	5.0	3.9	4.0	4.1	8.5	7.7	7.0	6.7	7.8	7.4	5.4
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit të nivelit të parë	1.8	4.5	4.1	5.3	4.3	4.4	4.9	10.4	9.0	8.0	7.3	8.4	8.0	5.7
Treguesit me bazë aktivet														
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.8	42.8	27.6	25.9	26.5	29.4	27.6	31.9	32.3	31.3	30.2	34.2	35.7	33.3
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	74.0	64.9	32.6	30.6	33.1	36.7	34.7	40.4	41.4	40.6	40.8	46.2	49.4	46.1
Depozita të klientëve ndaj totalit të huave	215.5	162.6	154.3	166.4	163.2	171.6	180.8	180.2	187.8	192.8	194.0	203.2	207.2	208.4

Burimi: Banka e Shqipërisë